Ambasciata d'Italia
Tirana

AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO

MINISTRIA E SHENDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

UN WOMEN

# Fuqizimi i Grave për Zhvillimin Rural në Shqipërinë Veriore

## Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirëve të Vlerës në Bashkinë Shkodër

UN Women është krijuar për të avancuar të drejtat e grave, barazinë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave. Si enti drejtues i Kombeve të Bashkuara për barazinë gjinore dhe sekretariat i Komisionit për Statusin e Grave, ne punojmë për të ndryshuar ligjet, institucionet, sjelljet shoqërore dhe shërbimet, me qëllim mbylljen e hendekut gjinor dhe ndërtimin e një bote të barabartë për të gjitha gratë dhe vajzat.Partneritetet tona me qeveritë, lëvizjet e grave dhe sektorin privat, së bashku me rolin tonë koordinues në kuadër të sistemit të Kombeve të Bashkuara, i kthejnë përparimet në ndryshime të qëndrueshme. Puna jonë për avancimin e të drejtave të grave dhe vajzave përqendrohet në katër fusha kyçe: lidershipi, fuqizimi ekonomik, mbrojtja nga dhuna, roli i grave në paqe dhe siguri, si dhe veprimi humanitar.

UN Women i vendos të drejtat e grave dhe vajzave në qendër të përparimit global—gjithmonë dhe kudo. Sepse barazia gjinore nuk është vetëm ajo që bëjmë. Barazia gjinore është ajo që jemi.

UN Women Zyra e Shqipërisë,
Rr. "Skenderbej", Ndërtesa 8, Ap. 29-31, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 450 2555/7575
E-mail: unwomen.albania@unwomen.org
Website: https://albania.unwomen.org

Kjo analizë me ndjeshmëri gjinore e zinxhirëve të vlerës u realizua në kuadër të projektit "Fuqizimi i grave për zhvillim rural në Shqipërinë e Veriut", i zbatuar nga UN Women dhe i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar e Italisë. Ky projekt zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, Kombeve të Bashkuara ose cilësdo prej organizatave të lidhura me to.

Për të shkarkuar këtë botim, ju lutemi shkoni në faqen: https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications

Autorë: Erald Lamja, Diamanta Vito, ekspertë të UN Women

Me kontribut teknik të: Rachele Megna, Besmira Kukaj, nga UN Women

Bashkia e Shkodrës

Përpunimi grafik: HL Branding

Ky botim është i disponueshëm me akses të lirë në përputhje me licencën Creative Commons të krijuar për organizatat ndërqeveritare, e disponueshme në: https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/3.0/igo/.

Botuesit duhet të heqin logot e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, UN Women nga botimi i tyre dhe të krijojnë një kopertinë të re. Botuesit duhet të dërgojnë versionin e tyre në format elektronik në adresën: permissions@unwomen.org. Fotokopjimi dhe riprodhimi i pjesëve të veçanta lejohet, për sa kohë që jepet njohja e duhur.

# Fuqizimi i Grave për Zhvillimin Rural në Shqipërinë Veriore

## Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirëve të Vlerës në Bashkinë Shkodër

Qershor 2025

# Tabela e Përmbajtjes


Lista e shkurtesave 9

Përligjja e studimit 11

Përmbledhje e konstatimeve kryesore kontekstuale 12

**PJESA 1:** METODOLOGJIA 16

**PJESA 2:** ANALIZË E ZINXHIRIT TË VLERËS TË FIDANËVE TË PERIMEVE 26

1. Analizë me ndjeshmëri gjinore e zinxhirit të vlerës të fidanëve të perimeve 30
2. Diagram i zinxhirit të vlerës të farave dhe fidanëve 28

2.1 Aktorët në zinxhirin e vlerës 31

2.2 Shërbimet e mbështetjes dhe kontrollit 32

2.3 Konstatimet e studimit 35

2.4 Ndërhyrjet e rekomanduara për zinxhirin e vlerës së fidanëve në Gurin e Zi 37

**PJESA 3:** ANALIZË E ZINXHIRIT TË VLERËS SË QEPËS 42

1. Analizë me ndjeshmëri gjinore e zinxhirit të vlerës së qepës 43
2. Diagram i zinxhirit të vlerës të qepës 46

2.1 Aktorët në zinxhirin e vlerës 47

2.2 Shërbimet e mbështetjes dhe kontrollit 48

2.3 Konstatimet e studimit 52

2.4 Rekomandime për zhvillimin e zinxhirit të vlerave të qepës në Postribë 55

**PJESA 4:** SHTOJCAT 60

Shtojca 1. Bashkia Shkodër: Informacion i përgjithshëm 61
Demografia dhe popullsia 62
Konteksti social-ekonomik 64
Shërbimet sociale dhe ndihma ekonomike 64
Migracioni 67
Edukimi 67
Shëndetësia 70
Aktiviteti ekonomik 71
Tregu i punës, punësimi dhe papunësia në Shkodër 72
Punësimi 72
Infrastruktura: toka, ujërat, energjia elektrike dhe jeta sociale 73
Prodhimi i Energjisë Elektrike në Shkodër 72
Ujitja dhe Kullimi 74
Përbërja e Tokës në Bashkinë Shkodër 74
Infrastruktura rrugore në Bashkinë Shkodër 74
Turizmi, trashëgimia kulturore dhe historike 74
Bujqësia dhe blegtoria 76
Blegtoria 74
Bimët e arave 78
Kultivimi i perimeve 76
Pemët frutore dhe prodhimi i frutave 80

Shtojca 2: Konteksti kombëtar i barazisë gjinore 82

Shtojca 3. Bujqësia dhe zhvillimi rural: çështje gjinore kyçe në Shqipëri 85

# Lista e Tabelave


**Tabela 1.** Klasifikimi dhe përzgjedhja e zinxhirëve të vlerës me përdorim të kritereve me ndjeshmëri gjinore 20

**Tabela 2.** Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e bimëve dekorative 21

**Tabela 3.** Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e fidanëve të perimeve 22

**Tabela 4.** Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e qepës 23

**Tabela 5.** Analiza SWOT e zinxhirit të vlerës së fidanëve 29

**Tabela 6.** Rekomandime për zinxhirin e vlerës të fidanëve 40

**Tabela 7.** Analiza SWOT e zinxhirit të vlerës të qepës 45

**Tabela 8.** Rekomandime për zinxhirin e vlerës së qepës 56

**Tabela 9.** Ndarja e bashkisë në lagje, njësi administrative dhe fshatra 61

**Tabela 10.** Popullsia sipas grupmoshës dhe gjinisë (2023) 62

**Tabela 11.** Demografia sipas NJA-ve, gjinisë dhe grupmoshës (2023)) 63

**Tabela 12.** Bërthamat familjare sipas njësive administrative (2023) 64

**Tabela 13.** Shërbimet sociale në vitin 2023 65

**Tabela 14.** Popullsia sipas njësive administrative, aftësisë së kufizuar dhe gjinisë 65

**Tabela 15.** Treguesit socialë 66

**Tabela 16.** Kopshtet në Shkodër 67

**Tabela 17.** Regjistrimi dhe personeli arsimor në kopshte 67

**Tabela 18.** Shkollat në Shkodër 68

**Tabela 19.** Shkollat dhe nxënësit sipas njësive administrative 68

**Tabela 20.** Frekuentimi i shkollës dhe aftësitë e leximit dhe shkrimit 70

**Tabela 21.** Institucionet shëndetësore 70

**Tabela 22.** Numri i ndërmarrjeve aktive sipas gjinisë, 2023 71

**Tabela 23.** Ndërmarrjet sipas madhësisë, 2023 71

**Tabela 24.** Numri i ndërmarrjeve aktive sipas sektorit, 2023 72

**Tabela 25.** Treguesit e tregut të punës, zona e Shkodrës, 2023 72

**Tabela 26.** Punësimi në sektorin publik kundrejt sektorit privat 73

**Tabela 27.** Të dhëna kyçe të hidrocentraleve në Shkodër 73

**Tabela 28.** Pasqyrë e përgjithshme e nismave 75

**Tabela 29.** Monumente dhe vende me interes kulturor 75

**Tabela 30.** Numri i fermerëve në vitet 2021 deri 2023 76

**Tabela 31.** Shifrat e bagëtive 2023 77

**Tabela 32.** Prodhime blegtorale, 2023 77

**Tabela 33.** Bimët e arave, 2023 78

**Tabela 34.** Prodhimi i perimeve të freskëta, 2023 79

**Tabela 35.** Prodhimi i pjeprit dhe shalqirit, 2023 79

**Tabela 36.** Pemët frutore dhe prodhimi i frutave, 2023 80

**Tabela 37.** Kultivimi dhe prodhimi i agrumeve, 2023 80

**Tabela 38.** Kultivimi dhe prodhimi i ullirit, 2023 80

**Tabela 39.** Kultivimi dhe prodhimi i vreshtave, 2023 81

# Lista e Figurave

**Figura 1.** Qasja metodologjike 19

**Figura 2.** Diagram i zinxhirit të vlerës të fidanëve të perimeve 30

**Figura 3.** Diagram i zinxhirit të vlerës të qepës 46

**Figura 4.** Gratë, burrat dhe bujqësia në Shqipëri 92

# Lista e Shkurtesave

| | |
|---|---|
| **AICS** | Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim |
| **AIDA** | Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve |
| **AKU** | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit |
| **AKVMB** | Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve |
| **AREB** | Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor |
| **NJA** | Njësi administrative |
| **FAO** | Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e OKB-së |
| **PMB** | Praktikat e mira bujqësore |
| **GIZ** | Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar |
| **OMGJ** | Organizma të modifikuar gjenetikisht |
| **ANGJZV** | Analizë me ndjeshmëri gjinore e zinxhirit të vlerës |
| **HACCP** | Analiza e Rrezikut dhe Pikave Kritike të Kontrollit |
| **UNKN** | Unioni Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës |
| **INSTAT** | Instituti i Statistikave i Shqipërisë |
| **BMA** | Bimë mjekësore dhe aromatike |
| **MBZHR** | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| **MEKI** | Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit |
| **DHKZ** | Dhoma Kombëtare e Zejtarisë |
| **QTTB** | Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore |
| **UN Women** | Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave |
| **USAID** | Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar |
| **ZV** | Zinxhir i vlerës |
| **FEG** | Fuqizimi ekonomik i grave |

# Përligjja e Studimit

Dhuna me bazë gjinore mund të krijojë barriera që pengojnë mundësitë ekonomike dhe zhvillimin. Nga ana tjetër, fuqizimi ekonomik i grave (FEG) mund të shtojë besimin dhe pavarësinë dhe të zvogëlojë gjasat që ato të jetojnë në situata të dhunshme; po kështu, rritja e fuqizimit ekonomik të grave u kundërvihet edhe stereotipave gjinorë dhe normave shoqërore të rrënjosura thellë, të cilat mund të manifestohen me rritje të dhunës me bazë gjinore.

Ky dualitet nxjerr në pah ndërveprimin kompleks midis fuqizimit të grave dhe rezistencës ndaj ndryshimit, që thekson nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse dhe të përshtatur me kontekstin ndaj barazisë gjinore. Rrjedhimisht, fuqizimi ekonomik i grave shihet njëkohësisht edhe si mjet për t'i dhënë fund dhunës, në rastin e grave që i kanë mbijetuar dhunës, edhe si mënyrë për forcimin e pavarësisë ekonomike të grave dhe pjesëmarrjen e tyre në forcat e punës. Këto dinamika janë veçanërisht të dukshme në bashkitë e Bulqizës, Malësisë së Madhe, Shkodrës, dhe Dibrës, të cilat janë bashkitë e synuara në projektin "Fuqizimi i grave për zhvillim rural në Shqipërinë e Veriut,"[1] i zbatuar nga UN Women Shqipëri, me mbështetjen e Ministrisë Italiane të Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, përmes Agjencisë Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor (AICS Tiranë). Në këto zona mbizotërojnë stereotipet gjinore dhe ato karakterizohen nga mungesa sistematike të shërbimeve sociale, si transporti publik dhe kopshtet e fëmijëve; aksesi i kufizuar ose i paqartë i grave në të drejtat pronësore; si dhe një shkallë e lartë e punës së papaguar dhe informale të kryer nga gratë, që mund të kufizojë masën në të cilën ato mund të marrin pjesë në veprimtari ekonomike.[2] Për t'i trajtuar këto probleme, UN Women promovon qeverisjen e përgjigjshme gjinore, ku përfshihen elementë të forcimit të reagueshmërisë gjinore të kornizës së politikave bujqësore dhe të zhvillimit vendor në nivel kombëtar dhe lokal duke rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e grave dhe duke adresuar stereotipet gjinore, ndër të tjera edhe në lidhje me të drejtat pronësore dhe dhënien fund të dhunës ndaj grave. Kjo qasje me ndjeshmëri gjinore ndaj zinxhirëve të vlerës është një strategji proaktive që jo vetëm promovon barazinë gjinore, por edhe forcon efikasitetin, qëndrueshmërinë, dhe karakterin përfshirës të ekonomive rurale. E bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, parimet e drejtësisë sociale dhe avantazhet ekonomike të përfshirjes gjinore për bizneset – si ato që janë shtjelluar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP)[3] – kjo qasje i njeh gratë si kontribuese aktive në produktivitetin ekonomik dhe në forcimin e aftësisë së komunitetit për të përballuar situata të vështira. Nisma synon të transformojë dinamikën ekzistuese të pushtetit dhe të zgjerojë rolet e grave si veprimtare ekonomike. **Garantimi i reagueshmërisë gjinore të ligjeve, politikave dhe shërbimeve do të krijojë një mjedis mundësues i cili mbështet jo vetëm të drejtat e grave, por edhe aftësinë konkurruese dhe qëndrueshmërinë ekonomike të tyre.** Nga ana e tij, promovimi i fuqizimit ekonomik të grave forcon autonominë e tyre dhe bën të mundur që ato të dalin nga cikli i dhunës, të kërkojnë dhe ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të kontribuojnë në mënyrë më të plotë në familje dhe komunitet.

Përmes njohjes së rolit kyç të barazisë gjinore në arritjen e një zhvillimi rural përfshirës dhe të qëndrueshëm, ky projekt ndërmerr të kryejë **analiza me ndjeshmëri gjinore të zinxhirëve të vlerës, të përshtatura me veçoritë e zonave** në secilën bashki partnere. Këto analiza synojnë të evidentojnë sektorët kyç të ekonomisë dhe zinxhirët e vlerës që kanë potencial zhvillimor, të hartëzojnë rolet e diferencuara të grave dhe burrave në këta zinxhirë vlere, dhe të identifikojnë pengesat që kufizojnë pjesëmarrjen dhe rolin drejtues të grave. Mbi bazën e këtyre të dhënave po përgatiten ndërhyrje të posaçme për rritjen e aksesit të grave në mundësi ekonomike, si dhe për të promovuar një zhvillim të drejtë gjinor të zinxhirëve të vlerës. Studimi bën një analizë të Bashkisë Shkodër nga këndvështrimi gjinor dhe sugjeron qasje me ndjeshmëri gjinore për forcimin e barazisë gjinore në zinxhirët e vlerës ekonomike dhe përmes tyre, mbi bazën e ekspertizës së UN Women në këtë fushë.[4] Ai synon të identifikojë strategji konkrete dhe të realizueshme për forcimin e barazisë gjinore **në zinxhirët e vlerës dhe përmes tyre,** duke u mbështetur në ekspertizën globale të UN Women dhe partneritetet vendore. **Përmes promovimit të zinxhirëve të vlerës me përfshirje të gjerë, projekti synon të çlirojë potencialin e plotë ekonomik të grave dhe të forcojë rolet e tyre si faktorë të ndryshimit në zhvillim të qëndrueshëm rural.**

1. Projekt i financuar nga AICS – Agjencia Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor dhe i zbatuar nga UN Women Shqipëri (2024-2027).
2. *Empowering Women in the Rural Economy* (Fuqizimi i grave në ekonominë rurale). Shih: https://www.ilo.org/sites/default/files/wcms-sp5/groups/public/%40ed_dialogue/%40sector/documents/publication/wcms_601071.pdf
3. *Guide to Gender-Sensitive Approaches to Value Chain Development* (Udhëzues për qasje me ndjeshmëri gjinore në zhvillimin e zinxhirit të vlerave). Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP). (2022). Shih: https://www.ilo.org/publications/guide-gender-sensitive-approaches-value-chain-development
4. https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2022/12/gender-sensitive-value-chain-analysis

# Përmbledhje e Konstatimeve Kryesore Kontekstuale

Bashkia Shkodër, me sipërfaqe 872,71 km², përbëhet nga 11 njësi administrative dhe 92 fshatra dhe është një prej bashkive më të mëdha në Shqipëri. Ajo ka një popullatë prej 102.434 banorësh (52.209 femra dhe 50.225 meshkuj), me strukturë gjinore relativisht të balancuar. Pozicioni strategjik i saj, si urë lidhëse midis Shqipërisë, Malit të Zi dhe Kosovës, kontribuon në një ekonomi dinamike me bazë bujqësinë, përpunimin e produkteve bujqësore, turizmin, industrinë dhe tregtinë.

Bujqësia është shtyllë qendrore e ekonomisë së Shkodrës, ku 40% e të gjithë sipërfaqes së tokës përdoret për bujqësi. Në bashki kultivohen një numër kulturash të ndryshme bujqësore, si patate, domate, qepë, ullinj, rrush, fiq, pjeshkë, kumbulla, dhe gështenja. Në vitin 2023, në 1.233 hektarë të mbjellë me perime u prodhuan 28.327 ton perime, ndërsa nga 7.365 hektarë të mbjellë me bimë foragjere u morën 276.649 ton prodhim. Ndër kulturat bimore me vlerë të lartë, qepët zënë vend të rëndësishëm dhe ofrojnë mundësi për angazhimin e grave në prodhim, përpunim dhe lidhje me tregun.[5] Po kështu, edhe bimët dekorative dhe fidanët e perimeve janë një sektor në rritje, ku fidanishtet e drejtuara nga gratë mund të jenë të suksesshme. Këto biznese kërkojnë investime fillestare relativisht modeste dhe i përshtaten mirë pjesëmarrjes së grave në fermat dhe ndërmarrjet e vogla.

Blegtoria është mjaft e zhvilluar në Shkodër, ku numërohen 13.871 gjedhë, 19.680 dhen dhe 11.865 dhi, që prodhojnë 37.251 ton qumësht në vit. Bashkia furnizon 22 ndërmarrje të përpunimit të qumështit, të cilat i shesin prodhimet e tyre në tregun lokal dhe kombëtar.

Bletaria është një sektor tjetër me potencial të madh ekonomik; në vitin 2023, nga 22.000 koshere u morën 247 ton mjaltë. Pjesëmarrja e grave në prodhim, përpunim dhe promovimin e brandit  mund të nxitet përmes stimujve financiarë, mbështetjes së bizneseve, dhe programeve trajnuese, duke u mundësuar atyre akses në tregun e brendshëm dhe në eksport. Shkodra është destinacion i rëndësishëm turistik, e njohur për trashëgiminë kulturore, monumentet, vendet historike dhe bukuritë natyrore, si Liqeni i Shkodrës.

**Qepët, si një kulturë me vlerë të lartë, ofrojnë për gratë mundësi në prodhim e përpunim.**

**Zinxhirët e vlerës së fidanëve të perimeve dhe bimëve dekorative janë një sektor ku fidanishtet e drejtuara nga gratë mund të jenë të suksesshme dhe të rriten.**



**29.5% e ndërmarrjeve aktive në Shkodër janë në pronësi ose menaxhohen nga gra.**

5. INSTAT. Shih: https://www.instat.gov.al/

Sektori i turizmit ofron mundësi unike për gratë, sidomos në ekoturizëm, hoteleri, dhe artizanat. Gratë sipërmarrëse mund të organizojnë bujtina, punishte artizanati, guida turistike ose të ofrojnë përvoja kulinare, që forcojnë njëherazi traditën vendore dhe zhvillimin ekonomik me përfshirje gjinore. Në veçanti, ekoturizmi ofron një model të qëndrueshëm biznesi, në kuadër të të cilit gratë mund të marrin pjesë në veprimtari turistike në natyrë, si përmes menaxhimit të qëndrimit në ferma, akomodimit në zona rurale, si dhe prodhimit të ushqimeve organike për vizitorët. Zhvillimi i bizneseve turistike të drejtuara nga gratë mund të forcojë pavarësinë e tyre financiare, duke ruajtur në të njëjtën kohë identitetin kulturor të zonës.

Shkodra ka 5.148 sipërmarrje aktive, por gratë janë pronare ose drejtuese në vetëm 1.518 (29,5%) prej tyre. Ekonomia e bashkisë përfshin industrinë e lehtë, prodhimin e tekstileve, zejtarinë, dhe tregtinë. Ndër pengesat kryesore ndaj fuqizimit ekonomik të grave janë aksesi i kufizuar në financa, mungesa e trajnimit në biznes, dhe rrjetet e kufizuara.

Bashkia Shkodër ka mjaft potencial për rritje ekonomike me përfshirje gjinore, duke pasur parasysh bazën ekonomike të diversifikuar të saj, ku përfshihet bujqësia, turizmi dhe ndërmarrjet e vogla të industrisë së lehtë, të cilat mund të zhvillohen më tej përmes mbështetjes së posaçme për gratë sipërmarrëse dhe pjesëmarrjen e grave në forcat e punës. Bashkia ka edhe një shoqëri civile mjaft të zhvilluar, diasporë aktive dhe nisma zhvillimore të vazhdueshme që mund të shfrytëzohen për promovimin e fuqizimit ekonomik të grave.[6]

Duke rritur pjesëmarrjen e grave në bujqësi, përpunim, turizëm dhe sipërmarrje, bashkia mund të mundësojë krijimin e një ekonomie më të barabartë dhe më të diversifikuar. Forcimi i strukturave bashkëpunuese, trajnimeve profesionale dhe aksesit në treg do t'u mundësojë grave të zgjerojnë bizneset e tyre dhe të kontribuojnë më aktivisht në zhvillimin e zonës.

Mbështetja e politikave me ndjeshmëri gjinore në bujqësi, biznes dhe turizëm jo vetëm që do të adresojë dallimet në punësim, por edhe do të sigurojë mundësi të qëndrueshme punësimi për gratë dhe komunitetin më gjerë.

**Bashkia e Shkodrës**

Sipërfaqja
**872.71 km²**
(11 njësi administrative
dhe 92 fshatra)

Population
**102,434**
(52,209 gra
dhe 50,225 burra).




6. Po aty.

# Konstatimet kryesore

**Konstatimi I** Në njësinë administrative (NJA) të Dajçit, gratë luajnë rol të rëndësishëm në prodhimin e bimëve dekorative, me mbi 20 familje të angazhuara në kultivimin e rreth 20 specieve bimore. Ndonëse këto biznese sigurojnë të ardhura të qëndrueshme për familjet, burrat dominojnë në proceset vendimmarrëse, përfshirë në lidhje me aksesin në treg dhe caktimin e çmimeve, që shpesh bazohen në burime informale, si për shembull bisedat dhe diskutimet nëpër kafene. Aksesi i kufizuar në trajnime, burime financiare dhe ekspertizë kufizon më tej mundësitë për rritje të bizneseve të drejtuara nga gratë. Aksesi në treg vazhdon të jetë pengesë e konsiderueshme. Emigrimi ka përkeqësuar më tej mungesën e forcave të punës, duke çuar në rënie të popullsisë së zonës nga 3000 banorë në vetëm 1000 banorë në vitet e fundit.[8]

**Konstatimi II** Zejtaria dhe punimet artizanale në fshatin Gur i Zi: Zona e Gurit të Zi është e njohur për punimet artizanale, me një firmë private mjaft aktive "Guri i Zi Albania", me pronare një grua (Laureta Toma), që operon kryesisht vetëm me një klient në Itali. Gratë e angazhuara në artizanat zakonisht punojnë me kohë të plotë (në kohën e intervistës ishin gjashtë punëtore) dhe me kohë të pjesshme (sipas kërkesës), me pagë rreth 10.000 lekë në muaj. Një numër i vogël grash (si Flora dhe Drane Ejlli) operojnë në mënyrë të pavarur në zinxhirin e vlerës të punimeve artizanale. Sfidat kryesore të identifikuara përfshijnë aksesin në tregun lokal dhe eksport dhe përmirësimin e kushteve të punës për punëtoret me kohë të pjesshme, përfshirë trajtimin e problemit të informalitetit.

**Konstatimi III** Gratë në Postribë merren me aktivitete ekonomike të ndryshme, si qëndistaria, prodhimi i perimeve dhe kultivimi i qepëve. Në vitin 2021 u krijua një kooperativë lokale, "Qepa e Drishtit", por të gjithë anëtarët themelues ishin burra dhe ajo ende nuk është integruar plotësisht në komunitetin bujqësor të zonës. Gratë janë të përfshira pothuaj në të gjitha fazat e zinxhirit të vlerës – që nga përgatitja e fidanëve deri në fazën e pastharjes – por ato përballen me vështirësi, si mungesa e kushteve të përshtatshme të punës, mungesa e objekteve për magazinim të produktit, luhatjet e çmimeve, mungesa në mjete e pajisje pune dhe në njohuri të teknologjive më të fundit. Qepët e prodhuara në Drisht kanë certifikimin PDO, por nuk ka ndonjë dallim të qartë nga qepët e tjera (si për shembull, qepët e Korçës) dhe nuk ka strategji për shtimin e vlerës së tyre, si krijimi i brandit apo paketimi.

**Konstatimi IV** Në fshatin Gur i Zi, rreth 100 familje (ku mbi 50% janë gra),[9] merren me prodhimin e vogël të fidanëve, kryesisht për domate, tranguj, speca, patëllxhanë dhe bostane. Gratë japin kontribut të konsiderueshëm në të gjitha fazat, përfshirë përgatitjen e tavave të fidanëve, transplantim, kontrollin e cilësisë dhe shitje. Megjithatë, zinxhiri i vlerës mbetet rudimentar dhe mbështetet në metoda tradicionale dhe teknologji të ulët. Ndër sfidat kryesore përfshihen mungesa e njohurive për praktikat bujqësore moderne, si për mbrojtjen dhe ujitjen e bimëve, si dhe mungesa e veglave të punës dhe e pajisjeve të përshtatshme. Vendimet merren mbi bazën e perceptimeve personale dhe jo mbi baza shkencore, dhe shërbimet e ekstensionit bujqësor përgjithësisht nuk janë të disponueshme. Edhe në këtë zonë popullsia ka pasur rënie si rezultat i emigracionit, dhe tani në Gur të Zi kanë mbetur vetëm rreth 5.000 banorë, nga 12.000 që kanë qenë më parë.

Pjesa 1
# **Metodologjia**

Kjo analizë u krye nga UN Women Shqipëri, në kuadër të projektit "Fuqizimi i grave për zhvillim rural në Shqipërinë e Veriut", i financuar nga Ministria Italiane e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit Ndërkombëtar, përmes Agjencisë Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor (AICS Tirana).

Me mbështetjen e personelit të bashkisë dhe bashkëpunimin e grupeve të rëndësishme të interesit nga zinxhirët e vlerës, ky studim synoi evidentimin e sektorëve ekonomikë me potencial për rritjen dhe fuqizimin e grave në bashkinë e Shkodrës. Në veçanti, ai vlerësoi pjesëmarrjen e grave në këta sektorë, pengesat dhe vështirësitë me të cilat përballen, si dhe disa zinxhirë vlerash me potencial të lartë për zhvillim. Krahas këtyre, ai ofron rekomandime reaguese gjinore për forcimin e roleve të grave dhe eliminimin e anshmërive gjinore në sistemin e tregut. Gjatë gjithë analizës u zbatua një qasje me ndjeshmëri gjinore për të siguruar që mendimet e grave, sfidat dhe mundësitë e tyre, të përfshiheshin plotësisht në vlerësimin e zinxhirit të vlerës.

Kjo qasje me ndjeshmëri gjinore ndaj zinxhirëve të vlerës bazohet kryesisht në metodologjinë e shtjelluar në *Making the Strongest Links: A Practical Guide to Mainstreaming Gender analysis in Value Chain Development* (Krijimi i hallkave më të forta – Udhëzues praktik për përfshirjen e analizës gjinore në zhvillimin e zinxhirit të vlerës) nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) botuar në vitin 2007; udhëzuesi plotësues, *Gender-Sensitive Approaches to Value Chain Development: A Complementary Guide* (Qasje me ndjeshmëri gjinore në zhvillimin e zinxhirit të vlerës: Udhëzues plotësues), po ashtu botim i ONP-së në vitin 2022; dhe *Guide for Practitioners and Interested Stakeholders* (Udhëzues për profesionistët dhe grupet e interesit) përgatitur nga USAID në vitin 2019 dhe ribotuar nga UN Women Shqipëri në vitin 2021.

Në analizë u përdor metodologjia e kërkimit sasior, me përfshirje të burimeve dytësore dhe parësore të të dhënave për të mundësuar një kuptim tërësor të dinamikave ekonomike dhe gjinore në Bashkinë Shkodër. Për të përfshirë këndvështrimet e grupeve kryesore të interesit u përdor një qasje me pjesëmarrje, e cila siguroi që konstatimet të pasqyronin përvojat reale të njerëzve në terren. U krye edhe një analizë e thelluar e raporteve zyrtare dhe burimeve statistikore, për të përcaktuar kontekstin ekonomik dhe të politikave. Ndër burimet kryesore që u analizuan ishin raporte të Institutit të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), dokumente të Bashkisë Shkodër (p.sh. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Shkodër 2015-2030, Strategjia e Zhvillimit të Territorit, Plani Social i Zonës 2020-2023, Programet Buxhetore Afatmesme (PBAM) 2023-2025 dhe 2024-2026),[7] të këshillave rajonalë, si dhe të ministrive përkatëse, si Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Krahas tyre, u analizuan edhe konstatime nga studime dhe projekte të mëparshme për zhvillimin rural dhe barazinë gjinore. Analiza e të dhënave dytësore shërbeu për krijimin e një makro-perspektive për tendencat ekonomike, përparësitë institucionale, dhe kornizat ekzistuese të politikave me ndjeshmëri gjinore në zonë. Përmes përdorimit të këtyre burimeve, studimi siguroi që kërkimi parësor të ndërtonte mbi njohuritë dhe orientimet e politikave ekzistuese. Në plotësim të të dhënave dytësore, u krye punë kërkimore në terren, përmes veprimtarive me angazhim të grupeve të interesit, vizitave në terren dhe konsultimeve me pjesëmarrje të gjerë.

Burimet parësore, d.m.th. puna në terren, shërbeu për të ndihmuar në përzgjedhjen e zinxhirëve të vlerës. Këtu u përfshinë konsultime, intervista dhe angazhimi i drejtpërdrejtë me përfaqësues të bashkisë, aktorë të zinxhirit të vlerës (gra dhe burra), prodhues dhe specialistë. Ky hap u nda në dy faza:

**Vlerësimi paraprak:** U mbajtën diskutime dhe takime me përfaqësues të bashkisë, prodhues, anëtarë të ekipit të projektit dhe organizata mbështetëse për të parë mundësitë e zinxhirëve të vlerës. Seancat në grupe fokusi me përfaqësues të bashkisë ndihmuan në identifikimin e kufizimeve, pengesave specifike gjinore dhe të mundësive që lidhen me zinxhirët ekzistues, apo të krijuar rishtas, të vlerës. Bazuar në këtë punë paraprake në terren, u identifikuan disa sektorë kyç për analizë të mëtejshme, bazuar në potencialin e tyre për zhvillim ekonomik dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse. Ndër këto ishin prodhimi i fidanëve të perimeve (veçanërisht në Gur të Zi), kultivimi i qepës (veçanërisht në Postribë), bimët dekorative (veçanërisht në Dajç), bletaria, shërbimet e lidhura me turizmin dhe zejtaria. Këtyre sektorëve iu dha përparësi për shkak të aksesit të grave në to, potencialit për krijimin e vendeve të

7. Shih: https://bashkiashkoder.gov.al///wp-content/uploads/Relacioni-permbledhes-Faza-I-PBA-2024-2026.pdf

punës, njohurive ekzistuese në zonë dhe relevancës kulturore. Në përputhje me Agjendën e ONP-së për Punë të Denjë, përzgjedhja e këtyre sektorëve thekson objektiva si:

- Promovimi i punësimit produktiv përmes sektorëve me mundësi zhvillimi dhe me intensitet të lartë pune në nivel vendor;
- Zgjerimi i aksesit në mundësi të drejta për fitim të ardhurash nga gratë dhe grupet e margjinalizuara;
- Përmirësimi i kushteve të punës dhe mbrojtjes sociale, sidomos në bujqësi dhe aktivitetet informale;
- Forcimi i zërit dhe pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje në të gjithë zinxhirët e vlerës.

Bazuar në konstatimet e vlerësimit paraprak, u organizuan vizita në terren, intervista dhe takime me përfaqësues të grupeve të interesit për të bërë vlerësimin e zinxhirëve specifikë të vlerës. Mbledhja e të dhënave parësore konsistoi në angazhime të drejtpërdrejta me gra sipërmarrëse, autoritete bashkiake dhe grupe të tjera kyçe të interesit. Aktivitetet kryesore që u kryen ishin:

- Takim në Dajç (07.02.2025) me nëntë gra që merren me kultivimin e bimëve dekorative.
- Takim me drejtorin e shërbimeve sociale, me gra në qendrën komunitare dhe administratorë vendorë (katër burra dhe gjashtë gra) në Gur të Zi dhe Postribë (13.02.2025).
- Vizitë në biznesin artizanal «Guri i Zi Albania» i drejtuar nga një grua, dhe kontakte me dhjetë gra që merren me punime artizanale dhe bujqësi (13.02.2025).
- Takim me 11 gra dhe autoritete vendore në Postribë (13.02.2025), si dhe diskutime me përfaqësues nga sektorët e arsimit dhe të shëndetësisë.
- Vizita dhe intervista në terren me dy familje (dy burra dhe një grua) që merren me prodhimin e fidanëve të perimeve në fshatin Gur i Zi (20.02.2025).
- Vizitë në familjen Plangaj (në burrë dhe dy gra) që merren me kultivimin dhe marketimin e qepës në Postribë (20.02.2025).
- Vizitë vijuese në Postribë me fermerë (në burrë dhe dy gra) që merren me prodhimin e qepës (05.03.2025).

Këto angazhime mundësuan vrojtime në terren, kryerjen e intervistave të gjysmëstrukturuara, si dhe një kuptim më të thelluar të rolit, pengesave dhe mundësive të grave në zinxhirët e përzgjedhur të vlerës. Për të validuar konstatimet, u përdor metoda e trekëndëzimit, përmes krahasimit të të dhënave parësore (punës kërkimore në terren) me të dhënat dytësore (raportet dhe statistikat zyrtare). Kjo ndihmoi të sigurohej saktësia dhe besueshmëria e përfundimeve të studimit. Krahas kësaj, konstatimet paraprake iu paraqitën edhe përfaqësuesve të bashkisë dhe partnerëve të projektit gjatë një takimi validimi më 07.02.2025, dhe komentet e sugjerimet e dhëna u përfshinë në analizën përfundimtare. Për vlerësimin e zinxhirëve potencialë të vlerës u përdorën këto kritere:

- A ka kërkesa në rritje për produktin?
- A janë të përfshira gratë në hallkat e zinxhirit të vlerës?
- A janë shumica e hallkave në zinxhirin e vlerës me bazë në bashki?
- A ka nisma të tanishme apo të kohëve të fundit që mund të shërbejnë si bazë për zinxhirin e vlerës?
- A krijohen mundësi nga zhvillimi i zinxhirit të vlerës?
- A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për zhvillim/diversifikim në zinxhirin e vlerës?

Grupet e interesit të përfshira kontribuan aktivisht për identifikimin e të gjithë përbërësve kryesorë të sistemit të tregut të zinxhirit të vlerës, duke diskutuar si për kufizimet, ashtu edhe për rolin e grave në faza të ndryshme të proceseve. Përmes vizitave në terren, vrojtimit të drejtpërdrejtë aktiviteteve të punës dhe intervistave të gjysmëstrukturuara me pyetësorë të posaçëm për aktorë të ndryshëm në zinxhirin e vlerës, u krye vlerësim lidhur me fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore në tre zinxhirë vlerash të rëndësishëm: fidanët në Gur të Zi, qepët në Postribë, dhe bimët dekorative në Dajç. Në përgjithësi, në proces u ndoqën këta hapa:

8. Të dhëna të mbledhura nga intervistat.
9. Të dhëna të mbledhura nga intervistat.

1. **Përcaktimi i objektivave dhe i grupit të synuar:** Caktimi i objektivave bazuar në synimet në nivel kombëtar dhe të bashkisë (konkretisht, përmirësimi i jetesës dhe promovimi i barazisë gjinore) dhe përcaktimi i grupit të synuar dhe i kritereve të përzgjedhjes:

2. **Grupi i synuar:** gratë dhe burrat në zonat rurale veriore;

3. **Kriteret:** rëndësia e zinxhirit të vlerës në krijimin e mundësive për fuqizimin ekonomik ët grave.

4. **Vlerësimi i situatës në bashki:** Vlerësimi fillestar i situatës në bashki dhe studimi i planeve, strategjive, studimeve të mëparshme, etj.;

5. **Sektorët kryesorë:** Identifikimi i sektorëve kryesorë përmes vlerësimit të raporteve, të dhënave dhe botimeve të ndryshme;

6. **Vlerësimi i ZV-ve:** Vlerësimi i zinxhirëve kryesorë të vlerës në sektorët e përzgjedhur përmes marrjes së mendimeve, diskutimeve, dhe grupeve të fokusit;

7. **Përzgjedhja e ZV-ve:** Përzgjedhja e një deri në dy zinxhirëve të vlerës dhe vlerësimi i mundësive, kufizimeve dhe fushave të ndërhyrjes përmes punës kërkimore në terren;

8. **Rekomandime:** Rekomandime për bashkinë lidhur me përmirësimin e zinxhirit të vlerës dhe rekomandime për projektin në lidhje me mundësitë e ndërhyrjes.

**Figura 1.** Qasja metodologjike



**Tabela 1.** Klasifikimi dhe përzgjedhja e zinxhirëve të vlerës me përdorim të kritereve me ndjeshmëri gjinore

| Kriteret | Bimët dekorative NJA Dajç | Fidanët e perimeve NJA Gur i Zi | Qepa Postribë |
|---|---|---|---|
| A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për rritje/diversifikim në zinxhirin e vlerës? | Gratë marrin pjesë në pjesën më të madhe të fazave të zinxhirit të vlerës; megjithatë të gjitha rolet vendimmarrëse dhe tregu janë nën kontrollin e burrave. | Gratë janë të përfshira aktivisht në të gjitha fazat e zinxhirit të vlerës, që nga inputet deri në treg. Ka perspektiva që të theksohet roli i tyre sidomos në fazat e sigurimit të cilësisë, tregut, dhe vendimmarrjes, përmes shtimit të aftësive të biznesit. | Gratë kontribuojnë në të gjitha fazat, që nga përgatitja e fidanishteve, farave dhe fidanëve, kultivimi, vjelja dhe proceset pas vjeljes. |
| A kanë (ose a mund të fitojnë) gratë aftësitë e nevojshme për shtimin e vlerës përmes përpunimit ose diversifikimit të produktit? | Të gjitha teknikat e kultivimit që zbatohen bazohen në përvojat e fituara nga burrat në emigracion, ose nga tradita dhe perceptimet e tyre. Gjatë misionit në terren u konstatua se gratë nuk kanë njohuri për aspektet agroteknike. Megjithatë ZV është shumë i shkurtër dhe kufizon mundësitë për shtimin e vlerës ose diversifikimin e produktit. | Gratë veprojnë mbi bazën e traditës. Nevojitet më shumë për shtimin e njohurive dhe aftësive të tyre në lidhje me praktikat më të mira dhe teknologjitë e fundit, si dhe aftësitë e biznesit dhe të marketimit. | Gratë kanë aftësi bujqësore bazë (tradicionale) por kanë nevojë për trajnime shtesë në lidhje me praktikat më të mira, përfshirë praktikat e mira në bujqësi, seleksionimin dhe paketimin në shkallë të vogël pas vjeljes, për të shtuar mundësitë e tyre ekonomike. |
| A ofron zinxhiri i vlerës mundësi të reja për gratë? | Pak. ZV nuk ofron shumë mundësi për fuqizimin e grave. Kontrollin e kanë burrat dhe sistemi i tregut (kryesisht ndërkombëtar) kufizon mundësitë e tyre. | Po. Përmes pajisjes së grave me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme në praktikat më të mira bujqësore dhe të biznesit, grupimit për bashkëpunim mes tyre dhe marrjes së roleve më aktive në vendimmarrje. | Po. Përmes pajisjes së grave me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme në praktikat më të mira bujqësore, dhe pajisjes me mjete të vogla për përmirësimin e kushteve të tyre të punës dhe për të rritur/përmirësuar prodhimin, përfshirë proceset e magazinimit dhe ato pas vjeljes për vlerë të shtuar. |
| A mund t'i përmirësojë zinxhiri i vlerës kushtet e jetesës për gratë/familjet e tyre? | Për të paktën 20 familje në Dajç, ky ZV është burimi kryesor i të ardhurave të tyre. Zgjerimi i njohurive për kërkesat e tregut mund t'i orientojë më mirë proceset vendimmarrëse të tyre. | Po. Kjo veprimtari mund të kryhet nga shtëpia dhe gratë mund të shtojnë të ardhurat e familjes. Megjithatë, nevojiten investime të vogla për vendin dhe mjetet e punës, ndërtim kapacitetesh në lidhje me teknologjitë më të fundit dhe praktikat më të mira për të shtuar produktivitetin. | Po. Sidomos me pajisje për uljen e kostos së punës dhe ngarkesës së punës së grave në proceset e kultivimit, si dhe pajisje të vogla për proceset e renditjes/klasifikimit dhe ato pas vjeljes, për shtimin e vlerës së produktit. |
| A ka një organizatë të motivuar në zinxhirin e vlerës që mund të mbështetë/përfaqësojë aktorët në zinxhirin e vlerës, e cila mund të çojë përpara zhvillimin? | Gjatë vizitave në terren dhe takimeve me gratë, nuk u identifikua ndonjë. ZV është nën kontrollin e 2-3 kompanive të mëdha në zonë (me pronarë burra). Gratë nuk treguan interes për t'u grupuar për përfaqësim më të mirë dhe për të pasur kontroll në rolet vendimmarrëse. | Administrata vendore e ka në fokus këtë ZV. Në kombinim me grupimin e grave/fermerëve, ka perspektiva për përfaqësim më të mirë dhe zhvillim të ZV-së. | Në vitin 2021 u krijua një kooperativë "Qepa e Drishtit", por të gjithë anëtarët themelues ishin burra dhe ajo ende nuk është integruar plotësisht në komunitetin bujqësor të zonës. Duhet punuar për rritjen e përfaqësimit të grave në kooperativë dhe bashkëpunimin midis të gjithë kultivuesve të qepës. |
| A ka mundësi të bëhen ndryshime me investime të vogla? | Pak. Do të nevojiteshin investime për pajisje për gratë sipërmarrëse të vogla dhe ato të varfra, për serra-fidanishte për fazën e parë të rritjes, trajnime dhe ndërtim kapacitetesh për praktikat më të mira dhe eksplorimin e tregjeve të reja në lidhje me kërkesat e tregut dhe stabilitetin e çmimeve. | Po. Nevojiten investime kryesisht për të përmirësuar kushtet e punës për gratë, për të shtuar njohuritë dhe aftësitë e tyre për praktikat më të mira, dhe për të zbatuar teknologjitë më të fundit në prodhimin e vogël. | Po. Pajisje të vogla për uljen e kostove të punës dhe ngarkesës së grave në proceset e kultivimit, përmirësimin e mjediseve të magazinimit, dhe pajisje të vogla për proceset e renditjes/klasifikimit dhe ato pas vjeljes, për shtim të vlerës së produktit. |

**Tabela 2.** Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e bimëve dekorative

| Pyetjet | Pikët* | Pesha** | Gjithsej | Përshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| A është numri i grave të punësuara në zinxhirin e vlerës relativisht i lartë? | 3 | 2 | 6 | Gratë e punësuara në ZV përbëjnë 50% të forcës punëtore. Disa janë të vetëpunësuara në biznesin familjar, ndërsa disa të tjera në fidanishtet më të mëdha në zonë. |
| A ka shumë gra sipërmarrëse në zinxhirin e vlerës? | 1 | 2 | 2 | Ndonëse përqindja e grave aktive në ZV është e lartë dhe ato janë të angazhuara në të gjitha proceset në hallkat e mesit të ZV-së, sipërmarrja mbetet tek burrat. Gjatë vizitës në terren u identifikua vetëm një grua sipërmarrëse (nënë e vetme). |
| A kanë gratë kontroll mbi pajisjet dhe asetet? | 2 | 2 | 4 | Mesatar. Pronësia mbi tokën mbetet problem, që kufizon kontrollin mbi asetet. Pajisjet dhe veglat e punës janë nën kontroll të përbashkët. |
| A kanë (apo a mund të fitojnë) gratë aftësitë e nevojshme për ndonjë shtim interesant të vlerës përmes përpunimit ose diversifikimit të produktit? | 1 | 1 | 1 | I ulët. Gratë mund të shtojnë aftësitë e tyre në praktikat më të mira të kultivimit, por ZV është shumë i shkurtër dhe kufizon mundësitë për shtim të vlerës ose diversifikim të produktit. |
| A kanë kontroll gratë mbi të ardhurat nga shitjet dhe mbi sipërmarrjen? | 2 | 2 | 4 | I mesëm deri i ulët. Sipas informacionit nga intervistat me gratë, burrat kanë kontroll mbi shitjet dhe biznesin; vetëm një numër i vogël menaxhojnë bashkërisht me kryefamiljarin (burrë). |
| A mund të kryhet puna afër shtëpisë? | 3 | 1 | 3 | Po, në shumicën e rasteve fidanishtet janë afër shtëpisë. |
| A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për hyrjen e sipërmarrëseve të varfra (prodhim i vogël, kosto e ulët për fillim biznesi, nuk kërkon investime kapitale madhore, me përdorim aftësish teknologjike të ulëta)? | 3 | 1 | 3 | Fidanët importohen (nga Italia) dhe kanë kosto të konsiderueshme. Ndërsa proceset e mëtejshme janë kryesisht punë krahu, plehërim dhe mbrojtje e bimëve. |
| A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për përfshirjen e grave në të (koha dhe aftësia për të lëvizur, aksesi në teknologji dhe asete, kufizimet kulturore)? | 2 | 2 | 4 | Mesatar. Gratë janë të përfshira edhe tani në ZV. Megjithatë, mbetet barriera e aksesit në asete, teknologji, pajisje dhe informacion për tregun. |
| A ofron ky ZV mundësi të reja për gratë? | 2 | 4 | 8 | I ulët. ZV nuk u ofron shumë mundësi për fuqizimin e grave. Kontrollin e kanë burrat dhe sistemi i tregut (kryesisht ndërkombëtar) i kufizon mundësitë e tyre. |
| A është aktiviteti në ZV në përputhje me kushtet e jetesës (të ardhurat gjatë vitit, përdorimi i punës së familjarëve, kthim i shpejtë i investimit, ruajtja e paprekur e mjedisit)? | 2 | 2 | 4 | Mesatar. Kthimi i investimit është i ngadalshëm. Disa kultivarë duan deri në katër vjet të rriten dhe tregu nuk është i qëndrueshëm. |
| A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për rritje/diversifikim në zinxhirin e vlerës? | 2 | 1 | 2 | I ulët. Njësoj si më lart. |
| A ka norma gjinore (për shembull, ngecje në 'punët e grave') që i pengojnë gratë të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e zinxhirit të vlerës? | 2 | 2 | 4 | Rolet e burrave në ZV (vendimmarrja) dhe fakti që sistemi i tregut është larg vendit ku janë gratë, kufizojnë mundësitë e tyre. |
| Totali i përgjithshëm i potencialit gjinor | | | 45/102 | |

** Pikëzimi: 0 (shumë i ulët, jo, aspak) deri në 5 (shumë i lartë, po, shumë i rëndësishëm).*

*** Pesha nga 1 në 4, sipas rëndësisë dhe impaktit të secilës prej pikave të mësipërme në arritjen e objektivave të përcaktuara.*[10]

**Tabela 3.** Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e fidanëve të perimeve

| Pyetjet | Pikët* | Pesha** | Gjithsej | Përshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| A është numri i grave të punësuara në zinxhirin e vlerës relativisht i lartë? | 3 | 2 | 6 | Gratë që punojnë në ZV përbëjnë mbi 50% të forcës punëtore, kryesisht të angazhuara në biznese familjare. |
| A ka shumë gra sipërmarrëse në zinxhirin e vlerës? | 2 | 2 | 4 | Ndonëse përqindja e grave aktive në ZV është e lartë dhe ato janë të angazhuara në të gjitha proceset e hallkave të mesme të ZV-së, sipërmarrja mbetet në duart e kryefamiljarëve (burra). |
| A kanë gratë kontroll mbi pajisjet dhe asetet? | 2 | 2 | 4 | Duke pasur parasysh se në shumicën e rasteve pronarë të fermave janë burrat, gratë nuk kanë të drejta pronësore. Megjithatë, ato mund të kenë kontroll mbi pajisjet që përdoren në fazat ku janë të angazhuara. |
| A kanë (apo a mund të fitojnë) gratë aftësitë e nevojshme për ndonjë shtim interesant të vlerës përmes përpunimit ose diversifikimit të produktit? | 3 | 1 | 3 | Gratë zotërojnë njohuri dhe aftësi tradicionale, por duhet të trajnohen për teknologjitë më të fundit, diversifikimin e produkteve (shartimin e fidanëve) dhe praktikat më të mira bujqësore. |
| A kanë kontroll gratë mbi të ardhurat nga shitjet dhe mbi sipërmarrjen? | 2 | 2 | 4 | Sipërmarrjet janë kryesisht nën kontrollin e burrave. Vendimet për çmimin e shitjes së produktit diktohen nga tregu dhe cilësia e fidanëve. |
| A mund të kryhet puna afër shtëpisë? | 3 | 1 | 3 | Po, shtëpitë dhe fidanishtet janë ngjitur me njëra-tjetrën, që lehtëson aksesin. Tregu është në Shkodër dhe ndonjëherë në qytetet fqinje. |
| A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për hyrjen e sipërmarrëseve të varfra (prodhim i vogël, kosto e ulët për fillim biznesi, nuk kërkon investime kapitale madhore, me përdorim aftësish teknologjike të ulëta)? | 3 | 1 | 3 | Krijimi i një fidanishteje tradicionale ka barriera të ulëta të hyrjes për sipërmarrësit e varfër, por kjo vetëm për prodhim në shkallë të vogël. Fillimi i një aktiviteti më të orientuar nga tregu do të kërkonte kosto fillestare që lidhen me krijimin e një fidanishteje plotësisht funksionale, përfshirë një serrë të vogël, si dhe pajisje bazë. |
| A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për përfshirjen e grave në të (koha dhe aftësia për të lëvizur, aksesi në teknologji dhe asete, kufizimet kulturore)? | 3 | 2 | 6 | Nuk ka pengesa madhore sa u përket dallimeve gjinore, sepse gratë janë të përfshira në pothuaj të gjitha fazat. |
| A ofron ky ZV mundësi të reja për gratë? | 3 | 4 | 12 | Po. Përmes pajisjes së grave me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme në praktikat më të mira bujqësore dhe të biznesit, grupimit për bashkëpunim mes tyre dhe roleve më aktive në vendimmarrje. |
| A është aktiviteti në ZV në përputhje me kushtet e jetesës (të ardhurat gjatë vitit, përdorimi i punës së familjarëve, kthim i shpejtë i investimit, ruajtja e paprekur e mjedisit)? | 4 | 2 | 8 | Po. Kthimi i investimeve është i shpejtë, duke pasur parasysh ciklin e shkurtër të jetës së fidanëve të perimeve. Zbatimi i praktikave më të mira bujqësore mund të trajtojë edhe problemet me menaxhimin e mbeturinave. |

10. Përcaktimi i zinxhirëve prioritarë të vlerës mbi bazën e mundësive që ofrojnë për promovimin e barazisë gjinore si një mënyrë efektive për të nxjerrë në pah faktorët që kanë ndikim pozitiv në punësimin dhe të ardhurat e grave dhe të vajzave. Për këtë qëllim është përdorur një sistem klasifikimi nga 1 në 4 (ku 1 është 'i ulët', 2 'mesatar', 3 'mirë', dhe 4 'shumë mirë'). Bazuar në: Women's Inclusion and Value Chain Improvement in Albania – A Guide for Practitioners and Stakeholders (Përfshirja e grave dhe përmirësimi i zinxhirit të vlerës në Shqipëri – Udhëzues për punonjësit dhe palët e interesit). USAID 2019 dhe UN Women 2021.

| Pyetjet | Pikët* | Pesha** | Gjithsej | Përshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për rritje/diversifikim në zinxhirin e vlerës? | 3 | 1 | 3 | Po. Gratë kanë njohuri dhe aftësi tradicionale, por u nevojitet për trajnim për teknologjitë më të fundit, diversifikimin e produkteve (shartimin e fidanëve), dhe praktikat më të mira bujqësore. Pajisja e grave me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme në praktikat më të mira bujqësore dhe të biznesit, grupimi i tyre për bashkëpunim dhe rol më aktiv në vendimmarrje. |
| A ka norma gjinore (për shembull, ngecje në 'punët e grave') që i pengojnë gratë të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e zinxhirit të vlerës? | 3 | 2 | 6 | Gratë edhe tani janë të angazhuara në zinxhirin e vlerës pa kufizime tradicionale madhore. Mbetet ende pengesë për gratë aksesi në informacion, shërbime të ekstensionit, teknologji, transport dhe kredi. |
| Totali i përgjithshëm i potencialit gjinor | | | 63/102 | |

** Pikëzimi: 0 (shumë i ulët, jo, aspak) deri në 5 (shumë i lartë, po, shumë i rëndësishëm).*

*** Pesha nga 1 në 4, sipas rëndësisë dhe impaktit të secilës prej pikave të mësipërme në arritjen e objektivave të përcaktuara.*[11]

**Tabela 4.** Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e qepës

| Pyetjet | Pikët* | Pesha** | Gjithsej | Përshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| A është numri i grave të punësuara në zinxhirin e vlerës relativisht i lartë? | 3 | 2 | 6 | Po. Gjatë punës në terren u evidentua që gratë janë të përfshira në pjesën më të madhe të ZV-së. |
| A ka shumë gra sipërmarrëse në zinxhirin e vlerës? | 3 | 2 | 6 | Po. Ndonjëherë gratë marrin tokë me qira për të kultivuar qepë. |
| A kanë gratë kontroll mbi pajisjet dhe asetet? | 2 | 2 | 4 | Mesatar. Duke pasur parasysh se në shumicën e rasteve pronarët e fermave janë burra, gratë nuk kanë të drejta pronësore. Megjithatë gratë dhe burrat kanë kontroll të përbashkët të pajisjeve që përdoren në fazat ku ato janë të përfshira. |
| A kanë (apo a mund të fitojnë) gratë aftësitë e nevojshme për ndonjë shtim interesant të vlerës përmes përpunimit ose diversifikimit të produktit? | 3 | 1 | 3 | Gratë kanë aftësitë bazë në praktikat bujqësore, por nëpërmjet trajnimeve të nevojshme mund t'i zhvillojnë më tej aftësitë e tyre në praktikat më të mira bujqësore, punët pas vjeljes, renditjen/klasifikimin dhe paketimin e produktit. |
| A kanë kontroll gratë mbi të ardhurat nga shitjet dhe mbi sipërmarrjen? | 2 | 2 | 4 | Mesatar. Në shumicën e rasteve biznesi është familjar, por ndonjëherë gratë veprojnë në mënyrë të pavarur dhe kanë kontroll mbi shitjet dhe biznesin. |
| A mund të kryhet puna afër shtëpisë? | 3 | 1 | 3 | Po. Parcelat e tokës gjenden afër shtëpive të tyre. |

*(Vazhdon në faqen tjetër)*

11. Përcaktimi i zinxhirëve prioritarë të vlerës mbi bazën e mundësive që ofrojnë për promovimin e barazisë gjinore si një mënyrë efektive për të vënë në pah faktorët që kanë ndikim pozitiv në punësimin dhe të ardhurat e grave dhe të vajzave. Për këtë qëllim është përdorur një sistem klasifikimi nga 1 në 4 (ku 1 është 'i ulët', 2 'mesatar', 3 'mirë', dhe 4 'shumë mirë'). Bazuar në: Women's Inclusion and Value Chain Improvement in Albania – A Guide for Practitioners and Stakeholders (Përfshirja e grave dhe përmirësimi i zinxhirit të vlerës në Shqipëri – Udhëzues për punonjësit dhe palët e interesit). USAID 2019 dhe UN Women 2021.

| Pyetjet | Pikët* | Pesha** | Gjithsej | Përshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për hyrjen e sipërmarrëseve të varfra (prodhim i vogël, kosto e ulët për fillim biznesi, nuk kërkon investime kapitale madhore, me përdorim aftësish teknologjike të ulëta)? | 5 | 1 | 5 | Po. Fillimi i kultivimit të qepëve nuk kërkon investime madhore. Kostot lidhen më shumë me përgatitjen e tokës, farat/fidanët, dhe forcat e punës. |
| A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për përfshirjen e grave në të (koha dhe aftësia për të lëvizur, aksesi në teknologji dhe asete, kufizimet kulturore)? | 3 | 2 | 6 | Po, duke pasur parasysh koston e ulët fillestare, dhe se gratë tradicionalisht janë përfshirë në këtë ZV. Megjithatë, mungesa e aksesit në informacion, në shërbime të ekstensionit bujqësor, teknologji, transport dhe kredi, ende përbëjnë barriera, kryesisht për gratë. |
| A ofron ky ZV mundësi të reja për gratë? | 3 | 4 | 12 | Gratë mund t'i shtojnë aftësitë e tyre përmes trajnimeve për praktikat e mira bujqësore, si edhe të shtojnë vlerën e produktit përmes diversifikimit dhe paketimit. |
| A është aktiviteti në ZV në përputhje me kushtet e jetesës (të ardhurat gjatë vitit, përdorimi i punës së familjarëve, kthim i shpejtë i investimit, ruajtja e paprekur e mjedisit)? | 4 | 2 | 8 | Po. Kthimi i investimit bëhet brenda sezonit/vitit. |
| A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për rritje/diversifikim në zinxhirin e vlerës? | 4 | 1 | 4 | Po. Gratë kanë aftësitë bazë në praktikat bujqësore; përmes trajnimeve të nevojshme ato mund të zhvillojnë më tej aftësitë e tyre për praktikat më të mira bujqësore, menaxhimin e fermave, proceset e punës pas vjeljes, renditjen/klasifikimin dhe paketimin e produktit, dhe ka perspektivë për rritjen e rolit të tyre në ZV. |
| A ka norma gjinore (për shembull, ngecje në 'punët e grave') që i pengojnë gratë të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e zinxhirit të vlerës? | 4 | 2 | 8 | Aktualisht gratë janë të përfshira aktivisht në kultivimin e qepës pa kufizime të mëdha tradicionale. |
| Totali i përgjithshëm i potencialit gjinor | | | 69/102 | |

** Pikëzimi: 0 (shumë i ulët, jo, aspak) deri në 5 (shumë i lartë, po, shumë i rëndësishëm).*

*** Pesha nga 1 në 4, sipas rëndësisë dhe impaktit të secilës prej pikave të mësipërme në arritjen e objektivave të përcaktuara*[12]

Bazuar në tabelat e vlerësimit në lidhje me fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore në zinxhirët e vlerës, zinxhiri i vlerës i fidanëve të perimeve në Gur të Zi dhe ai i qepës në Postribë tregojnë potencial të konsiderueshëm për fuqizimin e grave dhe zhvillimin e këtyre zinxhirëve të vlerës.

12. Përcaktimi i zinxhirëve prioritarë të vlerës mbi bazën e mundësive që ofrojnë për promovimin e barazisë gjinore si një mënyrë efektive për të vënë në pah faktorët që kanë ndikim pozitiv në punësimin dhe të ardhurat e grave dhe të vajzave. Për këtë qëllim është përdorur një sistem klasifikimi nga 1 në 4 (ku 1 është 'i ulët', 2 'mesatar', 3 'mirë', dhe 4 'shumë mirë'). Bazuar në: Women's Inclusion and Value Chain Improvement in Albania – A Guide for Practitioners and Stakeholders (Përfshirja e grave dhe përmirësimi i zinxhirit të vlerës në Shqipëri – Udhëzues për punonjësit dhe palët e interesit). USAID 2019 dhe UN Women 2021.

Pjesa 2

# Analizë e Zinxhirit të Vlerës të Fidanëve të Perimeve

# 1. Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirit të Vlerës të Fidanëve të Perimeve

Prodhimi i fidanëve të perimeve ka evoluar me kalimin e viteve. Sipërfaqja gjithsejtë e fidanishteve aktualisht është 117.500 m2. Prodhimi i fidanëve varion nga 55,1 deri në 96,1 milion fidanë. Farat zakonisht importohen nga distributorë të mëdhenj, ose përmes tyre.

Numri i furnizuesve të inputeve është relativisht i lartë, por disa prej tyre janë edhe prodhues dhe shitës të farave dhe fidanëve cilësorë. Fidanët e perimeve prodhohen në të paktën 17 fidanishte, si Agroblend (Vorë), Lisar Seedlings (Divjakë), Agrokoni (Durrës), groAlba (Divjakë), Saimir Bitri (Divjakë), Ali Lico (Divjakë), etj.[13]

Një nga sfidat më të mëdha në sektorin e bujqësisë është cilësia e inputeve, sidomos e produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB) dhe fidanëve. Për perimet e serrave – që janë produkti me orientim më të fortë për eksport në sektorin e hortikulturës – theksi po vihet gjithnjë e më shumë në përdorimin e inputeve me cilësi të lartë. Fidanët cilësorë janë inpute me rëndësi kyçe për prodhuesit komercialë. Megjithatë, prodhuesit e vegjël të perimeve, që përballen me kufizime financiare, shpesh blejnë fara dhe i prodhojnë fidanët në fermë. Ndonëse mund të duket sikur fermerët kursejnë ose ulin disa prej kostove me këtë qasje, farat e prodhuara në fermë mund të rezultojnë me prodhim dhe rendiment shumë më të ulët.

Megjithatë, edhe në rastin e fermerëve që i blejnë farat, ka raste prodhimi të dështuar, ose për shkak të cilësisë së fidanëve, ose sepse ata nuk janë të përshtatshëm për kushtet/mjedisin konkret. Në rastin e perimeve, ka një numër furnizuesish që shesin fara të importuara, përfshirë edhe nga prodhues të mëdhenj e të njohur ndërkombëtarë. Disa furnizues farash bashkëpunojnë me pikat e grumbullimit për t'i orientuar bashkërisht fermerët drejt varieteteve më të kërkuara në treg.[14]

**Prodhimi i fidanëve në njësinë administrative të Gurit të Zi është bërë një nga mënyrat kryesore të fitimit të jetesës në bujqësi, me përfshirjen e rreth 100 familjeve, ku gratë përbëjnë të paktën 50% të personave të angazhuar.**

### Gratë dhe Prodhimi i Fidanëve në Gurin i Zi: Sfidat dhe Kontributet

Në njësinë administrative të Gurit të Zi, prodhimi i fidanëve është bërë një nga mënyrat kryesore të fitimit të jetesës në bujqësi, me përfshirjen e rreth 100 familjeve, ku gratë përbëjnë të paktën 50% të personave të angazhuar, sipas të dhënave nga intervistat. Për shumë prej tyre, kjo është jo vetëm një veprimtari sezonale, por burim kryesor të ardhurash për mbajtjen e ekonomive familjare. Kultivohen kryesisht fidanë domatesh, trangujsh, specash, patëllxhanësh dhe bostanesh – kulturat bujqësore më të zakonshme në kalendarin bujqësor të rajonit. Me gjithë shkallën modeste të aktivitetit, ky sistem i lokalizuar luan rol të rëndësishëm në vijimësinë e prodhimit ushqimor në zonë. Në qendër të këtij cikli prodhimi është

13. *Fruit and Vegetable Sector Study Report, 2021* (Raport i studimit të sektorit të frutave dhe perimeve, 2021, përgatitur nga AGT SpA & DSA për MBZHR). Gjendet në: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/07-Fruit-Vegetable-Report__FINAL.pdf
14. Po aty.

**Gratë luajnë një rol qëndror në të gjitha fazat e prodhimit të fidanëve, por sektori mbetet informal dhe me burime të pakta, duke pasur nevojë urgjente për formalizim për të përmbushur standardet kombëtare dhe për të siguruar qëndrueshmërinë.**

kontributi i grave, të cilat punojnë në të gjitha fazat e procesit të prodhimit të fidanëve. Që nga përgatitja e kontejnerëve dhe menaxhimi i shtretërve në fidanishte, tek transplantimi, sigurimi i cilësisë dhe shitja, gratë mbajnë mbi shpatulla një pjesë të madhe të përgjegjësive fizike dhe organizative. Po kështu, ato merren drejtpërdrejt me marketing dhe marrëdhëniet me klientët, duke i shitur prodhimet e tyre tek fermerët e zonës ose në tregjet lokale dhe rajonale, shpesh duke i menaxhuar transaksionet financiare me shumë pak ndihmë të jashtme. Megjithatë, zinxhiri i vlerës i fidanëve të perimeve në Gurin e Zi mbetet më së shumti informal dhe tradicional. Veglat e punës që përdoren janë elementare, shpesh të bëra me dorë ose të improvizuara, dhe puna në bujqësi bazohet kryesisht në punën e krahut. Vendimet e rëndësishme – që nga zgjedhja e farave deri tek koha e ujitjes – merren bazuar në njohuritë e trashëguara ose përvojat individuale, dhe jo në shkencën e agronomisë. Mungesa e shërbimeve të strukturuara të ekstensionit bujqësor bën që fermerët shpesh të kërkojnë këshilla prej shitësve të inputeve, të cilët, ndonëse të dobishëm, nuk mund të japin ekspertizën teknike të nevojshme për një prodhim të qëndrueshëm dhe cilësor të fidanëve. Një kufizim madhor teknik është përdorimi i përhapur i farave të pacertifikuara, shpesh të ruajtura nga stinët e mëparshme. Kjo praktikë jo vetëm që bart rreziqet e transmetimit të sëmundjeve dhe degradimit gjenetik, por është edhe në kundërshtim me kornizën rregullatore të caktuar nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve.

Sipas Ligjit nr. 10416, datë 07.04.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor" dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij, të gjithë prodhuesit e fidanëve duhet të përdorin material riprodhues bimor të regjistruar dhe të certifikuar. Përdorimi dhe marketimi i fidanëve të pacertifikuar është në kundërshtim me ligjin dhe mund të sjellë si pasojë gjoba dhe kufizim të aksesit në treg për prodhuesit. Gjithashtu, në bazë të Ligjit nr. 7659, datë 12.01.1993, "Për farat dhe fidanët" çdo varietet i ri ose i ruajtur për qëllime shumëzimi në nivel vendor, duhet të miratohet dhe të regjistrohet në Katalogun Kombëtar të Specieve dhe Varieteteve, pas miratimit nga komisioni përkatës i testimit. Ky kuadër ligjor ka për qëllim të garantojë sigurinë fitosanitare, integritetin gjenetik dhe vlerën agronomike të materialit mbjellës që shpërndahet në vend. Në Gurin e Zi, shtretërit në fidanishte zakonisht ndërtohen me ripërdorim të kubikëve ose të ngastrave të dheut, dhe shumë pak vëmendje i kushtohet sterilizimit apo cilësisë së nënshtresave. Si njohuritë mbi standardet e përgatitjes së dheut, ashtu edhe zbatimi i tyre është i kufizuar, që çon në nivele nënoptimale të mbirjes dhe cenueshmëri më të lartë nga sëmundjet dhe dëmtuesit. Ujitja bëhet në mënyrë manuale, shpesh në mënyrë jo konsistente, dhe nuk ka një sistem të strukturuar për rregullimin e prurjes së ujit. Kontrollimi i dëmtuesve është reagues dhe bazohet në metoda tradicionale, dhe jo në plane parandaluese për mbrojtjen e bimëve.

Gratë, të cilat mbajnë peshën kryesore në këtë proces pune të rëndë, punojnë në kushte fizike të vështira. Rolet e tyre janë të domosdoshme, por shpesh nuk vlerësohen sa duhet, dhe aksesi i tyre në trajnime teknike, pajisje moderne apo mjete mbrojtëse mbetet minimal. Krahas kësaj, komuniteti përballet edhe me sfida të përgjithshme demografike. Emigracioni ka përgjysmuar popullatën e Gurit të Zi nga rreth 12.000 në rreth 5.000 banorë, duke krijuar edhe më shumë ngarkesë për forcat e punës dhe duke e bërë më të vështirë përcjelljen e njohurive bujqësore tek brezat e rinj.

Me gjithë këto mangësi sistemike, praktika e prodhimit të fidanëve në Gur të Zi është tregues i forcës mbijetuese, aftësive krijuese dhe angazhimit të fuqishëm lokal. Megjithatë, për t'iu përmbajtur standardeve kombëtare për bujqësinë dhe për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë, nevojitet urgjentisht formalizimi i praktikave në përputhje me kërkesat ligjore.

**Tabela 5.** Analiza SWOT e zinxhirit të vlerës së fidanëve

| Pikat e Forta | Pikat e Dobëta |
|---|---|
| **Angazhim i lartë i komunitetit:** rreth 100 familje të angazhuara, ku gratë përbëjnë mbi 50%, që tregon nivel të lartë interesi dhe pjesëmarrjeje.<br>**Kontributi i konsiderueshëm i grave:** gratë janë të përfshira aktivisht në të gjitha fazat – përgatitje, transplantim, kontroll cilësie, dhe shitje.<br>**Baza e njohurive tradicionale:** praktikat e ruajtjes së farave dhe përvojat e brezave janë shtylla të prodhimit.<br>**Tipa të ndryshme fidanësh:** fokusi në kultivarë për të cilët ka kërkesë të lartë, si domatet, trangujt, specat, patëllxhanët, dhe bostanet.<br>**Tregu:** Afërsia me tregjet lokale dhe me fermerët që i përdorin këta fidanë, si dhe kërkesa e vazhdueshme për fidanë cilësorë.<br>**Aktivitet që gjeneron të ardhura:** Për shumë familje dhe gra të zonës prodhimi i fidanëve është burimi kryesor i jetesës. | **Mospërmbushja e kërkesave ligjore:** Përdorim i gjerë i farave të pacertifikuara dhe varieteteve të paregjistruara.<br>**Niveli i ulët i teknologjisë dhe mekanizimit:** procese manuale, numër i kufizuar veglash dhe mjetesh pune, dhe infrastrukturë e pazhvilluar sa duhet e fidanishteve.<br>**Zinxhir informal vlerash:** Mungesë e një sistemi të strukturuar të tregut dhe regjistrimit; gjurmueshmëri dhe kontroll cilësie i kufizuar.<br>**Njohuri të pamjaftueshme të praktikave moderne të punës, sidomos nga gratë e përfshira në ZV:** ekspertizë e kufizuar në ujitje, menaxhim të dëmtuesve, sterilizim dhe shëndetin e tokës.<br>**Mungesa e shërbimeve të ekstensionit:** Mungesë e aksesit në udhëzime nga specialistët dhe në rekomandime shkencore.<br>**Nënvlerësimi i punës së grave:** Megjithëse roli i tyre është qendror, gratë bëjnë punë të rënda fizike, me mbështetje dhe njohje minimale të kontributit të tyre.<br>**Veprimtari e vogël dhe e kufizuar,** me orientim fermerët e vegjël si treg i synuar.<br>**Mungesë e burimeve financiare** dhe, rrjedhimisht investime të pamjaftueshme në teknologji.<br>**Interes i ulët nga të rinjtë** për bujqësinë dhe nivel i lartë emigracioni.<br>**Varësia e tregut nga cilësia e fidanëve**, me sisteme të kufizuara për sigurimin e cilësisë.<br>**Kosto të larta të inputeve** që ndikojnë në normën e fitimit.<br>**Cenueshmëri e shumicës së fidanishteve** nga kushtet klimatike. |

| Mundësitë | Kërcënimet |
|---|---|
| **Formalizimi i prodhimit të fidanëve:** ka potencial për regjistrimin e fidanishteve dhe varieteteve në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve.<br>**Trajnime dhe ndërtim kapacitetesh për gratë fermere dhe familjet e tyre:** futja e teknikave bujqësore moderne dhe ndërgjegjësimi për ligjet në fuqi mund të shtojë produktivitetin dhe respektimin e ligjit.<br>**Programe mbështetëse me ndjeshmëri gjinore:** ndërhyrjet e fokusuara mund të përmirësojnë kushtet e punës dhe fuqizimin ekonomik të grave.<br>**Zhvillimi i varieteteve vendore të certifikuara:** njohja dhe regjistrimi i kapaciteteve gjenetike vendore (p.sh. i kultivarëve tradicionalë të zonës) mund të ruajë praktikat tradicionale dhe njëkohësisht të garantojë cilësinë.<br>**Potencial për krijimin e kooperativave:** organizimi i prodhuesve në grupe mund të përmirësojë aksesin në tregje, financim, vegla pune dhe mbështetje ligjore. | **Rrezik ligjor dhe i përjashtimit nga tregu:** Vazhdimi i përdorimit të farave të pacertifikuara mund të çojë në gjoba dhe akses të kufizuar të grave fermere dhe familjeve të tyre në treg.<br>**Rreziqet për sigurinë në punë dhe shëndetin e grave:** gratë shpesh punojnë pa veshje mbrojtëse apo vegla pune ergonomike në fidanishte, që i ekspozon ndaj kimikateve të dëmshme, shkakton lodhje fizike dhe probleme shëndetësore afatgjata që mund të ulin produktivitetin dhe të çojnë në tërheqjen e tyre prej punës bujqësore.<br>**Cenueshmëria nga dëmtuesit dhe sëmundjet:** Mungesa e mbrojtjes parandaluese të bimëve shton rreziqet për prodhimin.<br>**Sfidat klimatike:** Pa sistemet e duhura, ndryshimet e motit rrezikojnë mbijetesën e fidanëve.<br>**Shpopullimi dhe emigracioni:** Emigrimi i të rinjve pakëson numrin e forcave të disponueshme të punës dhe përcjelljen e njohurive tek brezi i ri.<br>**Konkurrenca në treg:** prodhimet që nuk u përmbahen kërkesave ligjore mund të humbin në treg kundrejt furnizuesve të certifikuar. |

# 2. Diagram i ZV të Farave dhe Fidanëve

Në vijim paraqitet një diagram gjithëpërfshirës i hallkave të zinxhirit të vlerës, aktorëve, faktorëve mbështetës dhe problemeve kryesore të identifikuara, bazuar në konstatimet nga intervistat me grupet e interesit dhe agjencitë mbështetëse vendore, punën kërkimore në terren, dhe konsultimet me specialistët.

Diagrami paraqet grupet kryesore të interesit, fazat që nga inputet deri në tregun përfundimtar, dhe ndihmon në identifikimin e vështirësive që dalin gjatë hallkave të prodhimit. Vlerat numerike sipër kutive përfaqësojnë kostot dhe vlerën e shtuar për çdo fazë.

**Figura 2.** Diagram i zinxhirit të vlerës të fidanëve të perimeve në Guri i Zi



## 2.1 AKTORËT NË ZINXHIRIN E VLERËS

Sikurse shihet në diagramin më lart, zinxhiri i vlerës i fidanëve të perimeve në Gurin e Zi është i organizuar në një numër të vogël nivelesh, konkretisht:

- Inputet
- Prodhimi
- Tregu

Më poshtë vijon një përshkrim i shkurtër i secilit aktor në zinxhirin e vlerës dhe i agjencive mbështetëse në sistemin e tregut, që nga inputet deri tek shpërndarja në treg.

Në sektorin e furnizimit të inputeve ka një kombinim aktorësh formalë dhe informalë. Dyqanet e agro-inputeve shërbejnë si burimi kryesor i farave dhe materialeve bazë, por zakonisht farat janë të pacertifikuara dhe mungon ekspertiza teknike. Shumë fermerë vazhdojnë praktikën tradicionale të ruajtjes dhe shkëmbimit të farave nga vjeljet e mëparshme, me gjithë kufizimet ligjore **për këtë praktikë**. Depërtimi i kompanive të regjistruara të farave dhe i Entit Shtetëror i Farave në zonë është i ulët, duke krijuar një boshllëk në aksesin në materiale mbjellëse të certifikuara. Fidanishtet e regjistruara, që funksionojnë në bazë të rregulloreve të rrepta (Ligji nr. 10416/2011), duhet të marrin fara të certifikuara nga furnizues të miratuar dhe të mbajnë regjistra të hollësishëm të inputeve të tyre. Këto praktika formale janë në kontrast të thellë me sistemin informal **që mbizotëron**, ku fermerët përdorin si medium rritës çfarëdo kontejnerësh **të disponueshëm (shpesh qese plastike të përshtatura) dhe dheun lokal**, **të patrajtuar.** Mungesa e standardizimit të inputeve kontribuon në cilësinë e paqëndrueshme **të fidanëve në rajon**. Në prodhimin e fidanëve janë të përfshirë operatorë të regjistruar dhe të paregjistruar, me dallime të theksuara në aktivitetin e tyre. Operatorët e fidanishteve të regjistruara duhet të përmbushin standarde të rrepta, si **përdorimi i farave të certifikuara, mbajtja e protokolleve të duhur sanitarë, dhe mbajtja e evidencave të prodhimit për qëllime të inspektimit. A**ta zakonisht investojnë për infrastrukturë më të mirë, si serra me ngrohje dhe tava **të përshtatshme për** fidanët. Në ndryshim prej tyre, shumica e prodhuesve të vegjël – kryesisht fermerë të vegjël – operojnë jashtë këtij sistemi formal. Metodat e tyre të prodhimit vazhdojnë të jenë tradicionale dhe të bazuara në punën e krahut, ujitjen me dorë, vlerësimin me sy **të cilësisë, dhe metoda shtëpiake për luftimin e dëmtuesve. Gratë mbajnë ngarkesën më të madhe**

**Gratë kryesisht kryejnë punë intensive me fidanët, shpesh pa akses në mjete dhe pajisje mbrojtëse.**

**të kësaj pune të rëndë fizike, shpesh pa** pasur akses në vegla që lehtësojnë punën e krahut, apo mjete mbrojtëse. Fidanishtet e regjistruara zakonisht kanë klientelë më të qëndrueshme, si edhe kontrata me ferma komerciale, kurse prodhuesit informalë shesin përmes kanaleve vendore të paparashikueshme. Dallimet në njohuri ndërmjet këtyre dy grupeve janë të konsiderueshme, ku operatorët e regjistruar kanë më shumë gjasë të përdorin teknika moderne, si ujitja me precizion, dhe menaxhimi i integruar i dëmtuesve. Tregu i fidanëve funksionon përmes një numri kanalesh paralele me shkallë të ndryshme formaliteti. Fidanishtet e regjistruara zakonisht funksionojnë me transaksione më të strukturuara, furnizojnë fermerë të mëdhenj dhe prodhues komercialë drejtpërdrejt, ose përmes furnizuesve vendorë të inputeve, dhe ndonjëherë eksportojnë edhe në tregjet rajonale. Ato mund të vendosin çmime optimale, duke dhënë certifikata fitosanitare dhe garanci për cilësinë. Në tregun informal, që përbën shumicën e transaksioneve në zonë, mbizotërojnë fidanishtet e vogla, shpesh informale, që tregtojnë fidanë në tregjet lokale ose në fermë, bazuar në marrëveshje gojore. Operatorët e regjistruar përfitojnë nga informacione më të mira për tregun dhe ndonjëherë edhe nga programe mbështetëse nga shteti, kurse prodhuesit informalë janë pre e luhatjeve të çmimeve dhe shfrytëzimit. Shumica e prodhuesve **të vegjël të fidanëve nuk kanë aftësitë teknologjike dhe** nivelin e njohurive për të marrë pjesë në sisteme më të gjera tregtimi. Prodhuesit informalë janë gjithmonë e më shumë nën trysni, sepse blerësit – gjithnjë e më të vëmendshëm ndaj cilësisë – preferojnë fara **të** certifikuara nga furnizues të regjistruar.

## 2.2 SHËRBIMET E MBËSHTETJES DHE KONTROLLIT

**Janë katër Agjenci Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB)**,[15] me qendër në Shkodër, Lushnjë, Korçë, dhe Tiranë, të cilat operojnë nën Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 13.03.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor." Këto agjenci rajonale synojnë të bëhen aktore kyçe në zhvillimin e një sektori konkurrues dhe të qëndrueshëm bujqësor në vend, duke punuar në partneritete afatgjata me përfituesit. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të tyre përfshijnë:

- të ofrojnë informacion dhe këshillim për zhvillimin teknik e teknologjik të fermave bujqësore, me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë në bujqësi;
- të ofrojnë informacion dhe të asistojnë fermerët për të përfituar nga skemat mbështetëse kombëtare, IPARD-i dhe projekte të tjera në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- të nxisin dhe të ndihmojnë krijimin e funksionimin e formave të ndryshme të kooperimit të fermerëve;
- të organizojnë dhe të kryejnë trajnimin profesional të fermerëve në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- të sigurojnë informacion për standardet lidhur me mjedisin, cilësinë, marketingun, bujqësinë organike, produktet me tregues gjeografikë;
- të informojnë dhe të këshillojnë fermerët për përzgjedhjen dhe përdorimin e makinerive e të pajisjeve bujqësore, duke ofruar asistencë teknike pa pagesë.

**Pesë Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore (QTTB)**[16] **të vendosura në Fushë-Krujë, Shkodër, Vlorë, Lushnjë, dhe Korçë, u krijuan me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM)** nr. 515, datë 19.07.2006, «Për ristrukturimin e instituteve kërkimore-shkencore, në varësi të ministrisë së bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit.» Ndër to, QTTB Lushnjë është posaçërisht e fokusuar në perimet. Përgjegjësitë kryesore të QTTB-ve përfshijnë:

- identifikimin, testimin, përshtatjen dhe futjen, në praktikat bujqësore, të metodave dhe materialeve (inputeve) të reja;
- përgatitjen e paketave teknologjike për kulturat bujqësore kryesore dhe mbarështimin e bagëtive;
- kërkime dhe testime në ferma bujqësore për problemet e ngritura nga fermerët e rajoneve përkatëse;
- trajnime për specialistë të bujqësisë, fermerë, studentë të shkencave bujqësore dhe subjekte të tjera të interesuara;
- sigurimin e ekspertizës teknike për strukturat e shërbimit këshillimor dhe fermerët;
- demonstrimin e teknologjive të reja të kultivimit të kulturave bujqësore dhe mbarështimit të blegtorisë;
- përgatitjen dhe publikimin e materialeve informuese për specialistët e bujqësisë dhe fermerët;
- mbështetjen e hartimit të politikave nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në fushën e bujqësisë, ushqimit, mbrojtjes së konsumatorit dhe zhvillimit rural.

**Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB)**[17] është përgjegjës për garantimin e shëndetit dhe sigurisë së kafshëve, bimëve dhe prodhimeve bujqësore në Shqipëri. Ai operon në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe luan rol kyç në mbrojtjen e shëndetit të publikut, promovimin e qëndrueshmërisë bujqësore dhe lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare të prodhimeve bujqësore dhe ushqimore. Ndër përgjegjësitë kryesore të AKVMB-së përfshihen:

15. Shih: https://bujqesia.gov.al/drejtorite-e-bujqesise/, dhe https://www.bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/2.1-struktura-AREB-TIRANE.doc
16. Shih: https://bujqesia.gov.al/qendrat-e-transferimit-te-teknologjive-bujqesore-qttb/
17. Shih: https://akvmb.gov.al/

- **Shërbimet veterinare:** Monitorimi dhe kontrollimi i shëndetit të kafshëve, parandalimi i përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, dhe garantimi i sigurisë ushqimore në produktet me prejardhje shtazore.

- **Mbrojtja e bimëve:** Zbatimi i masave fitosanitare për parandalimin dhe kontrollimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve që mund të dëmtojnë prodhimin bujqësor.

- **Roli rregullator për pesticidet dhe plehrat:** Mbikëqyrja e importit, shpërndarjes, dhe përdorimit të pesticideve dhe plehrave, duke siguruar përmbushjen e standardeve të sigurisë.

- **Siguria ushqimore dhe inspektimi:** Kryerja e inspektimeve të fermave, mjediseve të përpunimit ushqimor, dhe tregjeve, për të siguruar që produktet përmbushin standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë ushqimore.

- **Kontrolli kufitar dhe biosiguria:** Menaxhimi i inspektimeve kufitare veterinare dhe fitosanitare për parandalimin e hyrjes së dëmtuesve, sëmundjeve dhe produkteve të pasigurta ushqimore në vend.

- **Legjislacioni dhe zbatimi i ligjit:** Hartimi dhe zbatimi i ligjeve, politikave dhe rregulloreve që lidhen me shërbimet veterinare dhe mbrojtjen e bimëve.

- **Ndërtimi i kapaciteteve dhe trajnimet:** Ofrimi i trajnimeve dhe mbështetjes për fermerët, veterinerët dhe specialistët bujqësorë për përmirësimin e praktikave më të mira në menaxhimin e shëndetit të bimëve dhe të kafshëve.

AKVMB-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është organizuar në nivel qendror nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme dhe në nivel rajonal, nëpërmjet katër drejtorive rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve në Elbasan, Vlorë, Shkodër, dhe Tiranë. Drejtoritë rajonale veprojnë brenda fushave të tyre të përgjegjësisë dhe kryejnë këto detyra:

- vlerësojnë nevojat dhe problematikat që lidhen me shërbimet veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve, dhe i propozojnë zgjidhje Drejtorisë së Përgjithshme;
- planifikojnë nevojat për shërbime veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve dhe ia paraqesin ato Drejtorisë së Përgjithshme;
- koordinojnë dhe monitorojnë ofrimin e shërbimeve veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve në territorin e tyre;
- përgatisin raporte për marrjen e kampioneve, materialeve patologjike dhe rezultateve të analizave për sëmundje të dyshuara dhe konfirmuara;
- hartojnë raporte periodike për shkallën e infeksionit të bimëve dhe statusin e produkteve bimore;
- detajojnë dhe zbatojnë planet e punës të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- lëshojnë dokumente dhe certifikata sipas dispozitave ligjore, akteve nënligjore dhe autorizimeve të Drejtorisë së Përgjithshme;
- kryejnë detyra të tjera të ngarkuara sipas ligjit ose sipas urdhrave të Drejtorisë së Përgjithshme.

**Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF)**,[18] me seli në Tiranë, është institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ai financohet nga buxheti i shtetit dhe ka si objekt të punës së tij zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 10416, datë 07.04.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor" si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Misioni i ESHFF-së përfshin:

- mbrojtjen e interesave të fermerëve;
- shtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
- prezantimin e varieteteve të reja në treg;
- përmirësimin e treguesve të cilësisë të materialit mbjellës që tregtohet;
- sigurimin e konkurrencës së ndershme në treg.

Institucioni monitoron rrjetin zonal për prova krahasuese për testimin e varieteteve të reja të prodhuara në vend

18. Shih: http://www.eshff.gov.al/

ose të importuara, për riprodhim, shumëzim e tregtim. Mbi bazën e rezultateve të këtyre provave krahasuese dhe metodave laboratorike, ESHFF-ja bën vlerësimin dhe regjistrimin e varieteteve në Katalogun Kombëtar.

Certifikimi i materialit shumëzues dhe mbjellës në Shqipëri bëhet në bazë të Ligjit nr. 10416, datë 07.04.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor"," si edhe në bazë të VKM nr. 332,[19] datë 18.04.2013, dhe VKM nr. 530,[20] datë 13.06.2013.

Këto akte përcaktojnë kriteret për tregtimin dhe certifikimin e farave të perimeve dhe të materialeve të tjera mbjellëse, duke siguruar që ato të përmbushin standardet e cilësisë për përdorim bujqësor. Ligji synon të rregullojë procesin e certifikimit, duke siguruar që farat dhe materiali shumëzues, përfshirë fidanët, të përmbushin kriteret specifike të cilësisë për shpërndarjen në treg dhe prodhim bujqësor. Fidanishtet mund të aplikojnë për certifikim përmes faqes së internetit të ESHFF-së ose drejtpërdrejt përmes portalit e-Albania.[21]




19. VKM nr. 332, datë 18.04.2013, përcakton kriteret e tregtimit dhe certifikimit të farave të perimeve, duke siguruar që ato të përmbushin kritere të caktuara për t'u shitur brenda vendit.

20. VKM nr. 530, 13.06 2013, përcakton më tej kriteret e tregtimit dhe certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve, si fidanët dhe forma të tjera të materialit riprodhues.

21. Shih: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=143&service_type=Y

## 2.3 KONSTATIMET E STUDIMIT

Bazuar në punën në terren, vrojtimet, dhe intervistat e kryera me aktorë kyç në zinxhirin e vlerës, përfshirë operatorë tregtarë,[22] dhe specialistë,[23] u identifikuan të dhënat e mëposhtme:

### Kufizimet:

- **Mospërmbushje e kërkesave ligjore:** përdorim i gjerë i farave të pacertifikuara dhe varieteteve të paregjistruara, që mund të çojë në probleme ligjore dhe përjashtim nga tregu.
- **Teknologji dhe mekanizim i ulët:** procese manuale, numër i kufizuar veglash dhe mjetesh pune, dhe infrastrukturë e pazhvilluar sa duhet e fidanishteve.
- **Zinxhir vlerash informal:** Mungesë e një sistemi të strukturuar tregu ose regjistrimi, me gjurmueshmëri dhe kontroll të kufizuar të cilësisë së fidanëve, që e bën sektorin të jetë më pak i organizuar.
- **Njohuri të pamjaftueshme të praktikave moderne të punës:** Ekspertizë e kufizuar e burrave dhe grave fermere në fusha kyçe si ujitja, menaxhimi i dëmtuesve, sterilizimi dhe shëndeti i dheut.
- **Mungesë e shërbimeve të ekstensionit:** Mungesë aksesi në udhëzime nga specialistët, në trajnime dhe rekomandime shkencore për përmirësimin e praktikave të punës – që ndikon sidomos tek gratë, të cilat shpesh përjashtohen nga sistemet këshillimore ku dominojnë burrat dhe kanë më pak gjasa të kenë akses në ndihmën e disponueshme.
- **Nënvlerësimi i punës së grave:** Me gjithë rolin e tyre qendror dhe punën e rëndë fizike, mbështetja dhe njohja e kontributit të grave është minimale.
- **Veprimtari e vogël:** Veprimtari e kufizuar i fokusuar tek fermerët e vegjël, që kufizon depërtimin në treg dhe potencialin për rritje.
- **Mungesë e burimeve financiare:** financim i pamjaftueshëm për të investuar në teknologji dhe modernizimin e proceseve të punës.
- **Mosangazhim i të rinjve:** interesi i ulët për bujqësinë nga ana e brezit të ri, bashkë me shkallën e lartë të emigracionit, kufizojnë forcat e punës dhe përcjellen e njohurive nga brezi në brez.
- **Kosto të larta të inputeve:** Kostot në rritje për inpute si farat, plehrat, dhe pajisjet, që ndikojnë në normën e fitimit.
- **Cenueshmëri nga faktorët klimatikë:** Ndryshimet e motit dhe ato klimatike mund të kërcënojnë mbijetesën e fidanëve.

### Mundësitë:

- **Formalizimi i prodhimit të fidanëve:** ka potencial për regjistrimin e fidanishteve dhe varieteteve në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, duke e bërë sektorin më formal dhe të organizuar.
- **Trajnime dhe ndërtim kapacitetesh:** Futja e teknikave moderne bujqësore dhe ndërgjegjësimi për ligjet me qëllim përmirësimin e produktivitetit, cilësisë dhe respektimit të ligjit.
- **Programe mbështetëse me ndjeshmëri gjinore:** ndërhyrjet e fokusuara mund të përmirësojnë kushtet e punës dhe fuqizimin ekonomik të grave në bujqësi.
- **Zhvillimi i varieteteve vendore të certifikuara:** Mundësia e regjistrimit dhe ruajtjes së kapaciteteve gjenetike vendore (p.sh. kultivarët tradicionalë të zonës), që garanton cilësinë dhe promovon praktikat tradicionale.
- **Krijimi i grupeve:** Organizimi i prodhuesve në grupe mund të përmirësojë aksesin në tregje, financim, vegla pune dhe mbështetje ligjore, që promovon rritjen dhe aftësinë negociuese kolektive.

22. Ruzhdi Koni and Enea Huqi nga firma AgroKoni.
23. Prof. Dr. Alban Ibraliu, Prof. As. Dr. Adrian Doko, dhe Dr. Gjon Gaspri nga UBT.

**Gratë luajnë role kyçe në prodhimin e fidanëve, megjithatë puna e tyre është e shpeshherë e nënvlerësuar, e papaguar, si dhe pa mbështetjen e duhur.**

**Në lidhje me çështjet e pabarazisë gjinore dhe të përfshirjes së grave**, informacioni i mbledhur nga takimet dhe intervistat tregon se në zinxhirin e vlerës së fidanëve, pabarazia gjinore vazhdon të jetë një problem kyç, pavarësisht kontributeve të konsiderueshme që japin gratë. Gratë janë të përfshira në të gjitha fazat e prodhimit të fidanëve, që nga përgatitja e farave deri tek transplantimi, mbikëqyrja e kontrollit të cilësisë dhe shitja e fidanëve. Megjithatë, puna e tyre shpesh nënvlerësohet dhe nuk paguhet sa duhet. Ndonëse kryejnë punë të rëndësishme, gratë hasin pengesa në aksesimin e burimeve të nevojshme, si ndihmë financiare, vegla pune dhe teknologji moderne për përmirësimin e produktivitetit dhe cilësisë së fidanëve që prodhojnë. Krahas kësaj, gratë zakonisht kanë kompetenca të kufizuara vendimmarrëse në lidhje me proceset e prodhimit, strategjitë e shitjes, dhe menaxhimin e fitimeve, gjë që u lë atyre shumë pak autonomi ekonomike. Po kështu ka mungesë aksesi në mundësi trajnimi për praktikat moderne bujqësore, si menaxhimi i dëmtuesve, ujitja dhe kontrolli i cilësisë, gjë që kufizon aftësinë e tyre për të rritur produktivitetin dhe për t'u përshtatur me praktikat e evoluara bujqësore. Normat zakonore shpesh i pengojnë gratë të kenë role drejtuese ose të marrin vendime të rëndësishme në zinxhirin e vlerës; ngarkesa e tyre me punë fizike mbetet e lartë dhe shpesh njohja e punës dhe mbështetja për to është shumë e vogël.

**Në lidhje me mundësitë e financimit,** për shumë familje në Gur të Zi, prodhimi i fidanëve është burimi kryesor i të ardhurave dhe fitimet sigurohen pas shitjes së produkteve në treg. Megjithatë, ato kanë pengesa financiare të konsiderueshme. Ato operojnë kryesisht në mënyrë informale, që ua bën të vështirë të demonstrojnë qëndrueshmëri të biznesit dhe të sigurojnë mbështetje financiare. Mikrokredia përfaqëson një instrument të rëndësishëm financimi për fermerët e vegjël në Shqipëri, sidomos për ata që janë të përjashtuar nga sistemet bankare tradicionale për shkak të aksesit të ulët në kolateral, mungesës së strukturave formale të biznesit, dhe nivelit të lartë të riskut. Institucionet e mikrokredisë ofrojnë kredi të vogla që janë më të aksesueshme dhe shpesh kanë kërkesa më pak të rrepta, krahasuar me kreditë nga bankat tradicionale.

Këto kredi mund t'i ndihmojnë fermerët e vegjël që të investojnë në pajisje, të përmirësojnë infrastrukturën ose të rrisin produktivitetin. Megjithatë, mikrokreditë për fermerët e vegjël në Shqipëri shoqërohen edhe me probleme. Ndonëse janë të disponueshme në zonat rurale, aksesi në këto produkte financiare është i kufizuar, sidomos në zonat e thella ku fermerët mund të mos kenë dijeni për shërbimet e disponueshme ose mund të kenë vështirësi të plotësojnë kriteret për marrjen e atyre kredive. Norma e interesit në institucionet e mikrokredisë mund të jetë më e lartë krahasuar me institucionet financiare tradicionale, çka mund ta shtojë barrën financiare të fermerëve të vegjël, duke ua bërë më të vështirë shlyerjen e tyre. Shumë fermerë të vegjël kanë njohuri të kufizuara se si të menaxhojnë financimet, të aplikojnë për kredi, ose të vlerësojnë kostot dhe përfitimet e marrjes së kredisë, që mund të çojnë në vendimmarrje të gabuar dhe vështirësi në shlyerjen e mikrokredisë.[24]

Mundësitë për përmirësimin e aksesit në mikrokredi:

- Ndërgjegjësimi për mundësitë ekzistuese për marrjen e mikrokredive dhe shtimi i njohurive financiare mund t'i ndihmojë fermerët e vegjël që t'i kuptojnë më mirë dhe të kenë më shumë akses në këto burime.

- Dhënia e udhëzimeve se si të aplikohet për kredi dhe si të menaxhohet shlyerja e tyre, do t'i ndihmonte ato që t'i përdorin mikrokreditë më me efektivitet.

24. Ndikimi i shërbimeve të mikrokredisë në ekonominë rurale: prova nga Shqipëria. Acta Universitatis Danubius Oeconomica, 2021. Shih: https://www.researchgate.net/publication/349992166_The_Impact_of_Microcredit_Services_on_the_Rural_Economy_Evidence_from_Albania

- Krijimi i produkteve të kreditit që u përgjigjen posaçërisht nevojave të grave fermere (p.sh., kredi me normë interesi të ulët për blerjen e inputeve, pajisjeve, ose për ndërtimin e objekteve të magazinimit) mund të pakësojë ngarkesën financiare dhe të përmirësojë produktivitetin.

- Mundësimi i programeve për marrjen e kredive në grup, ku fermerët e vegjël, sidomos gratë, mund të aplikojnë bashkërisht për kredi si kooperativë, mund të pakësojë rreziqet dhe të përmirësojë aksesin në kredi.

- Forcimi i partneriteteve midis institucioneve të mikrokredisë dhe skemave mbështetëse shtetërore mund të rrisë aksesin në kredi me interes të ulët dhe në produkte të tjera financiare, duke u mundësuar grave fermere të vogla që të investojnë në përmirësime afatgjata në veprimtarinë e tyre të punës.

## 2.4 NDËRHYRJE TË REKOMANDUARA PËR ZINXHIRIN E VLERËS SË FIDANËVE NË GURIN E ZI

Më poshtë vijojnë disa rekomandime të përgjithshme për zhvillimin e zinxhirit të vlerës me ndjeshmëri gjinore të prodhimit të fidanëve në Gur të Zi, kategorizuar sipas impaktit të tyre:

**1. Formalizimi dhe respektimi i standardeve ligjore:**

- Mbështetja e grave prodhuese të fidanëve për t'u regjistruar dhe për të siguruar njohjen e tyre ligjore dhe përmbushjen e kritereve për mbështetje shtetërore dhe nga donatorët.

- Të ofrohet ndërtim kapacitetesh lidhur me kërkesat ligjore, si proceset e certifikimit, standardet fitosanitare dhe rregullat e gjurmueshmërisë.

Për të shtuar aksesin në treg dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e bizneseve, është me rëndësi kyçe të mbështetet regjistrimi i grave prodhuese të fidanëve, duke mundësuar njohjen ligjore të tyre. Kjo do të bëjë të mundur që ato të plotësojnë kushtet për mbështetje nga shteti dhe donatorët dhe do të shtojë aksesin e tyre në burime financiare dhe asistencë teknike. Programet për ndërtimin e kapaciteteve duhet të hartohen në mënyrë të tillë që prodhuesit, veçanërisht gratë prodhuese, të mësojnë për kriteret ligjore, si proceset e certifikimit, standardet fitosanitare, dhe rregullat e gjurmueshmërisë. Këto përpjekje do të nxisin zbatimin prej tyre të rregulloreve kombëtare dhe, rrjedhimisht, do të forcojnë besimin e konsumatorëve dhe blerësve në prodhimet e tyre. Me kalimin e kohës, kjo do të përmirësojë tregtueshmërinë e përgjithshme të fidanëve dhe do të ndihmojë krijimin e reputacionit për cilësi dhe besueshmëri.

**2. Trajnimi teknik dhe shërbime ekstensioni të posaçme:**

- Të hartohen dhe zbatohen module trajnimi reagues gjinorë për:
  - teknikat moderne që përdoren në fidanishte;
  - sterilizimin e tokës dhe përgatitjen e shtretërve;
  - ujitje dhe menaxhim i dëmtuesve rezistentë ndaj ndryshimeve klimatike;
  - përdorim i farave të certifikuara dhe përzgjedhje e varieteteve.

- Të organizohen ekipe këshillimore të lëvizshme për të kontaktuar drejtpërdrejt me gratë në vendet ku punojnë e prodhojnë, duke pasur parasysh kufizimet në mundësitë e lëvizjes dhe përgjegjësitë e tyre të përkujdesit.

Një nga barrierat më kryesore ndaj rritjes së biznesit në zinxhirin e vlerës të prodhimit të fidanëve është mbështetja në praktikat tradicionale dhe njohuritë e kufizuara teknike. Për të trajtuar këtë problem, është shumë e rëndësishme të hartohen module trajnimi reaguese gjinore posaçërisht për gratë prodhuese. Këto programe trajnimi duhet të fokusohen në teknikat moderne që përdoren në fidanishte, përgatitjen e shtretërve për mbjelljen e farave, sterilizimin e tokës, një sistem ujitjeje rezistent ndaj ndryshimeve klimatike, menaxhimin e dëmtuesve, dhe përdorimin e farave të certifikuara. Këto nisma do t'i fuqizojnë gratë fermere, do të përmirësojnë produktivitetin dhe do të pakësojnë varësinë e tyre nga praktikat e vjetruara.

Përveç kësaj, ekipet këshillimore të lëvizshme duhet të shkojnë dhe t'i takojnë gratë drejtpërdrejt aty ku punojnë, duke pasur parasysh mundësitë e kufizuara të lëvizjes dhe përgjegjësitë e tyre të përkujdesit. Kjo do të sigurojë që gratë të kenë akses në mbështetjen që u nevojitet për përdorimin e teknikave të reja dhe përmirësimin e praktikave të tyre.

### 3. Mbështetja e aksesit në inpute dhe vegla pune:

- Të mundësohet aksesi i grave në inpute jo të kushtueshme (tava farash, nënshtresa cilësore, pajisje ujitëse, etj.) përmes skemave me kuponë ose modeleve të prokurimit kolektiv.

- Të futen në përdorim vegla dhe mjete pune si dhe pajisje ergonomike të përshtatura sipas gjinisë, për të pakësuar ngarkesën fizike të punës në fidanishte.

Për gratë e angazhuara në prodhimin e fidanëve, aksesi në inpute cilësore dhe në vegla pune të përshtatshme përbën një sfidë e konsiderueshme. Për të përmirësuar efikasitetin dhe për të pakësuar sforcimin fizik, rekomandohet mundësimi i aksesit të grave në inpute jo të kushtueshme si tava farash, nënshtresa cilësore dhe pajisje për ujitje. Kjo mund të arrihet përmes skemave me kuponë ose modeleve të prokurimit kolektiv. Përpos kësaj, futja në përdorim e veglave të punës ose e pajisjeve ergonomike të përshtatura sipas gjinisë do të ndihmojë në pakësimin e ngarkesës së punës fizike të grave, duke përmirësuar mirëqenien dhe produktivitetin e përgjithshëm të tyre. Me kalimin e kohës, këto përmirësime do të çojnë në prodhimin e fidanëve me cilësi më të lartë dhe do të shtojnë aftësinë konkurruese të prodhuesve vendorë.

### 4. Mbështetja financiare dhe mundësimi i investimeve:

- Mbështetje për krijimin e skemave të mikrofinancimit dhe granteve posaçërisht për gratë prodhuese, për mbështetjen e investimeve për:

  - serra ose struktura fidanishtesh të mbuluara;
  - sisteme të ujitjes me pika;
  - transportim të fidanëve dhe mjete paketimi.

- Mbështetje e aksesit të grave në njohuri financiare dhe programe për planifikimin e biznesit.

Investimet në teknologji moderne bujqësore shpesh pengohen nga burimet e kufizuara financiare. Për ta trajtuar këtë problem, është e rëndësishme të krijohen skema mikrofinancimi dhe grantesh specifike për gratë prodhuese. Këto skema duhet të mbështesin investimet në infrastrukturë kyçe, si serra, struktura fidanishtesh të mbuluara, sisteme të ujitjes me pika, transportim të fidanëve dhe mjete paketimi.

Gjithashtu, lehtësimi i aksesit të grave në programe për njohuri financiare dhe seminare për hartimin e planeve të biznesit do të bëjë të mundur që ato t'i menaxhojnë financat e tyre më me efektivitet dhe të marrin vendime të bazuara në informacion lidhur me investimet. Këta hapa do të shtojnë stabilitetin financiar dhe do t'i nxisin gratë të investojnë në teknologji, duke përmirësuar suksesin afatgjatë të bizneseve të tyre.

### 5. Krijimi i kooperativave dhe grupeve

- Të promovohet krijimi ose forcimi i grupeve prodhuese të grave që:

- të bashkojnë burimet dhe të ulin kostot e inputeve;

- të lehtësojnë marketimin kolektiv;

- të shtojnë fuqinë negociuese me blerësit dhe institucionet.

- Të sigurohet që gratë të përfaqësohen në rolet vendimmarrëse brenda atyre strukturave.

Për të rritur fuqinë negociuese, pakësuar kostot e inputeve dhe mundësuar marketingun kolektiv, është me rëndësi thelbësore që të krijohen grupe prodhuese të grave. Këto grupe mund të ndihmojnë në bashkimin e burimeve, shkëmbimin e njohurive, dhe angazhimin kolektiv në proceset e vendimmarrjes. Përfaqësimi i grave në rolet vendimmarrëse në këto grupe do të sigurojë që të merren parasysh nevojat dhe pikëpamjet e tyre. Këto grupe prodhuese do të krijojnë gjithashtu mundësi që gratë të forcojnë kapitalin social, të shtojnë influencën, dhe të përmirësojnë aftësinë e tyre për të negociuar çmime më të favorshme për produktet e tyre.

### 6. Aksesi në treg dhe lidhjet e zinxhirit të vlerës

- Të organizohen ditë të dedikuara të tregut ose platforma për gratë prodhuese ku ato t'ua shesin fidanët drejtpërdrejt fermerëve ose blerësve.

- Të lehtësohen lidhjet me fidanishtet e shitjeve me pakicë dhe dyqanet bujqësore, njësitë agroturistike, panairet dhe ekspozitat bujqësore;

- Të nxiten marrëveshjet kontraktuese me ferma ose agrobiznese më të mëdha.

Përmirësimi i qasjes në treg është shumë i rëndësishëm për rritjen e potencialit për fitimin e të ardhurave dhe të stabilitetit të tregut për gratë në zinxhirin e vlerës të prodhimit të fidanëve. Për ta mbështetur këtë, rekomandohet mbajtja e ditëve të dedikuara të tregut në zonë ose krijimi i platformave ku gratë prodhuese mund t'ua shesin drejtpërdrejt fidanët fermerëve ose blerësve. Kjo do t'u mundësojë që të shtojnë fitimet dhe të jenë më të dukshme në treg.

Krahas kësaj, krijimi i lidhjeve me fidanishtet e shitjes me pakicë, dyqanet bujqësore, njësitë agroturistike, panairet dhe ekspozitat bujqësore do të hapin mundësi të reja në treg. Nxitja e marrëveshjeve kontraktuese bujqësore me ferma ose agrobiznese më të mëdha mund të ndihmojë edhe diversifikimin e të ardhurave dhe të sigurojë burime të ardhurash më të qëndrueshme për gratë prodhuese.

### 7. Trajtimi i dinamikave të rinisë dhe emigracionit

- Integrimi i trajnimeve profesionale për të rinjtë në prodhimin e fidanëve dhe agro-sipërmarrje për të tërhequr brezat e rinj.

- Promovimi i mjeteve digjitale dhe inovacionit (p.sh, aplikacione celulare për menaxhimin e dëmtuesve, platforma digjitale të ekstensionit, etj.) për ta bërë sektorin më tërheqës dhe efikas.

Trajtimi i problemit të emigrimit të rinisë dhe angazhimi i brezave të rinj në zinxhirin e vlerës të prodhimit të fidanëve është me rëndësi thelbësore për qëndrueshmërinë e tij. Kjo mund të arrihet përmes integrimit të trajnimeve profesionale të të rinjve dhe të rejave në prodhimin e fidanëve dhe sipërmarrje bujqësore. Këto trajnime do t'i pajisin të rinjtë dhe të rejat me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të kontribuar në këtë sektor dhe do të shërbejnë si kundërpeshë ndaj pasojave të migracionit nga fshati në qytet.

Krahas kësaj, promovimi i mjeteve dhe novacioneve digjitale, si aplikacionet celulare për menaxhimin e dëmtuesve dhe platformat digjitale të shërbimeve të ekstensionit, do ta bëjnë sektorin më tërheqës për të rinjtë, duke u ofruar atyre mënyra të reja dhe efikase për t'u përfshirë në bujqësi.

### 8. Infrastruktura dhe kushtet e punës

- Të avokohet për investime në infrastrukturë bazë (p.sh. fidanishte të centralizuara, njësi magazinimi, hapësira pune të mbuluara) me fokus mbi përmirësimin e kushteve të punës.

- Të sigurohet që zhvillimet e ardhshme në infrastrukturë (serra, depot e veglave të punës) të përfshijnë edhe mjedise të sigurta sanitare për gratë.

Përmirësimi i infrastrukturës dhe i kushteve të punës të grave në prodhimin e fidanëve është me rëndësi thelbësore për rritjen e produktivitetit dhe tërheqjen e punëtorëve të rinj. Investimet në infrastrukturë bazë, si fidanishte të centralizuara, objekte magazinimi dhe hapësira pune të mbuluara, do të përmirësojnë hapësirat e punës, sidomos për gratë që punojnë në kushte fizike të vështira. Është gjithashtu e rëndësishme të sigurohet që zhvillimet e ardhshme në infrastrukturë, si serrat dhe depot e veglave të punës, të përfshijnë edhe mjedise që u përgjigjen nevojave specifike të grave punëtore.
Përmirësimi i kushteve të punës do të shërbejë për të mbajtur punëtorët ekzistuese, si dhe për të tërhequr punëtore të reja, dhe do të çojë në rritjen e produktivitetit të punës.

*Këto rekomandime kanë për qëllim të trajtojnë të vështirësitë specifike që hasin gratë në zinxhirin e vlerës të prodhimit të fidanëve në Gurin e Zi. Me fokus mbi respektimin e ligjeve, trajnimet e posaçme, mbështetjen financiare dhe aksesin e përmirësuar në treg, këto veprime synojnë të fuqizojnë gratë, shtojnë produktivitetin dhe promovojnë qëndrueshmëri afatgjatë brenda zinxhirit të vlerës. Me këto përpjekje pritet që zinxhiri i vlerës të bëhet më konkurrues, më i qëndrueshëm ndaj krizave, dhe më i barabartë, duke krijuar një të ardhme më të mirë për të gjithë personat e përfshirë në të.*

**Tabela 6.** Rekomandime për zinxhirin e vlerës të fidanëve

| No. | Veprimtaria | Impakti | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Afatshkurtër | Afatmesëm | Afatgjatë |
| 1 | **Formalizimi dhe respektimi i standardeve ligjore** | | | |
| | Akses më i madh në tregje dhe financim dhe përmbushja e standardeve shton besimin e konsumatorëve dhe blerësve në produktet. | | | |
| 1.1 | Mbështetje e prodhuesve të fidanëve të drejtuara nga gratë, për t'u regjistruar dhe për të siguruar njohjen e tyre dhe plotësimin e kritereve për ndihma nga shteti dhe donatorët. | | X | X |
| 1.2 | Ndërtim kapacitetesh në lidhje me kërkesat ligjore, përfshirë për proceset e certifikimit, standardet fitosanitare, dhe rregullat e gjurmueshmërisë | | X | X |
| 2 | **Trajnimi teknik dhe shërbime ekstensioni të posaçme** | | | |
| | Produktivitet i përmirësuar, reduktim i varësisë nga praktikat tradicionale dhe fuqizim i grave fermere. | | | |
| 2.1 | Hartimi dhe zbatimi i moduleve të trajnimeve reaguese gjinore për:<br>o Teknikat moderne që përdoren në fidanishte<br>o Sterilizimin e tokës dhe përgatitjen e shtretërve<br>o Ujitje dhe menaxhim i dëmtuesve rezistentë ndaj ndryshimeve klimatike<br>o Përdorim i farave të certifikuara dhe përzgjedhje e varieteteve | X | X | X |
| 2.2 | Organizimi i ekipeve këshillimore të lëvizshme për të kontaktuar drejtpërdrejt me gratë në hapësirat ku punojnë e prodhojnë, duke pasur parasysh kufizimet që kanë në lëvizje dhe përgjegjësitë e tyre të përkujdesit. | X | X | X |
| 3 | **Mbështetja e aksesit në inpute dhe vegla pune** | | | |
| | Efikasitet i shtuar, mirëqenie fizike e grave dhe fidanë me cilësi më të lartë. | | | |
| 3.1 | Mundësimi i aksesit të grave në inpute jo të kushtueshme (tava farash, nënshtresa cilësore, pajisje ujitëse, etj.) përmes skemave me kuponë ose modeleve të prokurimit kolektiv. | | X | X |
| 3.2 | Të futen në përdorim vegla dhe mjete pune si dhe pajisje ergonomike të përshtatura sipas gjinisë, për të pakësuar ngarkesën fizike të punës në fidanishte. | X | X | X |
| 4 | **Mbështetja financiare dhe mundësim i investimeve** | | | |
| | Më shumë investime në teknologjitë moderne dhe biznese më të suksesshme. | | | |
| 4.1 | Mbështetje për krijimin e skemave të mikrofinancimit dhe granteve posaçërisht për gratë prodhuese, për mbështetjen e investimeve për:<br>o Serra ose struktura fidanishtesh të mbuluara<br>o Sisteme të ujitjes me pika<br>o Transportim të fidanëve dhe mjete paketimi | | X | X |
| 4.2 | Mbështetje e aksesit të grave në njohuri financiare dhe programe për planifikimin e biznesit. | X | X | X |
| 5 | **Mbështetja për krijimin e grupeve** | | | |
| | Shtim i fuqisë negociuese, aksesit në tregje më të mëdha dhe rritje e kapitalit social | | | |

*(Vazhdon në faqen tjetër)*

| No. | Veprimtaria | Impakti | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Afatshkurtër | Afatmesëm | Afatgjatë |
| 5.1 | Promovimi i krijimit ose forcimit të grupeve prodhuese të grave që:<br>o Të bashkojnë burimet dhe të ulin kostot e inputeve;<br>o Të lehtësojnë marketimin kolektiv;<br>o Të shtojnë fuqinë negociuese me blerësit dhe institucionet | | X | X |
| 5.2 | Të sigurohet që gratë të përfaqësohen në rolet vendimmarrëse brenda atyre strukturave. | X | X | X |
| 6 | **Aksesi në treg dhe lidhjet e zinxhirit të vlerës** | | | |
| | Potencial për të ardhura më të larta, përmirësim i stabilitetit të tregut, burime të diversifikuara të të ardhurave. | | | |
| 6.1 | Të organizohen ditë të dedikuara të tregut ose platforma për gratë prodhuese ku t'ua shesin fidanët drejtpërdrejt fermerëve ose blerësve.<br>o Të mundësohen lidhje me fidanishtet e shitjeve me pakicë dhe dyqanet bujqësore, njësitë agroturistike, panairet dhe ekspozitat bujqësore; | | X | X |
| 6.2 | Të nxiten marrëveshjet kontraktuese me ferma ose agrobiznese më të mëdha. | | X | X |
| 7 | **Trajtimi i dinamikave të rinisë dhe migracionit** | | | |
| | Reduktim i migracionit nga fshati në qytet; novacionet dhe qëndrueshmëria; dhe rritje e punësimit vendor | | | |
| 7.1 | Integrimi i trajnimeve profesionale për të rinjtë në prodhimin e fidanëve dhe agro-sipërmarrje për të tërhequr brezat e rinj. | | X | X |
| 7.2 | Promovimi i mjeteve digjitale dhe inovacionit (p.sh, aplikacione celulare për menaxhimin e dëmtuesve, platforma digjitale të ekstensionit, etj.) për ta bërë sektorin më tërheqës dhe efikas | X | X | X |
| 8 | **Infrastruktura dhe kushtet e punës** | | | |
| | Përmirësim i kushteve të punës, rritje e produktivitetit dhe tërheqja e punëtorëve të rinj | | | |
| 8.1 | Të avokohet për investime në infrastrukturë bazë (p.sh. fidanishte të centralizuara, njësi magazinimi, hapësira pune të mbuluara) me fokus mbi përmirësimin e kushteve të punës. | | X | X |
| 8.2 | Të sigurohet që zhvillimet e ardhshme në infrastrukturë (serra, depot e veglave të punës) të përfshijnë edhe mjedise të sigurta sanitare për gratë | | X | X |

Në këtë tabelë përvijohen aktivitetet kryesore për zhvillimin e një zinxhiri vlere me ndjeshmëri gjinore, jepen hollësi për veprimet specifike, impaktin e pritshëm në secilën fazë, dhe afatet kohore përkatëse. Aktivitetet kategorizohen në veprime afatshkurtra, afatmesme, dhe afatgjata, për të krijuar një zinxhir vlerash me ndjeshmëri gjinore të fidanëve i cili jo vetëm fuqizon gratë, por edhe forcon ekonominë bujqësore në Gur të Zi. Bashkia duhet të luajë një rol të rëndësishëm në ofrimin e mbështetjes përmes politikave, koordinimit dhe zhvillimit të infrastrukturës. Institucionet përkatëse publike dhe private të sektorit bujqësor, si shërbimet e ekstensionit bujqësor dhe OSHC-të mund të kontribuojnë me ekspertizën e tyre në trajnime dhe asistencë teknike. Bashkëpunimi me tregjet dhe panairet vendore do të krijojë mundësi për gratë që të ekspozojnë produktet e tyre dhe të kenë akses në një bazë më të gjerë klientësh. Kjo qasje e bazuar në shumë grupe interesi siguron qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e nismave, duke shfrytëzuar njohuritë, burimet dhe rrjetet vendore.

Pjesa 3

# Analizë e Zinxhirit të Vlerës së Qepës

# 1. Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirit të Vlerës së Qepës

Shqipëria është shumë e pasur me një shumëllojshmëri ekotipash të qepëve, secili prej të cilëve është i përshtatur në mënyrë unike me kushtet dhe traditat e kultivimit në zonë.Kjo pasuri varietetesh mbështet prodhimin e qepëve të thata dhe të njoma në të gjithë vendin. Ndër varietetet më të njohura të qepëve të thata janë qepa e Mirasit, që njihet për shijen e fortë, si dhe qepa e kuqe e Dishnicës. Varietete të tjera të njohura janë qepët e Bënjës, Rehovës, Linit, Peshkopisë, dhe Drishtit— ku secila përfaqëson një zonë specifike dhe traditën bujqësore të saj. Krahas këtyre pasurive vendore, fermerët shqiptarë kanë përqafuar edhe një gamë hibridesh të huaja. Varietete si Hercules dhe Stuttgart po bëhen gjithnjë e më të pëlqyeshme për shkak të prodhueshmërisë dhe përshtatshmërisë së lartë, duke plotësuar varietetet tradicionale dhe zgjeruar potencialin prodhues.

Në vitin 2023, qepët e thata në Shqipëri kultivoheshin në një sipërfaqe prej rreth 5.327 hektarë, me një prodhim total 117.110 ton – një rritje me 8% krahasuar me vitin 2022. Zonat kryesore prodhuese të qepës ishin Maliqi me 626 hektarë, ndjekur nga Tirana (365 ha), Fieri (268 ha), Divjaka (251 ha), Pogradeci (242 ha), dhe Korça (206 ha).[25]

Fermerët në bashkinë e Shkodrës kultivuan 201 hektarë, ose rreth 3,8% të sipërfaqes totalet të mbjellë me qepë të thata në vend. Kjo e vë Shkodrën në vendin e gjashtë ndër prodhuesit më të mëdhenj të qepës në Shqipëri, me një prodhim total 3.927 ton – afërsisht 3,35% të prodhimit kombëtar. Sa i përket rendimentit, Shkodra ishte në vendin e 23-të, me mesatarisht 195 ton qepë për hektar.[26]

Në njësinë administrative të Postribës, kultivimi i qepës i ka rrënjët thellë në traditën bujqësore të zonës dhe është kultura kryesore e prodhuar nga fermerët në zonë. Për breza me radhë, qepët kanë pasur një rol kryesor si në fitimin e jetesës ashtu edhe në identitetin kulturor të familjeve fermere të zonës. Ndër varietetet më të



**Për breza me radhë, qepët kanë pasur një rol kryesor si në fitimin e jetesës në njësinë administrative të Postribës, ashtu edhe në identitetin kulturor të familjeve fermere të zonës. Gratë luajnë një rol kryesor në këtë vazhdimësinë e kësaj tradite.**

vlerësuara është qepa e Drishtit, që, sipas dëshmive të mbledhura gjatë takimeve me fermerët, ka mbi 200 vjet që ruhet dhe kultivohet. Ky varietet i trashëguar brez pas brezi jo vetëm që është simbol i traditës së zonës, por edhe vlerësohet për cilësinë dhe përshtatjen me tokën dhe kushtet klimatike të zonës.

Në vitin 2023, çmimi i tregut të qepës në Shkodër ishte midis 60 dhe 70 lekë për kilogram, që u siguroi fermerëve një burim modest po të qëndrueshëm të ardhurash. Por situata ndryshoi rrënjësisht në vitin 2024, kur çmimi me shumicë i qepës ra ndjeshëm, në vetëm 35-40 lekë për kilogram. Kjo rënie e konsiderueshme pati një ndikim negativ të drejtpërdrejtë në mirëqenien financiare të familjeve të zonës, shumë prej të cilave prodhimin e qepëve e kanë burim kryesor të të ardhurave. Tregu primar i qepëve të tyre është në qytetin e Shkodrës, ku shitet edhe shumica e prodhimit. Megjithatë, disa fermerë të Postribës, veçanërisht gratë fermere, përballen me vështirësi individuale sa i takon aksesit në tregje. Ato shpesh ua shesin prodhimin drejtpërdrejt

25. Vjetari statistikor i bujqësisë, 2023. INSTAT. Shih: https://www.instat.gov.al/al/temat/bujq%C3%ABsia-dhe-peshkimi/bujq%C3%ABsia/#tab1
26. Po aty.

konsumatorëve ose restoranteve të zonës, duke anashkaluar tregun kryesor. Ndonëse kjo qasje e shitjes së drejtpërdrejtë mund të jetë më me fitim, ajo paraqet vështirësi logjistike, përfshirë probleme me magazinimin.

Sipas fermerëve të zonës, kostoja mesatare e prodhimit të një kilogrami qepë në Postribë vlerësohet në 20-25 lekë. Kjo shifër përfshin shpenzimet bazë, si përgatitja e tokës, inputet bujqësore (plehrat, pesticidet), dhe blerjen e qepujkave. Duhet theksuar që këto përllogaritje nuk përfshijnë koston e punës së pothuaj shtatë muajve, që nga mbjellja deri tek vjelja e tharja e produktit, që shpesh kryhen nga vetë anëtarët e familjes dhe potencialisht e bëjnë edhe më të lartë koston faktike të prodhimit. Rënia e çmimit i vuri shumë fermerë në pozitë të vështirë ekonomike, duke i reduktuar së tepërmi, ose duke i zhdukur plotësisht marzhet e fitimit të tyre.

Fermerët në zonën e Postribës shprehin shqetësim në rritje për mungesën e kushteve të duhura të magazinimit pas vjeljes dhe vënë në dukje se aktualisht në zonë nuk ka një pikë grumbullimi. Kjo mungesë kufizon ndjeshëm aftësinë e tyre për të ruajtur cilësinë e produktit, për të pakësuar humbjet, dhe për të pasur akses në tregje më të mëdha. Shumica e fermave në zonë janë të vogla dhe të fragmentuara, që e ndërlikon edhe më tej efikasitetin e prodhimit dhe kufizon mundësitë për mekanizim. Pjesa më e madhe e përgatitjes së tokës dhe e punëve të tjera të mekanizuara kryhen nga ofrues të këtyre shërbimeve kundrejt pagesës, sepse fermerët nuk i kanë makineritë e duhura. Kjo varësi shton kostot e prodhimit dhe mund të shkaktojë vonesa gjatë periudhave kritike në bujqësi.

Sa i përket shërbimeve këshillimore bujqësore, shumica e fermerëve mbështeten shumë tek furnizuesit e inputeve, sidomos tek farmacitë bujqësore, për këshilla dhe udhëzime teknike. Ndonëse i dobishëm deri në një farë mase, ky burim informacioni është shpesh i kufizuar dhe nuk u përgjigjet nevojave specifike të fermave të veçanta. Fermerët vënë në dukje mungesën e shërbimeve të specializuara të ekstensionit bujqësor, të cilat mund të ofrojnë rekomandime më të sakta dhe më të bazuara shkencore për përmirësimin e rendimentit dhe të qëndrueshmërisë së prodhimit. Gjatë vizitave në terren u evidentua mungesë e veglave të punës dhe pajisjeve të rëndësishme për punë të mekanizuar në parcela të vogla. Po kështu, përdorimi i herbicideve, pesticideve dhe trajtimeve të tjera shpesh bëhet në bazë të traditës ose përvojës personale, në vend të konsultimeve me ekspertët. Kjo praktikë ndikon jo vetëm produktivitetin, por mund të përbëjë edhe rrezik për mjedisin dhe sigurinë e konsumatorit.

*Megjithëse kanë rol qendror dhe të pazëvendësueshëm në çdo fazë të zinxhirit të vlerës të qepës, gratë në Postribë vazhdojnë të punojnë në kushte pune të papërshtatshme. Ato janë të angazhuara aktivisht në punë si përgatitja e farave dhe e qepujkave, mbjellja, kultivimi, vjelja, tharja dhe proceset pas vjeljes – përfshirë praktikën tradicionale të thurjes së vargjeve dekorative të qepëve për magazinim dhe shitje.*

*Megjithatë, një pjesë e mirë e kësaj pune kryhet në kushte fizike të rënda, shpesh pa akses në veglat e punës dhe pajisjet mbrojtëse të nevojshme, dhe pa marrë shpërblimin që u takon. Mungesa e mekanizimit dhe e shërbimeve mbështetëse bujqësore ndikon në mënyrë disproporcionale tek gratë, të cilat zakonisht i kryejnë këto punë me dorë. Kontributet e tyre, ndonëse shumë të rëndësishme, shpesh nuk njihen dhe nuk mbështeten – që thekson nevojën urgjente për ndërhyrje me ndjeshmëri gjinore për përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e aksesit në burime, dhe promovimin e barazisë në punët bujqësore.*

**Tabela 7.** Analiza SWOT e zinxhirit të vlerës të qepës

| Pikat e Forta | Pikat e Dobëta |
|---|---|
| **Traditë e gjatë e kultivimit të qepës,** sidomos të qepës së Drishtit, që është kultivuar tradicionalisht për mbi 200 vjet. Kultivimi i qepës ka rrënjë të thella në traditën e zonës së Postribës, ku qepa e Drishtit është një varietet tradicional me vlerë. Kjo forcon traditën dhe identitetin vendor.<br>**Qepa e Drishtit është e regjistruar si produkt me tregues gjeografik** (TGJ), që ofron një mundësi unike për krijimin e brandit dhe diferencim në treg.<br>**Fermerët, sidomos gratë fermere, zotërojnë njohuri** dhe përvoja të çmuara.<br>**Ekzistenca e ekotipave** të ndryshme të qepës të përshtatura me kushtet vendore.<br>**Pjesëmarrje aktive e grave në të gjitha fazat e zinxhirit të vlerës.** Gratë marrin pjesë në të gjithë procesin e prodhimit, që nga përgatitja e farave deri në fazat e vjeljes dhe të përpunimit pas vjeljes, që është tregues i pjesëmarrjes së fuqishme të komunitetit dhe i potencialit për programe të fokusuara gjinore për fuqizimin e grave.<br>**Afërsia me tregun e qytetit të Shkodrës** | **Ndryshime të theksuara në çmime** dhe varësi nga kanale të kufizuara të tregut.<br>**Mungesë mekanizimi** dhe pronësi e kufizuar e pajisjeve bujqësore, sidomos nga gratë.<br>**Infrastrukturë e pamjaftueshme** pas vjeljes (nuk ka pika grumbullimi, kushte të papërshtatshme magazinimi).<br>**Fermat e vogla dhe të fragmentuara** kufizojnë mundësitë për ekonomi në shkallë të gjerë.<br>**Kosto të larta prodhimi,** sidomos kur llogaritet edhe puna e punëtorëve.<br>**Akses i kufizuar** në shërbime ekstensioni dhe këshillimi profesional.<br>**Përdorimi i inputeve** (p.sh pesticideve) mbështetet në traditë dhe jo në udhëzimet e specialistëve.<br>**Pabarazi gjinore në kushtet e punës** dhe akses i kufizuar në pajisje dhe vegla pune.<br>**Mungesë burimesh financiare** dhe, rrjedhimisht, investime të pamjaftueshme në teknologji.<br>**Kosto të larta të inputeve.**<br>**Mungesë certifikimi** në lidhje me standardet e sigurisë dhe cilësisë.<br>**Ekzistenca e dallimeve në aftësitë teknike,** sidomos në proceset e mbrojtjes së bimëve.<br>**Disponueshmëria e tregut** dhe çmimet tejet të kushtëzuara nga importi.<br>**Rrezikimi nga ndryshimet klimatike** – stina e thatë ndikon në prodhim.<br>**Puna e rëndë dhe kushtet e vështira të punës,** sidomos për gratë.<br>**Mungesë e të rinjve të interesuar** në bujqësi dhe shkallë e lartë migracioni. |
| **Mundësitë** | **Kërcënimet** |
| **Potencial për mekanizim:** Futja e teknikave moderne bujqësore dhe mekanizimit mund të shtojë produktivitetin, të ulë intensitetin e punës së krahut, dhe të pakësojë shpenzimet e prodhimit, sidomos për fermerët e vegjël.<br>**Përmirësim i barazisë gjinore:** Pjesëmarrja aktive e grave në proceset bujqësore krijon mundësi për ndërhyrje me ndjeshmëri gjinore që mund të fuqizojnë gratë përmes trajnimeve, kushteve më të mira të jetesës, dhe shpërblim më të drejtë për punën e tyre.<br>**Diversifikim i tregut:** eksplorimi i mundësive të tregjeve të reja, përfshirë shitjet e drejtpërdrejta tek konsumatorët, restorantet dhe agrobizneset e zonës, mund të ndihmojë në zbutjen pasojave të lëvizjeve të çmimit dhe të zgjerojnë aksesin në treg.<br>**Shitje të drejtpërdrejta:** Krijimi i platformave për shitje të drejtpërdrejtë nga gratë prodhuese mund të shtojë dukshmërinë e tyre në treg, të shtojë shitjet, dhe të sigurojë burime të ardhurash shtesë.<br>**Praktika që u bëjnë ballë ndryshimeve klimatike:** Zbatimi i praktikave të ujitjes dhe menaxhimit të tokës që i qëndrojnë ndryshimeve klimatike mund t'i ndihmojnë fermerët që t'u përshtaten ndryshimit të kushteve mjedisore dhe të përmirësojnë rendimentin.<br>**Mundësi të mira për arritje pozitive** me investime të vogla, përfshirë përmes trajnimeve në zbatimin e praktikave të mira bujqësore.<br>**Zhvillime novatore** dhe përparime në proceset e tharjes dhe të trajtimit të produktit.<br>**Kërkesë e madhe për qepën** e prodhuar në zonë.<br>**Diferencim i produktit** përmes renditjes/kategorizimit, paketimit dhe krijimit të brandit. | **Rëniet e çmimeve** (si në vitin 2024) kërcënojnë drejtpërdrejt të ardhurat e familjeve.<br>**Ndryshimet klimatike** ndikojnë në sasinë e prodhimit dhe humbjet pas vjeljes. Cenueshmëria nga ngjarjet klimatike (për shembull, thatësira, përmbytjet) mund të rrezikojë më tej prodhimin, sidomos sa u takon fermave të vogla dhe të pamekanizuara.<br>**Shkalla e lartë dhe e vazhdueshme e emigracionit,** që çon në mungesë të forcave të punës dhe moshim të popullatës fermere.<br>**Mungesa e pikave të përpunimit** dhe ndërtesave të magazinimit pengon krijimin e ekonomive të mëdha, duke e bërë të vështirë aksesin në tregje më të mëdha.<br>**Rritja e kostos për inpute si plehrat,** pesticidet dhe krahun e punës e bëjnë më të vështirë që fermerët të dalin me fitim, sidomos kur nuk kanë akses në financime apo subvencione të përballueshme.<br>**Njohja e ulët dhe nënvlerësimi** i punës së grave.<br>**Ekspozimi ndaj rreziqeve mjedisore** dhe shëndetësore për shkak të mospërdorimit në mënyrën e duhur të inputeve. |

# 2. Diagram i Zinxhirit të Vlerës të Qepës

Në vijim paraqitet një diagram gjithëpërfshirës i hallkave të zinxhirit të vlerës, aktorëve, faktorëve mbështetës dhe problemeve kryesore të identifikuara, bazuar në konstatimet nga intervistat me grupet e interesit dhe agjencitë mbështetëse vendore, punën kërkimore në terren, dhe konsultimet me specialistët.

Diagrami paraqet grupet kryesore të interesit, fazat që nga inputet deri në tregun përfundimtar, si dhe ndihmon në identifikimin e vështirësive që dalin gjatë prodhimit. Vlerat numerike sipër kutive përfaqësojnë kostot dhe vlerën e shtuar për çdo fazë.

**Figura 3.** Diagram i zinxhirit të vlerës të qepës në Postribë



## 2.1 AKTORËT NË ZINXHIRIN E VLERËS

Sikurse shihet nga diagrami më lart, zinxhiri i vlerës i produktit të qepës në Postribë është i organizuar në këto nivele kyçe:

- Inpute
- Kultivim
- Vjelje dhe pasvjelje
- Magazinim
- Treg

Më poshtë jepet një përshkrim i shkurtë i çdo aktori dhe agjencie mbështetëse në zinxhirin e vlerës, që nga inputet deri në shpërndarjen përfundimtare në treg.

**Gratë në Postribë kryejnë shumicën e punës për prodhimin e qepëve pa pagesë, në kushte të pasigurta dhe fizikisht të vështira, dhe mbeten të nënvlerësuara në zinxhirin e vlerës.**

**Inputet:** Në Postribë, zinxhiri i vlerës i produktit të qepës fillon me blerjen e inputeve të domosdoshme, si qepujkat, plehrat, pesticidet dhe veglat e punës. Qepët janë një kulturë bujqësore me traditë të gjatë në zonë, sidomos qepa e Drishtit, që pëlqehet shumë për cilësinë e saj dhe ka mbi 200 vjet që kultivohet. Në vitin 2023, kostoja mesatare e prodhimit të një kilogrami qepë ishte rreth 20-25 lekë, ku përfshihet përgatitja e tokës, inputet dhe blerja e qepujkave – por nuk përfshihet kostoja e konsiderueshme e punës së anëtarëve të familjes gjatë ciklit shtatëmujor të kultivimit të qepës. Pjesa më e madhe e fermerëve i marrin këshillat teknike nga furnizuesit e inputeve, si farmacitë bujqësore, që zakonisht janë këshilla të përgjithshme dhe nuk u përgjigjen nevojave specifike të tyre. Mungesa e shërbimeve të specializuara të ekstensionit bujqësor ka lënë boshllëqe në njohuritë për praktikat moderne, si për përdorimin e duhur të pesticideve, shëndetin e tokës dhe qëndrueshmërinë.

**Kultivimi:** Zinxhiri i vlerës i qepës në Postribë dëshmon qëndrueshmërinë, por edhe sfidat me të cilat përballet bujqësia në Shqipërinë e Veriut. Me rrënjë të thella në traditën e pasur bujqësore, kultivimi i qepës është burimi kryesor i jetesës për familjet e zonës, i mbështetur nga përfshirja e gjerë e komunitetit dhe kultivimi në vijimësi i varieteteve tradicionale, si qepa e Drishtit. Më gjerë në bashkinë e Shkodrës, kultivimi i qepës së thatë bëhet në 201 hektarë tokë, që përbën 3,8% të totalit të vendit, me një prodhim total 3.927 ton – që e rendit atë në vendin e gjashtë sa i përket prodhimit të përgjithshëm, por vetëm në vendin e 23-të sa i përket rendimentit të prodhimit për hektar.
Në Postribë procesi i kultivimit të qepës është tejet manual dhe fizik, i kushtëzuar prej parcelave të vogla dhe të fragmentuara, dhe karakterizohet nga një mungesë e përgjithshme mekanizimi. Fermerët shpesh varen nga ofrues të shërbimeve me pagesë për punime kritike si përgatitja e tokës, që ua shton ngarkesën financiare dhe shkakton vonesa logjistike. Gratë luajnë rol qendror në të gjitha fazat e prodhimit – që nga mbjellja dhe ujitja e deri tek heqja e barërave të këqija – por puna e tyre shpesh nuk mbështetet. Pa akses në vegla pune të përshtatshme, pajisje sigurie ose kushte ergonomike, puna e tyre mbetet e nënvlerësuar, çka vë në pah dallimet gjinore. Këto kufizime, së bashku me infrastrukturën e dobët, mungesën e shërbimeve të ekstensionit dhe luhatjet e mëdha të tregut, e vënë të tërë zinxhirin e vlerës në rrezik, me gjithë rrënjët e forta që ka në traditë.

**Vjelja dhe pasvjelja:** Faza e vjeljes fillon zakonisht në verë dhe kërkon punë të imtë dhe të kujdesshme manuale, ku familje të tëra – sidomos gratë – përfshihen në shkuljen, pastrimin, tharjen dhe klasifikimin e qepëve. Praktikat tradicionale si thurja e vargjeve të qepëve për magazinim dhe shitje janë të zakonshme edhe sot. Megjithatë, për shkak të mungesës së njohurive për trajtimin e prodhimit pas vjeljes dhe mungesën e mjeteve të përshtatshme tharëse, fermerët kanë humbje në cilësi. Puna është e papaguar ose

jo e paguar sa duhet, sepse pjesa më e madhe e ngarkesës së punës mbahet nga anëtarët e familjes. Këto kushte ndikojnë shumë më tepër tek gratë, kontributet e të cilave, ndonëse shumë të rëndësishme, shpesh nuk njihen dhe nuk mbështeten. Përdorimi i pesticideve dhe herbicideve në këtë fazë zakonisht bazohet në traditë dhe jo një këshillat e ekspertëve, gjë që mund të ndikojë si në sasinë e prodhuar, ashtu edhe në sigurinë e konsumatorëve.

**Magazinimi:** Magazinimi është një nga pikat e dobëta më kritike në zinxhirin e vlerës të kulturës së qepës në Postribë. Fermerët theksojnë mungesën e pikave të grumbullimit, që ua bën të vështirë të ruajnë cilësinë e produktit dhe të parandalojnë humbjet. Qepët ruhen në ambiente të improvizuara në shtëpi ose në plevica, shpesh në kushte të papërshtatshme, që çojnë në kalbjen dhe prishjen e produktit. Kjo mungesë e ambienteve të përshtatshme të magazinimit kufizon mundësinë e fermerëve për të planifikuar strategjikisht kohën e hedhjes së produktit në treg, duke i detyruar që të shesin herët dhe me çmime të pafavorshme. Gratë janë shumë të përfshira edhe në punët që lidhen me magazinimin; por u duhet t'i kryejnë ato punë në ambiente ku nuk ka siguri dhe standarde të higjienës, që ua shton më tej ngarkesën e punës fizike.

**Tregu:** Pjesa më e madhe e qepëve të Postribës shitet në tregun kryesor të Shkodrës. Megjithatë, struktura e tregut mbetet informale dhe e fragmentuar. Në vitin 2023, fermerët patën të ardhura nga një çmim relativisht i qëndrueshëm prej 60-70 lekë/kg, por, në vitin 2024, çmimet ranë në mënyrë drastike, në vetëm 35-40 lekë/kg. Me koston e prodhimit të llogaritur rreth 20-25 lekë/kg, ku nuk përfshihet kostoja e punës, kjo rënie e theksuar e çmimit ndikoi negativisht në të ardhurat dhe sigurinë financiare të familjeve fermere. Krahas shitjeve në tregun e zakonshëm, disa fermerë u shesin edhe drejtpërdrejt konsumatorëve ose restoranteve, që mund t'u sjellë fitim më të madh, por ka edhe vështirësi logjistike – sidomos duke pasur parasysh vështirësitë në transport, magazinim dhe akses tek blerësit. Pjesëmarrja e tyre në treg kufizohet më tej nga vështirësitë e transportit, mungesa e fuqisë negociuese dhe njohja minimale e rolit të tyre sipërmarrës.

## 2.2 SHËRBIMET E MBËSHTETJES DHE KONTROLLIT

**Janë katër Agjenci Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB),**[27] me qendër në Shkodër, Lushnjë, Korçë, dhe Tiranë, të cilat operojnë nën Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 13.03.2018, «Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor."

Këto agjenci rajonale synojnë të bëhen aktore kyçe në zhvillimin e një sektori konkurrues dhe të qëndrueshëm bujqësor në vend, duke punuar në partneritete afatgjata me përfituesit. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të tyre përfshijnë:

- të ofrojnë informacion dhe këshillim për zhvillimin teknik e teknologjik të fermave bujqësore, me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë në bujqësi;
- të ofrojnë informacion dhe të asistojnë fermerët për të përfituar nga skemat mbështetëse kombëtare, IPARD-i dhe projekte të tjera në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- të nxisin dhe të ndihmojnë krijimin e funksionimin e formave të ndryshme të kooperimit të fermerëve;
- të organizojnë dhe të kryejnë trajnimin profesional të fermerëve në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- të sigurojnë informacion për standardet lidhur me mjedisin, cilësinë, marketingun, bujqësinë organike, produktet me tregues gjeografikë;
- të informojnë dhe të këshillojnë fermerët për përzgjedhjen dhe përdorimin e makinerive e të pajisjeve bujqësore, duke ofruar asistencë teknike pa pagesë.

27. Shih: https://bujqesia.gov.al/drejtorite-e-bujqesise/, dhe https://www.bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/2.1-struktura-AREB-TIRANE.doc

**Pesë Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore (QTTB)**[28] të vendosura në Fushë-Krujë, Shkodër, Vlorë, Lushnjë, dhe Korçë, u krijuan me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 515, datë 19.07.2006, «Për ristrukturimin e instituteve kërkimore-shkencore, në varësi të ministrisë së bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit.» Ndër to, QTTB Lushnjë është posaçërisht e fokusuar në perimet. Përgjegjësitë kryesore të QTTB-ve përfshijnë:

- identifikimin, testimin, përshtatjen dhe futjen, në praktikat bujqësore, të metodave dhe materialeve (inputeve) të reja;
- përgatitjen e paketave teknologjike për kulturat bujqësore kryesore dhe mbarështimin e bagëtive;
- kërkime dhe testime në ferma bujqësore për problemet e ngritura nga fermerët e rajoneve përkatëse;
- trajnime për specialistë të bujqësisë, fermerë, studentë të shkencave bujqësore dhe subjekte të tjera të interesuara;
- sigurimin e ekspertizës teknike për strukturat e shërbimit këshillimor dhe fermerët;
- demonstrimin e teknologjive të reja të kultivimit të kulturave bujqësore dhe mbarështimit të blegtorisë;
- përgatitjen dhe publikimin e materialeve informuese për specialistët e bujqësisë dhe fermerët;
- mbështetjen e hartimit të politikave nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në fushën e bujqësisë, ushqimit, mbrojtjes së konsumatorit dhe zhvillimit rural.

**Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB)**[29] është përgjegjës për garantimin e shëndetit dhe sigurisë së kafshëve, bimëve dhe prodhimeve bujqësore në Shqipëri. Ai operon në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe luan rol kyç në mbrojtjen e shëndetit të publikut, promovimin e qëndrueshmërisë bujqësore dhe lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare të prodhimeve bujqësore dhe ushqimore. Ndër përgjegjësitë kryesore të AKVMB-së përfshihen:

- Shërbimet veterinare: Monitorimi dhe kontrollimi i shëndetit të kafshëve, parandalimi i përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, dhe garantimi i sigurisë ushqimore në produktet me prejardhje shtazore.
- Mbrojtja e bimëve: Zbatimi i masave fitosanitare për parandalimin dhe kontrollimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve që mund të dëmtojnë prodhimin bujqësor.
- Roli rregullator për pesticidet dhe plehrat: Mbikëqyrja e importit, shpërndarjes, dhe përdorimit të pesticideve dhe plehrave, duke siguruar përmbushjen e standardeve të sigurisë.
- Siguria ushqimore dhe inspektimi: Kryerja e inspektimeve të fermave, mjediseve të përpunimit ushqimor, dhe tregjeve, për të siguruar që produktet përmbushin standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë ushqimore.
- Kontrolli kufitar dhe biosiguria: Menaxhimi i inspektimeve kufitare veterinare dhe fitosanitare për parandalimin e hyrjes së dëmtuesve, sëmundjeve dhe produkteve të pasigurta ushqimore në vend.
- Legjislacioni dhe zbatimi i ligjit: Hartimi dhe zbatimi i ligjeve, politikave dhe rregulloreve që lidhen me shërbimet veterinare dhe mbrojtjen e bimëve.
- Ndërtimi i kapaciteteve dhe trajnimet: Ofrimi i trajnimeve dhe mbështetjes për fermerët, veterinerët dhe specialistët bujqësorë për përmirësimin e praktikave më të mira në menaxhimin e shëndetit të bimëve dhe të kafshëve.

AKVMB-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është organizuar në nivel qendror nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme dhe në nivel rajonal, nëpërmjet katër drejtorive rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve në Elbasan, Vlorë, Shkodër, dhe Tiranë. Drejtoritë rajonale veprojnë brenda fushave të tyre të përgjegjësisë dhe kryejnë këto detyra:

- vlerësojnë nevojat dhe problematikat që lidhen me shërbimet veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve, dhe i propozojnë zgjidhje Drejtorisë së Përgjithshme;

28. Shih: https://bujqesia.gov.al/qendrat-e-transferimit-te-teknologjive-bujqesore-qttb/
29. Shih: https://akvmb.gov.al/

- planifikojnë nevojat për shërbime veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve dhe ia paraqesin ato Drejtorisë së Përgjithshme;
- koordinojnë dhe monitorojnë ofrimin e shërbimeve veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve në territorin e tyre;
- përgatisin raporte për marrjen e kampioneve, materialeve patologjike dhe rezultateve të analizave për sëmundje të dyshuara dhe konfirmuara;
- hartojnë raporte periodike për shkallën e infeksionit të bimëve dhe statusin e produkteve bimore;
- detajojnë dhe zbatojnë planet e punës të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- lëshojnë dokumente dhe certifikata sipas dispozitave ligjore, akteve nënligjore dhe autorizimeve të Drejtorisë së Përgjithshme;
- kryejnë detyra të tjera të ngarkuara sipas ligjit ose sipas urdhrave të Drejtorisë së Përgjithshme.

**Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)**[30] **është një institucion shtetëror në varësi të Ministrisë së** Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përgjegjës për inspektime dhe menaxhim në fushat e mbrojtjes së konsumatorit, mbrojtjes së bimëve dhe mbarështimit të kafshëve. AKU funksionon sipas Ligjit nr. 10433, datë 16.06 2011, «Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë», konkretisht neni 7, «Parimi i programit të inspektimeve». Koha e kryerjes së inspektimeve përcaktohet në programin vjetor të inspektimeve, por kryhen edhe inspektime rastësore kur kërkohet nga ligji. Neni 4 i të njëjtit ligj përcakton qëllimet e inspektimeve, ku përfshihen: i) vlerësimi i respektimit të kërkesave ligjore; ii) dokumentimi i praktikave të mira në respektimin e kërkesave ligjore; iii) këshillimi i subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore; iv) urdhërimi i korrigjimit të shkeljeve ligjore dhe eliminimit të pasojave të tyre; dhe, v) dhënia e dënimeve dhe marrja me masave administrative për shmangien e rreziqeve ndaj interesit publik.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) në Shqipëri është organi rregullator përgjegjës për sigurisë dhe cilësisë ushqimore dhe respektimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. AKU mbikëqyr të gjithë hallkat e furnizimit ushqimor, që nga prodhimi dhe përpunimi, deri tek shpërndarja dhe konsumi, dhe synon mbrojtjen e shëndetit publik dhe sigurisë së ushqimeve. Detyrat kryesore të tij përfshijnë:

- mbikëqyrjen dhe inspektimin e prodhimit, përpunimit të ushqimit dhe të mjediseve të shpërndarjes;
- garantimin e respektimit të rregulloreve dhe standardeve të sigurisë ushqimore;
- kryerjen e kontrolleve të cilësisë së ushqimeve dhe testimeve për të parandaluar kontaminimin dhe garantuar sigurinë e ushqimeve;
- zbatimin e ligjeve për sigurinë ushqimore dhe të rregulloreve të vendosura nga qeveria;
- koordinimin me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për harmonizimin e praktikave të sigurisë ushqimore;
- udhëzimin dhe trajnimin e bizneseve dhe palëve të interesit në industrinë ushqimore në lidhje me praktikat më të mira;
- lëshimin e certifikatave dhe miratimeve për prodhime ushqimore, sipas ligjit.

**Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF)**,[31] me seli në Tiranë, është institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ai financohet nga buxheti i shtetit dhe ka si objekt të punës së tij zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 10416, datë 07.04.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor" si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Misioni i ESHFF-së përfshin:

- mbrojtjen e interesave të fermerëve;
- shtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
- prezantimin e varieteteve të reja në treg;

30. Shih: https://aku.gov.al/
31. Shih: http://www.eshff.gov.al/

- përmirësimin e treguesve të cilësisë të materialit mbjellës që tregtohet;
- sigurimi i një konkurrence të ndershme në treg.

Institucioni monitoron rrjetin zonal për prova krahasuese për testimin e varieteteve të reja të prodhuara në vend ose të importuara, për riprodhim, shumëzim e tregtim. Mbi bazën e rezultateve të këtyre provave krahasuese dhe metodave laboratorike, ESHFF-ja bën vlerësimin dhe regjistrimin e varieteteve në Katalogun Kombëtar.

**Certifikimi organik** është një proces i gjatë, por me vlerë, sepse jep akses në tregjet globale dhe u mundëson bizneseve t'i marketojnë produktet e tyre si organike, me çmime më të larta dhe kërkesë më të madhe. Ky proces siguron që produktet të prodhohen sipas standardeve specifike të bujqësisë organike, që fokusohet në qëndrueshmërinë dhe ruajtjen e mjedisit, dhe përjashtimin e kimikateve sintetike dhe organizmave të modifikuara gjenetikisht (OMGJ). Certifikimi kërkohet për bizneset që dëshirojnë t'i reklamojnë dhe shesin produktet e tyre si 'organike', sidomos në tregjet ndërkombëtare.

Parlamenti i Shqipërisë ka miratuar kohët e fundit Ligjin nr. 104/2024 "Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre".[32] Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i parimeve dhe i rregullave për prodhimin organik, certifikimin dhe përdorimin e treguesve që i referohen prodhimit organik në etiketim dhe reklamim. Ai gjithashtu përcakton rregullat për kontrollin zyrtar, përveç sa parashikohet në legjislacionin në fuqi për kontrollet zyrtare. Fazat kyçe për certifikimin organik janë:

- **Aplikimi fillestar:** Biznesi dorëzon aplikimin në organin e akreditуar të certifikimit organik.
- **Inspektimi i fermës ose operatorit:** Kryhet inspektim në terren nga trupa certifikuese për të siguruar respektimin e standardeve të bujqësisë organike dhe të përpunimit organik. Ky inspektim përfshin kontrollin e dokumenteve, metodave të prodhimit dhe praktikave mjedisore.
- **Mbajtja e dokumentacionit dhe e të dhënave:** Bizneset duhet të mbajnë dokumentacion të hollësishëm të praktikave të tyre bujqësore (plehrat, pesticidet, etj.) rotacionin e kulturave bujqësore, menaxhimin e tokës dhe praktika të tjera përkatëse. Ky dokumentacion ndihmon garantimin e transparencës dhe gjurmueshmërisë.
- **Rishikimi i praktikave dhe procedurave:** Trupa certifikuese shqyrton praktikat e biznesit dhe i krahason ato me standardet organike. Kjo përfshin garantimin e mospërdorimit të substancave të ndaluara (si kimikate sintetike apo OMGJ) dhe që metodat e prodhimit mbështesin ruajtjen afatgjatë të një mjedisi të shëndetshëm.
- **Vendimi i certifikimit:** Pas inspektimit dhe shqyrtimit, trupa certifikuese merr një vendim. Në qoftë se biznesi konstatohet se i përmbush standardet organike, ai merr certifikatën organike.
- **Inspektime në vijimësi:** Certifikimi organik kërkon inspektime dhe auditime të përvitshme për vazhdimin e certifikimit. Bizneset duhet të vazhdojnë t'u përmbahen standardeve dhe çdo ndryshim në praktika duhet të dokumentohet dhe miratohet.

Procesi i certifikimit zakonisht merr 2-3 vjet, sepse bizneset duhet të tregojnë se u janë përmbajtur praktikave organike për të paktën atë periudhë. Gjatë kësaj kohe, bizneseve u jepet statusi i ndërmjetëm "në proces certifikimi organik."

32. Ky ligj është pjesërisht i harmonizuar me Rregulloren e BE-së nr. 2018/848 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 30 maj 2018, mbi prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike, që shfuqizoi Rregulloren e Këshillit nr. 834/2007. Për më shumë shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/09/ligj-nr.-104-dt.-19.9.2024-prodhimi-organik.docx

## 2.3 KONSTATIMET E STUDIMIT

### Kufizimet në prodhimin e qepës në postribë:

1. **Cenueshmëria në treg dhe mungesa e stabilitetit të çmimeve**

Prodhuesit e qepëve në Postribë janë tejet të ekspozuar ndaj luhatjeve të çmimeve në treg, sikurse ndodhi në vitin 2024 kur çmimet ranë me pothuaj 50%. Kjo varësi nga një numër i vogël kanalesh të tregut, së bashku e mungesën e rregullimit të çmimeve dhe kontratave, i lë fermerët në pasiguri financiare dhe shkurajon investimet afatgjata.

2. **Mungesa e mekanizimit dhe infrastruktura e pamjaftueshme për proceset pas vjeljes**

Pjesa më e madhe e veprimtarive bujqësore kërkojnë punë të rëndë fizike dhe kryhen me punë krahu, sidomos nga gratë. Mungesa e mjeteve të mekanizuara – së bashku me mungesën e ambienteve të magazinimit, pikave dhe qendrave të grumbullimit – kufizon efikasitetin e prodhimit dhe çon në humbje të konsiderueshme pas vjeljes.

3. **Kostot e larta të prodhimit dhe marzhet e kufizuara të fitimit**

Ndërsa kostot e prodhimit (pa punën) vlerësohen rreth 20-25 lekë/kg, rënia e ndjeshme e çmimeve në treg në vitin 2024 i zvogëloi së tepërmi marzhet e fitimit. Duke qenë se forca punëtore shpesh përbëhet nga anëtarë të familjes, kostot e vërteta nuk janë të pasqyruara në tërësi, duke e fshehur më tej barrën ekonomike të familjeve.

4. **Aksesi i kufizuar në shërbimet e ekstensionit bujqësor dhe njohuri teknike**

Shumica e fermerëve kështillat i marrin nga furnizuesit e inputeve bujqësore, që jo gjithmonë janë të sakta apo u përgjigjen nevojave të tyre. Mbështetja zyrtare për praktikat e mira bujqësore, menaxhimin e dëmtuesve, përshtatjen klimatike apo procedurat e certifikimit, është shumë e vogël.

5. **Pabarazia gjinore në kushtet e punës**

Megjithëse gratë kanë rol qendror në prodhimin e qepës, ato shpesh punojnë në kushte të vështira, pa mjete të mekanizuara, pa veshje mbrojtëse, dhe pa njohje formale të punës së tyre. Puna e tyre është thelbësore, por e pavlerësuar dhe e pambështetur.

6. **Emigrimi i të rinjve dhe moshimi i fuqisë punëtore**

Eksodi i brezave të rinj nga zonat rurale po bën që fermerët të jenë gjithnjë e më të moshuar, me mundësi të kufizuara inovacioni dhe vijimësie, që kërcënon qëndrueshmërinë e kultivimit të qepës në zonë.

7. **Cenueshmëria nga kushtet klimatike dhe praktikat jo të qëndrueshme**

Stinët e thata të zgjatura dhe ndryshimet në kushtet e motit ndikojnë si në nivelet e prodhimit, ashtu edhe efektivitetin e inputeve. Praktikat tradicionale dhe përdorimi i pesticideve pa mbikëqyrjen e ekspertëve, përbëjnë rrezik për shëndetin e mjedisit dhe të njerëzve.

### Mundësitë në prodhimin e qepës në postribë:

1. **Forcimi i zinxhirit të vlerës dhe i brandit të qepës së Drishtit**

Regjistrimi i qepës së Drishtit si produkt me tregues gjeografik ofron një platformë të shkëlqyer për promovimin e saj si një produkt tradicional me vlerë të lartë. Kjo mund të çojë në një dukshmëri më të madhe në treg, akses në tregje të veçanta, dhe çmime optimale në qoftë se shoqërohet me përpjekjet për krijimin e brandit dhe marketing.

2. **Mekanizimi për fermerët e vegjël**

Futja e mekanizimit që i përshtatet fermave të vogla dhe përdorimi i përbashkët i pajisjeve mund të shtojë ndjeshëm efikasitetin e punës, të reduktojë ngarkesën e punës fizike (sidomos për gratë) dhe të rrisë prodhimin.

3. **Krijimi i pikave të grumbullimit dhe magazinimit**

Krijimi i infrastrukturës bazë për fazën e pasvjeljes, si mjediset për tharjen e qepës ose qendrat e grumbullimit, do të pakësonin humbjet, do të mundësonin shitjet me shumicë, dhe do të mundësonin akses në tregje me vlerë më të lartë përmes kontrollit të përmirësuar të cilësisë.

4. **Ndërtimi i kapaciteteve dhe trajnimi teknik**

Ofrimi i trajnimeve të strukturuara për praktikat e mira bujqësore (PMB), menaxhimin e dëmtuesve, teknikat e ujitjes, dhe përdorimin e qëndrueshëm të inputeve do të shtonte produktivitetin dhe do të pakësonte rreziqet mjedisore. Trajnimet e organizuara posaçërisht për gratë gjithashtu mund të promovojnë barazinë në trajtim dhe efektivitetin e punës.

**5. Ndërhyrjet dhe mbështetja me ndjeshmëri gjinore**
Mbështetja e grave me anë të investimeve të posaçme – si për akses në vegla pune, kredi, trajnim dhe kanale të tregut – do të përmirësonte jetesën e tyre dhe të familjeve të tyre dhe do të forconte aftësinë e familjeve fermere për përballimin e situatave të krizave.

**6. Diversifikimi i tregut dhe shitjet e drejtpërdrejta**
Fuqizimi i fermerëve, sidomos i grave, për t'u përfshirë në marketing të drejtpërdrejtë (p.sh. në restorante, panaire vendore, ose platforma në internet) mund të shtojë të ardhurat dhe të pakësojë varësinë nga tregjet e paqëndrueshme me shumicë.

**7. Zbatimi i praktikave të qëndrueshme klimatike**
Me trajnimet dhe stimujt e duhur, fermerët mund të zbatojnë praktika që i përshtaten më mirë klimës, si mbulimi i tokës, ujitja me pika ose rotacioni i kulturave – që ndihmojnë zbutjen e rreziqeve që i kanosen prodhimit dhe përmirësojnë përdorimin me efikasitet të burimeve.

**8. Përfshirja e rinisë dhe mbështetja e inovacionit**
Nxitja e të rinjve që të përfshihen në bujqësi përmes trajnimeve për sipërmarrje, mjeteve digjitale, ose programeve të granteve, mund të nxisë inovacionin në sektor dhe të kthejë mbrapsht tendencën e migracionit.

**Në Lidhje me Çështjet e Pabarazisë Gjinore dhe të Përfshirjes së Grave**, informacioni i mbledhur nga takimet dhe intervistat tregon se kultivimi i qepëve në Postribë mbështetet shumë në punën e grave, megjithatë kontributet e tyre shpesh nuk njihen dhe kushtet e punës së tyre vazhdojnë të jenë të vështira. Ndonëse gratë kanë rol të rëndësishëm në mbjelljen, vjeljen, dhe punët pas vjeljes, ato përballen me barriera sistemike që kufizojnë produktivitetin, të ardhurat, dhe fuqinë vendimmarrëse të tyre. Në të njëjtën kohë, ekzistojnë mundësitë për fuqizimin e grave fermere dhe për rritjen e qëndrueshmërisë së përgjithshme të prodhimit të qepës në rajon.

Gratë në Postribë mbajnë barrën kryesore në prodhimin e qepës – ato kryejnë pjesën më të madhe të punës së krahut, si heqja e barërave të këqija, klasifikimi dhe tharja e qepëve – shpesh pa veglat apo pajisjet mbrojtëse të duhura. Duke qenë se puna e tyre është shpesh e papaguar (e klasifikuar si "punë në familje"), kontributet e tyre ekonomike nënvlerësohen. Kjo padukshmëri shtrihet edhe sa i përket aksesit në burime; gratë kanë më pak mundësi se burrat të marrin trajnim bujqësor, shërbime financiare, ose informacion për

**Ndonëse gratë kanë rol të rëndësishëm në mbjelljen, vjeljen, dhe punët pas vjeljes, ato përballen me barriera sistemike që kufizojnë produktivitetin, të ardhurat, dhe fuqinë vendimmarrëse të tyre.**

tregun. Në vend të kësaj, shumë prej tyre mbështeten në këshillat që marrin nga furnizuesit e inputeve – ku mbizotërojnë burrat – që jo gjithmonë **përputhen me nevojat specifike të tyre**. Mungesa e mekanizimit i përkeqëson më shumë dallimet gjinore. Ndërsa burrat shpesh merren me punë si plugimi (ndonjëherë me mjete të marra me qira) gratë kryejnë punët më të rënda me punë krahu. Kjo jo vetëm që rrit ngarkesën, por edhe kufizon potencialin e tyre prodhues dhe për fitimin e të ardhurave. Krahas kësaj, duke qenë se puna e grave rrall**ë faktorizohet në llogaritjet zyrtare të kostos, ngarkesa e vërtetë e punës e grave fermere mbetet e fshehur, duke përforcuar kështu ciklet e pabarazisë**.

Me gjithë këto vështirësi, ekzistojnë mundësi e mënyra të qarta për përmirësimin e barazisë gjinore në zinxhirin e vlerës të qepës në Postribë. Një nga mundësitë kyçe është mekanizimi që u përgjigjet nevojave gjinore – futja e pajisjeve të vogla dhe jo të shtrenjta të punës, (si mbjellës dore ose shkulës mekanikë të barërave të këqija) që mund të reduktojnë në mënyrë drastike ngarkesën fizike të grave, ndërkohë që rrisin efikasitetin.

Duke qenë se gratë aktualisht janë mjaft të përfshira në punët e përditshme bujqësore, pajisja e tyre me teknologjinë e duhur do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në produktivitet. Një hap tjetër kritik është organizimi i trajnimeve të posaçme për gratë, ku të trajtohen tema si teknikat e bujqësisë së qëndrueshme, menaxhimi i dëmtuesve dhe njohuritë financiare.

Gratë shpesh nuk kanë akses në shërbimet zyrtare të ekstensionit bujqësor, ndaj trajnimet nga ekipe të lëvizshme në kurse të drejtuara nga gratë në terren mund ta ngushtojë këtë hendek. Përveç kësaj, duke qenë se qepa e Drishtit tani ka statusin e produktit me tregues gjeografik të regjistruar, ofrimi i mbështetjes së posaçme mund t'i ndihmojë gratë në krijimin e brandit, paketim dhe shitje të drejtpërdrejtë, duke u mundësuar të nxjerrin më shumë vlerë nga produkti i vjelë.

Forcimi i kooperativave ose grupeve prodhuese të grave mund të fuqizojë edhe zërin e tyre në treg. Përmes bashkimit të burimeve, gratë mund të negociojnë çmime më të favorshme, të kenë akses në blerës me shumicë dhe të investojnë në depo magazinimi të përbashkëta – duke reduktuar humbjet pas vjeljes dhe duke shtuar të ardhurat e tyre. Përpos kësaj, integrimi i konsideratave gjinore **në strategjitë e përshtatjes me ndryshimet klimatike do t'i bëjë fermat më të qëndrueshme** dhe do të fuqizojnë gratë fermere si agjente të rëndësishme të ndryshimit.

Trajtimi i pabarazisë gjinore në prodhimin e qepës në Postribë nuk ka të bëjë thjesht me trajtimin e barabartë mes grave dhe burrave – ai është thelbësor edhe për qëndrueshmërinë afatgjatë **të fermave**. Kur gratë kanë akses në burime, trajnim dhe mundësi në treg, produktiviteti i fermave rritet, të ardhurat e familjes përmirësohen, dhe i gjithë zinxhiri i vlerës përfiton. Duke investuar në gratë fermere përmes mekanizimit, edukimit dhe politikave përfshirëse, Postriba mund ta transformojë prodhimin e qepës në një zinxhir vlere që është më i barabartë dhe më i begatë për të gjithë.

**Në Lidhje me Mundësitë e Financimit,** për shumë familje në Postribë, prodhimi i qepës është burimi kryesor i të ardhurave, ku fitimet merren pas shitjes së produktit në treg. Megjithatë, fermat e vogla kanë pengesa financiare të konsiderueshme. Fermerët e vegjël shpesh nuk punojnë mbi bazën e kontratave formale dhe sistemeve transparente, që ua bën të vështirë të demonstrojnë qëndrueshmëri të biznesit dhe të sigurojnë mbështetje financiare.

Mikrokredia përfaqëson një instrument të rëndësishëm financimi për fermerët e vegjël në Shqipëri, sidomos për ata që janë të përjashtuar nga sistemet bankare tradicionale për shkak të aksesit të ulët në kolateral, mungesës së strukturave formale të biznesit, dhe nivelit të lartë të riskut. Institucionet e mikrokredisë ofrojnë kredi të vogla që janë më të aksesueshme dhe shpesh kanë kërkesa më pak të rrepta, krahasuar me kreditë nga bankat tradicionale. Këto kredi mund t'i ndihmojnë fermerët e vegjël që të investojnë në pajisje, të përmirësojnë infrastrukturën ose të rrisin produktivitetin. Megjithatë, mikrokreditë për fermerët e vegjël në Shqipëri shoqërohen edhe me probleme. Megjithëse mikrokreditë janë të disponueshme në zonat rurale, aksesi në këto produkte financiare është i kufizuar, sidomos në zonat e thella ku fermerët mund të mos kenë dijeni për shërbimet ekzistuese, ose mund të kenë vështirësi të plotësojnë kriteret për ato kredi.

Norma e interesit në institucionet e mikrokredisë mund të jetë më e lartë krahasuar me institucionet financiare tradicionale, gjë që mund ta shtojë barrën financiare të fermerëve të vegjël, duke ua bërë më të vështirë t'i shlyejnë ato. Shumë fermerë të vegjël kanë njohuri të kufizuara se si të menaxhojnë financimet, të aplikojnë për kredi, ose të vlerësojnë kostot dhe përfitimet e marrjes së kredisë, që mund të çojnë në vendimmarrje të gabuar dhe vështirësi në shlyerjen e mikrokredisë.

Mundësitë për përmirësimin e aksesit në mikrokredi:

- Ndërgjegjësimi për mundësitë ekzistuese për marrjen e mikrokredive dhe shtimi i njohurive financiare mund t'i ndihmojë fermerët e vegjël që t'i kuptojnë më mirë dhe të kenë më shumë akses në këto burime. Dhënia e udhëzimeve se si të aplikojnë për kredi dhe si të menaxhojnë shlyerjen e tyre, do t'i ndihmonte fermerët t'i përdorin mikrokreditë më me efektivitet.

- Krijimi i produkteve të posaçme të kreditit për nevojat të grave fermere (p.sh., kredi me normë interesi të ulët për blerjen e inputeve, pajisjeve, ose për ndërtimin e objekteve të magazinimit) mund të pakësojë ngarkesën financiare dhe të përmirësojë produktivitetin.

- Mundësimi i programeve të kredive në grup, ku fermerët e vegjël, sidomos gratë, të mund të aplikojnë bashkërisht për kredi si kooperativë, gjë që mund të pakësojë rreziqet dhe të përmirësojë aksesin në kredi.

- Forcimi i partneriteteve midis institucioneve të mikrokredisë dhe skemave mbështetëse shtetërore mund të rrisë aksesin në kredi me normë interesi të ulët dhe në produkte të tjera financiare, duke u mundësuar grave fermere të vogla të investojnë në përmirësime afatgjata në veprimtarinë e tyre të punës.

## 2.4 REKOMANDIME PËR ZHVILLIMIN E ZINXHIRIT TË VLERËS TË QEPËS NË POSTRIBË, ME FOKUS MBI GRATË

### 1. Forcimi i rolit të grave në zinxhirin e vlerës përmes mbështetjes së posaçme

- **Krijimi i grupeve ose kooperativave me fokus gratë fermere** Të ndihmohet krijimi dhe regjistrimi zyrtar i grupeve ose kooperativave prodhuese të grave për të shtuar fuqinë e tyre negociuese kolektive, për të përmirësuar aksesin në tregje dhe për të mundësuar përdorimin e përbashkët të burimeve, si ambientet e tharjes, qendrat e paketimit, dhe transportin.

- **Ofrimi i trajnimeve teknike dhe ndërtim kapacitetesh me ndjeshmëri gjinore** Të organizohen programe trajnimi për gratë mbi:

  - praktikat e mira bujqësore (PMB) dhe menaxhimin e integruar të dëmtuesve;
  - teknikat e trajtimit dhe magazinimit të qepëve pas vjeljes;
  - njohuri financiare, aftësi digjitale dhe mbajtjen e dokumentacionit;
  - rol drejtues, negociim dhe drejtim të kooperativës.

- **Futja e teknologjive dhe mjeteve të punës që kursejnë punën e krahut** Të mbështetet aksesi në pajisje bujqësore jo të kushtueshme dhe të lehta për t'u përdorur (për shembull, mbjellës, shkulës të barërave të këqija, mini-traktorë) që lehtësojnë punët e rënda fizike që tradicionalisht kryhen nga gratë. Veglat e punës duhet të mbajnë parasysh parimet ergonomike, për t'iu përshtatur nevojave të grave.

### 2. Përmirësimi i aksesit në treg dhe i diferencimit të produktit

- **Shfrytëzimi i statusit të qepës së Drishtit si produkt me tregues gjeografik të regjistruar (TGJ)** Të hartohet një strategji marketingu për brandin e qepës së Drishtit që thekson traditën, cilësinë dhe rolin e grave në prodhim.

- **Krijimi i kanaleve për shitje të drejtpërdrejtë, të drejtuara nga gratë** Të testohen nisma marketingu të drejtuara nga gratë, si:

  - platforma në internet për shitje të drejtpërdrejtë të qepës tek konsumatori;
  - partneritete me restorantet dhe pikat e shitjes në zonë.

- **Lehtësimi i lidhjeve me blerës dhe eksportues institucionalë** Të mbështeten kontratat ose marrëveshjet paraprake me blerës si supermarkete, institucione publike (shkolla, spitale), dhe eksportues, të cilët gjithnjë e më shumë po kërkojnë prodhime të gjurmueshme të prodhuara në zonë.

### 3. Investime në infrastrukturën e grumbullimit dhe magazinimit

- **Krijimi i një objekti grumbullimi dhe magazinimi me bazë në komunitet** Të ngrihet ose rehabilitohet një qendër e menaxhuar nga gratë për grumbullim dhe magazinim në Postribë, me ajrim të përshtatshëm, rafte për tharje, dhe tryeza për renditjen dhe klasifikimin e qepëve. Kjo do të mundësojë:

  - ruajtjen afatgjatë të qepëve
  - marketingun me shumicë të qepëve
  - pakësimin e humbjeve pas vjeljes

- **Zgjidhje magazinimi të thjeshta dhe të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike** Të promovohet krijimi i depove jo të kushtueshme, të ajrosura mirë, për ruajtjen e qepëve, si dhe i njësive tharëse me energji diellore për përdorim familjar ose në grup – të projektuara dhe menaxhuara nga gratë fermere.

### 4. Lehtësimi i aksesit të grave në financim dhe subvencione për inputet

- **Skema grantesh ose mikrokredie me ndjeshmëri gjinore** Të bashkëpunohet me institucionet financiarë ose partnerë zhvillimorë për t'u dhënë grave fermere mikrokredi ose grante të vogla fleksibël për:

  - blerjen e pajisjeve;
  - blerjen e farave dhe inputeve të certifikuara;
  - ndërtimin e njësive të vogla për magazinim ose qendrave të paketimit.

- **Mbështetje për subvencione** Të krijohen skema për reduktimin e kostos së inputeve të domosdoshme (qepujkave, plehrave organike, veshjeve dhe pajisjeve mbrojtëse), sidomos për familjet me kryefamiljare gratë.

**5. Shtimi i ndihmës institucionale dhe këshillimore**

- **Vendosja e shërbimeve të ekstensionit bujqësor me vëmendje në çështjet gjinore** Të punohet me partnerë publikë ose privatë për të siguruar që shërbimet e ekstensionit bujqësor:
  - të kontaktojnë aktivisht me gratë fermere;
  - të përfshijnë gra si specialiste të ekstensionit, ose formate që u përshtaten grave (për shembull, demonstrime në terren/fermë, grupe mësimore për shkëmbim të njohurive);
  - të trajtojnë pengesat specifike gjinore, si mungesa e kohës dhe e mundësisë së lëvizjes.

**6. Promovimi i përfshirjes së rinisë dhe përfshirjes gjinore përmes Inovacionit**

- **Mbështetja e grave dhe të rinjve sipërmarrës në bujqësi** Të krijohen sfida të vogla për inovacion ose biznese të reja, duke i nxitur gratë dhe të rinjtë e të rejat që të propozojnë zgjidhje inteligjente (p.sh. eko-paketim, mjetet digjitale për menaxhimin e fermës, etj.).
- **Sigurimi i fondeve për fara dhe këshillim**
- **Përdorim i TIK dhe platformave mobile për komunikim përfshirës** Të shpërndahet informacion për çmimet e tregut, njoftime për motin, video trajnuese dhe rekomandime për inputet përmes mjeteve TIK – që janë të aksesueshme dhe të përshtatshme për gratë me nivel të ulët shkollimi ose që kanë mundësi lëvizjeje të kufizuar.
- **Rekomandim i përgjithshëm: Monitorimi i rezultateve gjinore**Të vendoset një sistem monitorimi dhe vlerësimi reagues gjinor për të vlerësuar se si ndikojnë ndërhyrjet në të ardhurat, ngarkesën e punës, fuqinë vendimmarrëse, dhe pjesëmarrjen e grave. Kjo mund të ndihmojë për përshtatjen e strategjive dhe për t'u treguar rezultatet e arritura donatorëve dhe grupeve të interesit.

**Tabela 8.** Rekomandime për zinxhirin e vlerës së qepës

| Nr. | Veprimtaria | Impakti | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Afatshkurtër | Afatmesëm | Afatgjatë |
| 1 | **Forcimi i rolit të grave në zinxhirin e vlerës përmes mbështetjes së posaçme** | | | |
| 1.1 | Krijimi i grupeve ose kooperativave me fokus mbi gratë fermere<br>o Të ndihmohet krijimi dhe regjistrimi ligjor i grupeve ose kooperativave prodhuese.<br>o Të shtohet fuqia negociuese kolektive e tyre, për të përmirësuar aksesin në tregje dhe për të mundësuar përdorimin e përbashkët të burimeve , si ambientet e tharjes, qendrat e paketimit, dhe transporti. | X | X | X |
| 1.2 | Ofrimi i trajnimeve teknike dhe ndërtim kapacitetesh me ndjeshmëri gjinore, për<br>o Praktikat e mira bujqësore (PMB) dhe menaxhimin e integruar të dëmtuesve<br>o Teknikat e trajtimit dhe magazinimit të qepëve pas vjeljes<br>o Njohuri financiare, aftësi digjitale dhe mbajtjen e dokumentacionit<br>o Rol drejtues, negociim dhe drejtimin e kooperativës. | X | X | X |

| Nr. | Veprimtaria | Impakti | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Afatshkurtër | Afatmesëm | Afatgjatë |
| 1.3 | Futja e teknologjive dhe veglave të punës që kursejnë punën e krahut<br>o Mbështetje e aksesit në pajisje bujqësore jo të kushtueshme dhe të lehta për t'u përdorur (për shembull, mbjellës, shkulës të barërave të këqija, mini-traktorë).<br>o Veglat e punës të jenë ergonomike dhe t'u përgjigjen nevojave të grave. | X | X | X |
| 2 | **Përmirësimi i aksesit në treg dhe i diferencimit të produktit** | | | |
| 2.1 | Shfrytëzimi i statusit të qepës së Drishtit si produkt me tregues gjeografik të regjistruar (TGJ):<br>o Të hartohet një strategji marketingu për markën e qepës së Drishtit që vë në pah traditën, cilësinë dhe rolin e grave në prodhim. | X | X | X |
| 2.2 | Krijimi i kanaleve për shitje të drejtpërdrejtë, nën drejtimin e grave<br>o Të krijohen platforma në internet për shitje të drejtpërdrejtë të qepës tek konsumatorët.<br>o Të krijohen partneritete me restorantet dhe pikat e shitjes në zonë për nismat e marketingut të drejtuara nga gratë. | | X | X |
| 2.3 | Lehtësimi i lidhjeve me blerësit:<br>o Të mbështeten kontratat ose marrëveshjet paraprake me blerësit, si për shembull, tregtarët me shumicë. | | X | X |
| 3 | **Investime në infrastrukturën e grumbullimit dhe magazinimit** | | | |
| 3.1 | Krijimi i objekteve të grumbullimit dhe magazinimit:<br>o Të mbështetet krijimi i qendrave të vogla, të menaxhuara nga gratë, për magazinim dhe grumbullim të produktit në Postribë.<br>o Të ofrohet ndihmë që qendra të ketë ajrim, rafte për tharje dhe tryeza për renditjen dhe klasifikimin e qepëve.<br>o Për ruajtjen më afatgjatë të produktit, mundësimin e marketingut me shumicë dhe pakësimin e humbjeve pas vjeljes. | | X | X |
| 3.2 | Zgjidhje të thjeshta dhe të qëndrueshme klimatike për magazinimin:<br>o Të promovohen depo jo të kushtueshme, të ajrosura mirë, për ruajtjen e qepëve dhe të njësive tharëse me energji diellore për përdorim familjar ose në grup. | | X | X |
| 4 | **Lehtësimi i aksesit të grave në financim dhe subvencione për inputet** | | | |
| 4.1 | Skema grantesh ose mikrokredie me ndjeshmëri gjinore:<br>o Të bashkëpunohet me institucionet financiarë ose partnerë zhvillimorë për ofrimin e mikrokredive ose granteve të vogla për:<br>✓ Blerjen e pajisjeve.<br>✓ Blerjen e farave dhe inputeve të certifikuara.<br>✓ Ndërtimin e njësive të vogla për magazinim ose qendrave të paketimit | | X | X |

*(Vazhdon në faqen tjetër)*

| Nr. | Veprimtaria | Impakti | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Afatshkurtër | Afatmesëm | Afatgjatë |
| 4.2 | o Mbështetje me subvencione:<br>o Të krijohen skema për reduktimin e kostos së inputeve të domosdoshme (qepujkave, plehrave organike, veshjeve dhe pajisjeve mbrojtëse) për gratë kryefamiljare. | | X | X |
| 5 | **Shtimi i ndihmës institucionale dhe këshillimore** | | | |
| 5.1 | Shërbime të ekstensionit bujqësor që kanë në vëmendje çështjet gjinore:<br>o Të sigurohet që shërbimet e ekstensionit bujqësor të kontaktojnë aktivisht me gratë fermere përmes grave specialiste të ekstensionit ose formateve që u përshtaten grave (p.sh., demonstrime në fermë, grupe mësimore për shkëmbim të njohurive).<br>o Të trajtohen pengesat specifike gjinore si mungesa e kohës dhe e mundësive të lëvizjes. | | X | X |
| 6 | **Promovimi i përfshirjes së rinisë dhe përfshirjes gjinore përmes inovacionit** | | | |
| 6.1 | Mbështetje e grave dhe të rinjve sipërmarrës bujqësorë:<br>o Të prezantohen sfida të vogla novacioni ose të bizneseve të reja, duke i nxitur gratë dhe të rinjtë që të propozojnë zgjidhje inteligjente (p.sh. eko-paketimi, mjetet digjitale për menaxhimin e fermës, etj.).<br>o Të jepen fonde për fara dhe këshillim. | | X | X |
| 6.2 | Përdorim i TIK dhe platformave mobile për komunikim përfshirës:<br>o Të shpërndahet informacion për çmimet e tregut, njoftime për motin, video trajnuese, dhe rekomandime për inputet përmes mjeteve TIK që janë të aksesueshme nga gratë me shkollim të ulët ose mundësi lëvizjeje të kufizuar. | | X | X |

Impakti i këtyre aktiviteteve do t'i fuqizojë gratë përmes forcimit të rolit të tyre drejtues, aksesit në treg, dhe aftësive bujqësore , që do të çojë në rritje të pavarësisë ekonomike dhe produktivitetit të tyre. Gratë do të përfitojnë nga një fuqi negociuese më e madhe, përmirësim i proceseve pas vjeljes, dhe akses në një infrastrukturë magazinimi të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike, që pakëson humbjet dhe siguron ruajtjen më afatgjatë të produktit. Përfshirja në financim përmes granteve dhe mikrokredive, së bashku me trajnimet dhe shërbimet këshillimore që u përgjigjen nevojave të grave, do t'u mundësojnë grave të investojnë në fermat e tyre. Krahas kësaj, mbështetja e inovacionit dhe përfshirjes së rinisë do të nxisë sipërmarrjen dhe do të promovojë barazinë gjinore, duke krijuar qëndrueshmëri dhe aftësi afatgjatë për përballimin e situatave në sektorin e bujqësisë.

Partnerët vendorë/Bashkëpunimi: Partnerë potencialë për këto veprimtari përfshijnë agjenci qeveritare si Ministria e Bujqësisë dhe organet e qeverisjes vendore për mbështetjen me politika, infrastrukturë dhe programe trajnimi; organizata zhvillimore për mbështetje me financim dhe mbështetje teknike; partnerë nga sektori privat, si furnizues të inputeve, agrobiznese, dhe institucione financiare për sigurimin e veglave të punës, kredive, dhe aksesit në treg; institucione publike dhe private të këtij sektori, përfshirë OSHC, për kërkime shkencore, ndërtim kapacitetesh dhe zbatim në terren; dhe tregtuesi me pakicë, restorante dhe tregtues me shumicë për krijimin e lidhjeve të drejtpërdrejta të grave prodhuese me tregun. Këta partnerë mund të bashkëpunojnë për forcimin e rolit të grave në zinxhirin e vlerës përmes financimit, trajnimeve, infrastrukturës dhe aksesit në treg.

Pjesa 4
**Shtojca**

# Shtojca 1. Bashkia Shkodër: Vështrim i Përgjithshëm

Bashkia Shkodër ka një sipërfaqe prej 872,71 km², dhe përbëhet nga 11 njësi administrative: Shkodër, Ana e Malit, Bërdica, Dajçi, Guri i Zi, Postriba, Pulti, Rrethinat, Shala, Shoshi, dhe Velipoja. Ajo administron një qendër urbane dhe 92 fshatra.

Me ndarjen e re territoriale dhe administrative, bashkia ka një pozitë gjeografike që përfshin zonën bregdetare dhe bujqësore në jug dhe rajonin më malor të Shqipërisë në veri. Në perëndim ajo kufizohet me liqenin e Shkodrës, me rëndësi të konsiderueshme kombëtare dhe ndërkombëtare për lidhjet me Malin e Zi. Në veçanti, nga perspektiva e marrëdhënieve ndërkufitare, pozita e favorshme gjeografike mundëson lidhje territoriale, ekonomike dhe natyrore ndërmjet Shkodrës, Malit të Zi dhe Kosovës, duke e bërë atë një vend me rëndësi strategjike për gjithë rajonin. Bashkia Shkodër karakterizohet nga një shumëllojshmëri aktivitetesh ekonomike, me elementë të industrisë, energjetikës, turizmit dhe zonave ekonomike. Vërehet se baza ekonomike përbëhet nga biznese të vogla që janë edhe katalizatorë për zhvillim, sepse krijimi, rritja dhe përmirësimi i këtyre bizneseve përfaqëson një potencial të konsiderueshëm për rritje ekonomike. Bizneset kryesore që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik përqendrohen më së shumti në industrinë e lehtë, përpunimin dhe prodhimin e materialeve tekstile, si dhe në tregti dhe biznese shërbimi. Si zonë e njohur prodhuese e produkteve bujqësore dhe blegtorale, Shkodra ka një prani të spikatur të bizneseve të agropërpunimit të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë.

Gjithashtu, aty janë të pranishme edhe bizneset e zejtarisë, me traditë të vjetër në Shkodër që vazhdon edhe sot, duke luajtur një rol të veçantë në ekonominë e zonës. Industria përpunuese përbën një prej potencialeve më të mëdha të zhvillimit në Shkodër.

Në zonën fushore ka një sipërfaqe të madhe toke bujqësore me prodhimtari të lartë e cilësore. Në veçanti, njësitë administrative të Bërdicës, Velipojës, Dajçit, Gurit të Zi, dhe Postribës kanë avantazh të konsiderueshëm në fushën e zhvillimit bujqësor. Sa u përket prodhimeve bujqësore, Shkodra ka një shumëllojshmëri kulturash bujqësore në të gjithë territorin e bashkisë gjatë gjithë vitit.

**Tabela 9.** Ndarja e bashkisë në lagje, njësi administrative dhe fshatra

| Bashkia | NJA | Fshatra |
|---|---|---|
| Shkodër | Shkodër | Qyteti i Shkodrës, pesë lagje |
| Shkodër | Ana e Malit | Oblikë, Babot, Muriqan, Shtuf, Dramosh, Oblikë e Sipërme, Obot, Vallas, Velinaj, Vidhgar |
| Shkodër | Dajç | Dajç, Samrisht i Ri, Samrisht i Sipërm, Belaj, Mali i Gjymtit, Pentar, Rrushkull, Mushan, Darragjat, Suka-Dajç, Shirq |
| Shkodër | Bërdicë | Bërdicë e Madhe, Bërdicë e Mesme, Bërdicë e Sipërme, Trush, Beltoje, Mali Hebaj |
| Shkodër | Guri i Zi | Guri i Zi, Juban, Ganjollë, Kuç, Rrencë, Vukatanë, Gajtan, Rragam, Sheldi, Mazrek, Shpor |
| Shkodër | Postribë | Mes, Dragoç, Boks, Kullaj, Myselim, Drisht, Ura e Shtrenjtë, Domen, Shakotë, Prekal, Vilëz |
| Shkodër | Pult | Pog, Kir, Gjuraj, Plan, Xhan, Bruçaj, Mgull |

*(Vazhdon në faqen tjetër)*

| | | |
|---|---|---|
| Shkodër | Shalë | Breg-Lumi, Abat, Nicaj-Shale, Lekaj, Vuksanaj, Pecaj, Theth, Nderlysaj, Gimaj, Nënmavriq, Lotaj |
| Shkodër | Shosh | Ndrejaj, Nikaj-Shosh, Palaj, Pepsumaj, Brashtë |
| Shkodër | Rrethinat | Dobraç, Grudë e Re, Shtoj i Ri, Guci e Re, Shtoj i Vjetër, Zues, Golem, Hot i Ri, Bleran, Bardhaj |
| Shkodër | Velipojë | Velipojë, Pulaj, Luarzë, Baks-Rrjoll, Gomsiqe, Baks i Ri, Reç i Ri, Ças, Mali Kolaj, Reç Pulaj |

Burimi: Bashkia Shkodër PBA 2023-2025.

## Demografia dhe Popullsia

Sipas Censusit të vitit 2023, bashkia ka një popullsi prej 102.434 banorësh, ku numri i femrave (52.209) është pak më i lartë se i meshkujve (50,225), që tregon për një shpërndarje gjinore relativisht të balancuar.

**Tabela 10.** Popullsia sipas grupmoshës dhe gjinisë (2023)

| Grupmosha | Numri total i popullsisë | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|
| Gjithsej | 102,434 | 50,225 | 52,209 |
| 0-4 | 5,017 | 2,644 | 2,373 |
| 5-9 | 5,466 | 2,839 | 2,627 |
| 10-14 | 5,642 | 2,909 | 2,733 |
| 15-19 | 6,120 | 3,051 | 3,069 |
| 20-24 | 5,985 | 2,920 | 3,065 |
| 25-29 | 6,121 | 3,083 | 3,038 |
| 30-34 | 6,179 | 3,254 | 2,925 |
| 35-39 | 5,752 | 2,973 | 2,779 |
| 40-44 | 5,288 | 2,528 | 2,760 |
| 45-49 | 5,832 | 2,677 | 3,155 |
| 50-54 | 7,250 | 3,222 | 4,028 |
| 55-59 | 7,793 | 3,743 | 4,050 |
| 60-64 | 8,772 | 4,158 | 4,614 |
| 65-69 | 7,540 | 3,712 | 3,828 |
| 70-74 | 5,451 | 2,673 | 2,778 |
| 75-79 | 3,897 | 1,876 | 2,021 |
| 80-84 | 2,755 | 1,281 | 1,474 |
| 85+ | 1,574 | 682 | 892 |

Burimi: INSTAT 2024.

Në grupmoshat 50-54 vjeç (7.250 persona), 55-59 vjeç (7.793 persona), dhe 60-64 vjeç (8.772 persona) përqindja e femrave është më e lartë se e meshkujve.
Në grupmoshën 0-19 vjeç përfshihen 21.245 individë, me një numër pak më të lartë femrash (10.804) se sa meshkujsh (10.441). Popullsia e në moshë pune (20-59 vjeç) përbën grupin më të madh, ku numri i meshkujve (25.503) dhe i femrave (26,339) është pak a shumë i balancuar, që tregon për ndarje të barabartë të tyre në forcat e punës. Grupmosha e të moshuarve (60+ vjeç) është e konsiderueshme, me 4.614 femra and 4.158 meshkuj në grupmoshën 60-64 vjeç.

**Tabela 11.** Demografia sipas NJA-ve, gjinisë dhe grupmoshës (2023))

| Njësia administrative | Gjithsej | Mosha 0-14 | Mosha 15-64 | Mosha 65+ | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ana e Malit | 2,652 | 354 | 1,706 | 592 | 1,327 | 1,325 |
| Bërdicë | 4,062 | 722 | 2,587 | 753 | 2,058 | 2,004 |
| Dajç | 2,494 | 322 | 1,497 | 675 | 1,236 | 1,258 |
| Guri i Zi | 6,315 | 1,196 | 4,013 | 1,106 | 3,127 | 3,188 |
| Postribë | 4,744 | 823 | 3,021 | 900 | 2,349 | 2,395 |
| Pult | 245 | 40 | 160 | 45 | 128 | 117 |
| Rrethinat | 15,968 | 2,856 | 10,251 | 2,861 | 7,897 | 8,071 |
| Shalë | 584 | 92 | 378 | 114 | 308 | 276 |
| Shkodër (City) | 61,633 | 9,141 | 39,205 | 13,287 | 29,944 | 31,689 |
| Shosh | 90 | 15 | 52 | 23 | 47 | 43 |
| Velipojë | 3,647 | 564 | 2,222 | 861 | 1,804 | 1,843 |

Burimi: INSTAT 2024.

Popullsia e Shkodrës është relativisht e balancuar midis meshkujve dhe femrave në të gjitha njësitë administrative, me pak më shumë femra (52.209) se sa meshkuj (50,225) në qytetin e Shkodrës. Grupmosha më e madhe në të gjitha njësitë është ajo e personave në grupmoshën e punës (15-64 vjeç), që përputhet me tendencat botërore në përgjithësi, dhe është tregues i një popullate relativisht të re dhe aktive.

Grupmosha «65+» është ndjeshëm më e vogël krahasuar me grupet në moshë më të re dhe ato të moshës së punës, me përjashtim të disa zonave të caktuara si Rrethinat dhe Shkodra, ku përqindja është më e lartë.

Qendrat urbane si Shkodra, Velipoja, dhe Guri i Zi kanë numër më të madh popullsie dhe pjesën më të madhe të popullatës të moshës së punës. Kurse në komunitetet rurale dhe ato më të vogla si Shala, Shoshi, dhe Pult popullsia totale është më e vogël dhe ato kanë dinamikë të ndryshme moshore, me numër më të madh personash të moshuar.

**Tabela 12.** Bërthamat familjare sipas njësive administrative (2023)

| Njësia administrative | Gjithsej bërthama familjare | Çifte të martuara/që bashkëjetojnë, pa fëmijë | Çifte të martuara/që bashkëjetojnë, me fëmijë | Prindër të vetëm |
|---|---|---|---|---|
| Gjithsej në nivel bashkie | 30.163 | 10.943 | 15.816 | 3.404 |
| Ana e Malit | 834 | 364 | 410 | 60 |
| Bërdicë | 1,241 | 504 | 650 | 87 |
| Dajç | 821 | 410 | 347 | 64 |
| Guri i Zi | 1,870 | 721 | 1,001 | 148 |
| Postribë | 1,443 | 629 | 700 | 114 |
| Pult | 64 | 20 | 37 | 7 |
| Rrethinat | 4,552 | 1,586 | 2,567 | 399 |
| Shalë | 162 | 56 | 84 | 22 |
| Shkodër (urban area) | 18,025 | 6,164 | 9,461 | 2,400 |
| Shosh | 27 | 13 | 12 | 2 |
| Velipojë | 1,124 | 476 | 547 | 101 |

Burimi: INSTAT 2024.

Bashkia Shkodër, e përbërë nga disa njësi administrative, ka gjithsej 30.163 bërthama familjare. Ndër to, qyteti i Shkodrës ka numrin më të madh, me 18.025 të tilla. Këtu përfshihen 6.164 çifte pa fëmijë, 9.461 çifte me fëmijë, dhe 2.400 familje me një prind.Një njësi tjetër e rëndësishme është Rrethinat, me 4.552 bërthama familjare, ku 2.567 janë çifte me fëmijë dhe 399 janë familje me një prind. Njësitë më të vogla administrative si Shala dhe Pulti kanë numër popullsie shumë më të ulët, me përkatësisht 162 dhe 64 bërthama familjare.
Të dhënat tregojnë për dallime të konsiderueshme në strukturat familjare në njësitë e ndryshme administrative.

## Konteksti social-ekonomik

Shkodra, një rajon me traditë të pasur bujqësore dhe industriale, paraqet një tablo social-ekonomike me mundësi dhe sfida. Bujqësia, përpunimi bujqësor dhe zejtaria janë sektorët kyç, ku gratë luajnë një rol të rëndësishëm në fermat familjare dhe bizneset e vogla. Ndonëse rajon me potencial të lakmueshëm dhe mundësi të mëdha për t'u bërë epiqendër zhvillimi në veriun e vendit sa i përket rritjes ekonomike në sajë të burimeve të saj natyrore dhe njerëzore – siç është diaspora mjaft e pasur dhe e mirëpozicionuar shkodrane – Shkodra përballet edhe me sfida dhe vështirësi të ndryshme.

## Shërbimet sociale

Bashkia Shkodër ka një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e nevojave social-ekonomike të banorëve të saj përmes një rrjeti të gjerë shërbimesh sociale. Në Shkodër ka 13 qendra sociale komunitare funksionale që ofrojnë shërbime për më shumë se 6.600 përfitues, me theks të veçantë tek mbështetja për familjet, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit. Nisma të specializuara, si diagnostikimi i hershëm i autizmit dhe shtëpitë familje për personat me aftësi të kufizuara, vë në pah vëmendjen që bashkia i kushton banorëve të cenueshëm, megjithatë shtrirja e shërbimeve mbetet e kufizuar.

**Tabela 13.** Shërbimet sociale në vitin 2023

| Treguesi | Vlera numerike |
|---|---|
| Numri i qendrave sociale komunitare | 13 |
| Numri I përfituesve të shërbimeve në qendrat komunitare "Për familjen" | 6600 |
| Numri i fëmijëve dhe familjeve që marrin shërbim në qendrën e specializuar për diagnostimin e fëmijëve me autizëm | 20 |
| Numri i shtëpive familje funksionale dhe në shërbim të PAK | 8 |
| Përfituesit nga qendrat rezidenciale (Opera Madonnina del Grappa + Project Hope) | 77 |
| Aktivitete ndërgjegjësimi për Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara | 7 |
| Trendi vjetor i përfituesve të shërbimeve ekzistuese (%) | 0 |
| Fëmijët në nevojë, pjesëmarrës në aktivitete kulturore artistike (Aktiviteti 1) | 30 |
| Fëmijët në nevojë, pjesëmarrës në aktivitete kulturore artistike (Aktiviteti 1) | 25 |
| Jetimët e mbështetur në kuadër të festave të fundvitit | 50 |
| Të moshuarit e trajtuar gjatë vitit në qendrat sociale | 50 |
| Viktimat e dhunës me bazë gjinore të mbështetura | 150 |

Burimi: PBA 2024-2026, Bashkia Shkodër.[33]

Në kuadër të nismës "Për familjen", shërbimet e specializuara përfshijnë mbështetjen për diagnostikimin e hershëm të autizmit për 20 fëmijë dhe familjet e tyre dhe shtëpi familje funksionale për persona me aftësi të kufizuara. Shërbimet rezidenciale kujdesen për 77 individë përmes projekteve si Opera Madonnina del Grappa dhe Project Hope. Aktivitetet e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes mbeten në fokus, me shtatë aktivitete të organizuara për Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe aktivitete kulturore me pjesëmarrjen përkatësisht të 30 dhe 25 fëmijëve në nevojë. Gjithashtu, 50 jetimë dhe 50 persona të moshuar marrin çdo vit ndihmë të dedikuar për to. Rëndësi ka gjithashtu vëmendja që u kushtohet viktimave të dhunës me bazë gjinore, me 150 persona të ndihmuar përmes ndërhyrjeve të dedikuara.

**Tabela 14.** Popullsia sipas njësive administrative, aftësisë së kufizuar dhe gjinisë

| Njësia administrative | Popullsia gjithsej | Me aftësi të kufizuara | Pa aftësi të kufizuara | Gjithsej meshkuj | Meshkuj me aftësi të kufizuara | Meshkuj pa aftësi të kufizuara | Gjithsej femra | Femra me aftësi të kufizuara | Femra pa aftësi të kufizuara |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjithsej Shkodër | 86.309 | 6.454 | 79.855 | 41.833 | 2.843 | 38.990 | 44.476 | 3.611 | 40.865 |
| Ana e Malit | 2,298 | 171 | 2,127 | 1,131 | 81 | 1,050 | 1,167 | 90 | 1,077 |
| Bërdicë | 3,340 | 272 | 3,068 | 1,685 | 132 | 1,553 | 1,655 | 140 | 1,515 |
| Dajç | 2,172 | 202 | 1,970 | 1,075 | 85 | 990 | 1,097 | 117 | 980 |

*(Vazhdon në faqen tjetër)*

33. https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/19.-Programi-10430-PBA-2024-2026-.pdf

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Guri i Zi | 5,119 | 514 | 4,605 | 2,485 | 200 | 2,285 | 2,634 | 314 | 2,320 |
| Postribë | 3,921 | 272 | 3,649 | 1,926 | 137 | 1,789 | 1,995 | 135 | 1,860 |
| Pult | 205 | 14 | 191 | 114 | 5 | 109 | 91 | 9 | 82 |
| Rrethinat | 13,112 | 889 | 12,223 | 6,411 | 400 | 6,011 | 6,701 | 489 | 6,212 |
| Shalë | 492 | 45 | 447 | 267 | 22 | 245 | 225 | 23 | 202 |
| Shkodër | 52,492 | 3,624 | 48,868 | 25,195 | 1,592 | 23,603 | 27,297 | 2,032 | 25,265 |
| Shosh | 75 | 3 | 72 | 40 | 1 | 39 | 35 | 2 | 33 |
| Velipojë | 3,083 | 448 | 2,635 | 1,504 | 188 | 1,316 | 1,579 | 260 | 1,319 |

Burimi: INSTAT 2024.

Në vitin 2023, 6.454 individë raportuan se kishin aftësi të kufizuara (afërsisht 7,5% e numrit të përgjithshëm të popullsisë). Pjesa më e madhe (79.855 ose 92,5%) nuk kanë aftësi të kufizuara.
Nga 41.833 meshkuj, 2.843 (6,8%) kanë aftësi të kufizuara dhe nga 44.476 femra, 3.611 (8,1%) kanë aftësi të kufizuara. Në të gjitha njësitë administrative, përqindja e femrave me aftësi të kufizuara është kudo pak më e lartë se ajo e meshkujve.

Qyteti i Shkodrës ka popullsinë më të madhe (52.492) dhe numrin më të madh të individëve me aftësi të kufizuara (3.624). Njësia e Velipojës ka numrin më të madh të personave me aftësi të kufizuara (448 ose 14,5% e banorëve të njësisë).
Njësi administrative si Rrethinat dhe Guri i Zi, kanë një numër të konsiderueshëm personash me aftësi të kufizuara (përkatësisht 889 dhe 514).

**Tabela 15.** Treguesit socialë

| Muaji | Ndihmë ekonomike (gjithsej) | Ndihmë ekonomike (qytet) | Familjet (fondi 6%) | Fondi 6% (në 000 lekë) | Skema e aftësisë së kufizuar (gjithsej) | Aftësi e kufizuar për punë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | 1673 | 268 | 191 | 530 | 4199 | 3373 |
| Shkurt | 1663 | 262 | 193 | 521 | 4296 | 3400 |
| Mars | 1639 | 251 | 185 | 516 | 4363 | 3401 |
| Prill | 1724 | 260 | 192 | 530 | 4385 | 3401 |
| Maj | 1841 | 276 | 207 | 578 | 4382 | 3401 |
| Qershor | 1924 | 283 | 207 | 587 | 4364 | 3412 |
| Korrik | 1853 | 278 | 199 | 564 | 4339 | 3347 |
| Gusht | 1826 | 157 | 196 | 555 | 4327 | 3376 |
| Shtator | 1813 | 268 | 207 | 590 | 4209 | 3364 |
| Tetor | 1775 | 263 | 205 | 554 | 4168 | 3357 |
| Nëntor | 1779 | 275 | 205 | 555 | 4145 | 3357 |
| Dhjetor | 1765 | 270 | 205 | 552 | 4125 | 3339 |

Burimi: Vlerësimi vullnetar lokal për Bashkinë Shkodër.[34]

34. https://unhabitat.org/sites/default/files/2021/12/shkodra_2021_sq.pdf

Numri i gjithsejtë i familjeve që marrin ndihmë ekonomike ka ndryshuar gjatë vitit, me numrin më të madh të regjistruar në qershor (1924 familje) dhe më të ulët në mars (1639 familje). Për qytetin e Shkodrës, tendenca pasqyron në përgjithësi shifrat totale, me një rënie të theksuar në gusht (157 familje), që me gjasë u shkaktua nga ndryshimet administrative ose rialokimi i burimeve. Numri i familjeve që përfituan nga fondi 6% varioi midis 185 familje (mars) dhe 207 familje (maj, qershor dhe shtator). Shuma e fondit pësoi pak ndryshim, me shifrën më të madhe në shtator (590,000 lekë) dhe mbi 550,000 lekë për pjesën më të madhe të muajve. Rastet e aftësisë së kufizuar në lidhje me punën kishin tendencë të ngjashme, duke rënë nga 3.373 përfitues në janar në 3.339 përfitues në dhjetor.

## Migracioni

Sa u takon shifrave të migracionit për Bashkinë Shkodër, ndonëse ato janë dukshëm të larta, është dokumentuar edhe një numër i konsiderueshëm personash të kthyer. Në veçanti, struktura e familjeve shqiptare me anëtarë të kthyer që kishin qenë jashtë shtetit për më shumë se 12 muaj tregon se në vitin 2019 u kthyen në Shkodër 4% e tyre, krahasuar me 7,5% në vitin 2011. Përveç kësaj, sipas një anketimi të kryer deri në 15 korrik 2019, numri i personave të kthyer në qytetin e Shkodrës ishte 4.304 individë, ose 20 individë për 1000 banorë.[35]

## Arsimi

Arritjet arsimore janë një tregues kyç i zhvillimit të përgjithshëm të një komuniteti, që ndikon në mundësitë individuale, rritjen ekonomike dhe trajtimin e barabartë shoqëror. Në rastin e Shkodrës, arritjet arsimore pasqyrojnë progres, por edhe sfida në vijimësi. Gjatë viteve, rajoni ka ecur shumë përpara sa i përket aksesit në arsim, por ka ende vështirësi, sidomos në zonat rurale ku faktorët social-ekonomikë, infrastruktura dhe normat kulturore ndikojnë në rezultatet arsimore.

**Tabela 16.** Kopshtet në Shkodër

| Lloji i institucionit | Publik | Privat | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| Arsim parashkollor (kopshte) dhe çerdhe | 59 | 7 | 66 |

Burimi: Bashkia Shkodër.

Të dhënat në Tabelën 16 tregojnë për shpërndarjen e institucioneve parashkollore në Shkodër, me theks mbi mbizotërimin e institucioneve publike në ofrimin e arsimit parashkollor. Nga gjithsej 66 kopshte dhe shkolla në bashki, 55 (afërsisht 83%) janë institucione publike dhe vetëm 7 (rreth 11%) janë private.

**Tabela 17.** Regjistrimi dhe personeli arsimor në kopshte

| Kategoria | Fëmijë |
|---|---|
| Numri gjithsej i fëmijëve në kopshte | 1.862 |
| Numri i vajzave në kopshte | 989 |
| Numri i personelit për fëmijët | 172 |

Burimi: Bashkia Shkodër.

35. Plani vendor i veprimit për migracionin dhe diasporën 2022-2025, Bashkia Shkodër.

Në bashkinë e Shkodrës janë 1.862 fëmijë të regjistruar në kopshte. Prej tyre, 989 janë vajza, që përfaqëson një shpërndarje pothuaj të balancuar gjinore në arsimin parashkollor. Me fëmijët në kopshte punojnë 172 anëtarë personeli.

**Tabela 18.** Shkollat në Shkodër

| Numri gjithsej i shkollave në Shkodër | 90 shkolla |
|---|---|
| Numri gjithsej i shkollave me konvikt | 2 shkolla me konvikt |
| Numri gjithsej i nxënësve që përfitojnë nga shërbimet arsimore | 17.200 nxënës |
| Nxënësit e shkollave në qytet | 11.227 nxënës |
| Nxënësit në njësitë administrative | 5.973 nxënës |

Burimi: PBAM 2022-2024.

Bashkia Shkodër ka 90 shkolla, ndër të cilat dy shkolla me konvikt, me gjithsej 17.200 nxënës. Prej tyre 11.227 janë nxënës në shkolla urbane dhe 5.973 shkojnë në shkolla në të gjitha njësitë administrative.

**Tabela 19.** Shkollat dhe nxënësit sipas njësive administrative

| Njësia administrative | Numri i shkollave | Nxënës gjithsej | Vajza |
|---|---|---|---|
| Rrethina | 9 | 1,749 | 838 |
| Gur i Zi | 7 | 1,012 | 530 |
| Postribë | 10 | 1,098 | 559 |
| Ana e Malit | 6 | 399 | 188 |
| Bërdicë | 5 | 632 | 294 |
| Velipojë | 6 | 562 | 273 |
| Dajç | 6 | 267 | 124 |
| Shalë | 5 | 136 | 63 |
| Shosh | 3 | 24 | 14 |
| Pult | 7 | 95 | 38 |

Burimi: Bashkia Shkodër.

Të dhënat në Tabelën 19 ndahen më tej për secilën njësi administrative. Përqendrimi më i madh i nxënësve është në NJA Rrethina (1.749 nxënës, nga të cilët 838 vajza), ndjekur nga Guri i Zi (1.012 nxënës, me 530 vajza). Numri më i vogël i nxënësve është në Shosh (24 nxënës, nga të cilët 14 vajza), dhe Pult (95 nxënës, nga të cilët 38 vajza). Bashkia ka 7 shkolla profesionale, ndër të cilat "Kolë Idromeno", "Arben Broci", "Shkolla Teknologjike" dhe "Kolë Margjini". Këto institucione ofrojnë arsim profesional që është me shumë rëndësi për forcat e punës në bashki. Krahas arsimit parauniversitar, Shkodra ka edhe Universitetin «Luigj Gurakuqi» që përbëhet nga fakultetet e mëposhtme:

| Fakulteti | Departamentet |
|---|---|
| Fakulteti i Shkencave Shoqërore | - Departamenti i Gjuhësisë |
| | - Departamenti i Letërsisë |
| | - Departamenti i Historisë |
| | - Departamenti i Gjeografisë |
| Fakulteti i Shkencave Natyrore | - Departamenti i Matematikës |
| | - Departamenti i Informatikës |
| | - Departamenti i Fizikës |
| | - Departamenti Biologji-Kimi |
| | - Departamenti i Infermierisë |
| Fakulteti i Shkencave të Edukimit | - Departamenti i Punës Sociale |
| | - Departamenti i Mësuesisë |
| | - Departamenti i Edukimit Fizik dhe i Sporteve |
| | - Departamenti i Arteve |
| Fakulteti Ekonomik | - Departamenti i Administrim Biznesit |
| | - Departamenti Financë Kontabilitet |
| | - Departamenti i Turizmit |
| Fakulteti i Drejtësisë | - Departamenti i së Drejtës Publike |
| | - Departamenti i së Drejtës Civile |
| | - Departamenti i së Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane |
| Fakulteti i Gjuhëve të Huaja | - Departamenti i Gjuhës Angleze |
| | - Departamenti i Gjermanistikës |
| | - Departamenti i Romanistikës |

Burimi: Bashkia Shkodër.

Në Bashkinë Shkodër numri i banorëve që dinë të lexojnë e të shkruajnë është shumë i lartë, me 89.535 persona (nga 91.951) që dinë të lexojnë e të shkruajnë, që do të thotë se niveli i përgjithshëm i aftësisë për lexim e shkrim është rreth 97,4%.

**Tabela 20.** Frekuentimi i shkollës dhe aftësitë e leximit dhe shkrimit

| Njësia administrative | Popullsia gjithsej (2023) | Aftësia e leximit dhe shkrimit | Analfabetë |
|---|---|---|---|
| *Gjithsej* | *91.951* | *89.535* | *2.416* |
| Ana e Malit | 2,429 | 2,365 | 64 |
| Bërdicë | 3,577 | 3,463 | 114 |
| Dajç | 2,277 | 2,230 | 47 |
| Guri i Zi | 5,540 | 5,448 | 92 |
| Postribë | 4,221 | 4,132 | 89 |
| Pult | 223 | 211 | 12 |
| Rrethinat | 14,169 | 13,565 | 604 |
| Shalë | 518 | 464 | 54 |
| Shkodër | 55,636 | 54,432 | 1,204 |
| Shosh | 79 | 76 | 3 |
| Velipojë | 3,282 | 3,149 | 133 |

Burimi: INSTAT 2024.

Nivelet më të ulëta në aftësitë për lexim e shkrim shihen në Shalë dhe Pult, ku një numër i vogël i popullsisë (përkatësisht 518 dhe 223 persona) janë analfabetë; megjithatë, në këto komunitete shkalla e aftësisë për lexim e shkrim është mbi 90%.Numri i analfabetëve në Bashkinë Shkodër është 2.416, që përfaqëson 2,6% të totalit të popullsisë. Në zona më të vogla, si Shoshi, Velipoja, dhe Shalë, analfabetizmi mbetet i ulët. Vetë Shkodra, si qendër urbane, ka numrin më të madh të personave që dinë të shkruajnë e të lexojnë (54.432) dhe 1.204 persona analfabetë.

## Shëndetësia

Në ofrimin e shërbimeve shëndetësore në Shkodër ka pasur si arritje, ashtu edhe sfida. Megjithëse rajoni ka një varg institucionesh shëndetësore, përfshirë qendra shëndetësore primare dhe shërbime të specializuara, disa barriera vazhdojnë të ekzistojnë, sidomos në zonat e thella, të cilat ndikojnë aksesueshmërinë, cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve shëndetësore të ofruara.

**Tabela 21.** Institucionet shëndetësore

| | |
|---|---|
| Qendra shëndetësore funksionale | 14 |
| Të ndërtuara rishtas | 3 |
| Spitali rajonal | 1 |
| Numri i personave të trajtuar në këto qendra | 173.029 |

Burimi: Bashkia Shkodër.

Në Shkodër funksionojnë 14 qendra shëndetësore, që ofrojnë shërbime shëndetësore të rëndësishme për gjithë rajonin. Nga këto, tri qendra janë ndërtuar të reja, që është tregues i përmirësimeve në infrastrukturën shëndetësore. Krahas kësaj, rajoni shërbehet edhe nga një spital rajonal, i cili ofron shërbime më të specializuara dhe të avancuara shëndetësore. Nga shërbimet e ofruara në këto institucione përfitojnë gjithsej 173.029, çka vë në pah rolin e sistemit shëndetësor në kujdesin për nevojat shëndetësore të popullatës. Përfshirja e spitalit rajonal flet për rëndësinë që i kushtohet si kujdesit parësor, ashtu edhe atij të avancuar në zonë.

## Aktiviteti ekonomik

Aktiviteti ekonomik në Shkodër pasqyron ndërveprimin dinamik midis sektorëve tradicionalë dhe mundësive të reja. Bujqësia, blegtoria, dhe përpunimi bujqësor përbëjnë boshtin e aktivitetit ekonomik rural, duke siguruar punësim dhe duke kontribuar në zinxhirin e vlerës ushqimore në zonë. Tokat pjellore dhe klima e favorshme e Shkodrës mundësojnë kultivimin e kulturave bujqësore të rëndësishme, si edhe prodhimin e qumështit, mishit, dhe mjaltit, që janë pjesë integrale e ekonomisë së saj.

Zonat urbane të Shkodrës kanë një mjedis mjaft aktiv biznesi, me një numër të konsiderueshëm ndërmarrjesh të vogla dhe të mesme që merren me tregti, shërbime dhe manifakturë.
Turizmi vazhdon të jetë një sektor që i jep hov rritjes ekonomike, në sajë të trashëgimisë kulturore, monumenteve historike, dhe bukurisë natyrore. Turizmi sezonal, sidomos përqark liqenit të Shkodrës, tërheq vizitorë dhe krijon mundësi në sektorët e mikpritjes, tregtisë dhe zbavitjes. Megjithatë, probleme si dallimet në punësim, një nivel i lartë inaktiviteti tek gratë, dhe diversifikimi i kufizuar industrial theksojnë nevojën për politika të synuara dhe qasje me ndjeshmëri gjinore për stimulimin e një rritjeje ekonomike përfshirëse dhe të qëndrueshme.

**Tabela 22.** Numri i ndërmarrjeve aktive sipas gjinisë, 2023

| Gjithsej | 5,148 |
|---|---|
| Burra | 3,630 |
| Gra | 1,518 |

Burimi: INSTAT 2024.

Në vitin 2023, Shkodra kishte 5.148 ndërmarrje aktive. Nga këto, 3.630 kishin pronarë ose drejtues burra, ndërsa 1.518 drejtoheshin nga gra. Ndonëse burrat ende përbëjnë shumicën e pronarëve dhe drejtuesve të ndërmarrjeve, gratë po marrin pjesë aktivisht në skenën sipërmarrëse, me rreth 29,5% të totalit.

**Tabela 23.** Ndërmarrjet sipas madhësisë, 2023

| Gjithsej | 5,148 |
|---|---|
| 1-4 të punësuar | 4,472 |
| 5-9 të punësuar | 334 |
| 10+ të punësuar | 342 |

Burimi: INSTAT 2024.

Në vitin 2023, Shkodra kishte 5.148 ndërmarrje aktive. Shumica e tyre (4.472) janë biznese të vogla me një deri në katër punëtorë, që pasqyron mbizotërimin e mikrondërmarrjeve në ekonominë vendore. Numri i ndërmarrjeve të mesme (5-9 punëtorë) është 334, ndërsa bizneset më të mëdha, që me dhjetë ose më shumë punëtorë, janë 342. Kjo shpërndarje sugjeron se ekonomia e Shkodrës bazohet më së shumti në bizneset e vogla; megjithatë ka prani të ndjeshme të ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha.

**Tabela 24.** Numri i ndërmarrjeve aktive sipas sektorit, 2023

| Gjithsej | 5,148 |
|---|---|
| I. Prodhues të të mirave | 628 |
| II. Prodhues të shërbimeve | 4,520 |

Burimi: INSTAT 2024.

Në vitin 2023, Shkodra kishte një total prej 5.148 ndërmarrjesh aktive. Nga këto, 628 merreshin me prodhimin e të mirave, ndërsa një numër mjaft më i madh 4.520, merreshin me ofrimin e shërbimeve. Kjo shpërndarje vë në pah mbizotërimin e sektorit të shërbimeve në ekonominë e zonës.

## Tregu i punës, punësimi dhe papunësia në Shkodër

Shifrat e forcave të punës në zonën e Shkodrës për vitin 2023 tregojnë se shkalla e përgjithshme e pjesëmarrjes në forcat e punës është 63,8%, me një dallim të ndjeshëm midis burrave (72%) dhe grave (56%).

**Tabela 25.** Treguesit e tregut të punës, zona e Shkodrës, 2023

| Treguesi | Gjithsej | Burra | Gra |
|---|---|---|---|
| Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës | 63.8% | 72.0% | 56.0% |
| Shkalla e punësimit | 59.4% | 67.5% | 51.7% |
| Shkalla e inaktivitetit | 36.2% | 28.0% | 44.0% |
| Shkalla e papunësisë | 6.9% | 6.2% | 7.8% |

Burimi: INSTAT 2024.

Në vitin 2023, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës në Shkodër ishte 63,8%; ku shkalla e pjesëmarrjes së burrave (72,0%) është më e lartë krahasuar me atë të grave (56,0%). Kjo sugjeron që burrat kanë më tepër gjasë të përfshihen në tregun e punës krahasuar me gratë. Shkalla e përgjithshme e punësimit ishte 59,4%, ku burrat (67,5%) kanë shkallë më të lartë punësimi se sa gratë (51,7%). Shkalla e inaktivitetit ishte mjaft më e lartë tek gratë (44,0%) krahasuar me burrat (28,0%), që pasqyron një hendek gjinor nga mospërfshirja e grave në forcat e punës.

## Punësimi

Në vitin 2022, Bashkia Shkodër kishte gjithsej 30.296 persona të punësuar. Të dhënat tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e forcave të punës në Shkodër janë të punësuar në sektorin privat, që sugjeron ekzistencën e një ekonomie vendore me biznese që kontribuojnë mjaft në krijimin e vendeve të punës.

**Tabela 26.** Punësimi në sektorin publik kundrejt sektorit privat

| Sektori | Gjithsej të punësuar | E shprehur në përqindje |
|---|---|---|
| Publik | 6.627 | 28% |
| Privat | 23.669 | 72% |

Burimi: PBAM 2024-2026.

Përqendrimi më i madh i punësimit është në qytetin e Shkodrës. Njësia administrative Rrethinat vjen e dyta për sa i përket numrit të individëve të punësuar. 6.627 persona, ose 28% e totalit të personave të punësuar në Shkodër punojnë në sektorin publik, ndërsa pjesa tjetër, gjithsej 23.669 persona, ose 72% e personave të punësuar, punojnë në sektorin privat.

## Infrastruktura: toka, ujërat, energjia elektrike dhe jeta sociale, Prodhimi i energjisë elektrike në Shkodër

Shkodra ka një pozicion strategjik, në afërsi të tre hidrocentraleve të mëdha: Ashta, Vau i Dejës, dhe Komani. Këto hidrocentrale kanë rol vital në prodhimin e energjisë elektrike në Shqipëri, me kontribut të konsiderueshëm në rrjetin elektrik kombëtar.

Hidrocentrali i Vaut të Dejës, në funksionim që prej vitit 1971, përfshin digat e Zadejës dhe Qyrsaqit, ndërtuar mbi kaskadën e lumit Drin. Këto diga krijojnë rezervuarin e Vaut të Dejës, me kapacitet 580 milion $m^3$ ujë. Ky hidrocentral ka gjeneruar energji elektrike për dekada të tëra.

Hidrocentrali i Ashtës, që gjendet 10 kilometra larg qytetit të Shkodrës, përfaqëson një infrastrukturë moderne për prodhimin e energjisë. Ai ndahet në dy pjesë: Ashta I, që përdor turbina *Hydro Matrix* për gjenerimin e energjisë, dhe Ashta II, që përdor ujin e transportuar përmes një kanali 5 kilometra të gjatë. Së bashku, Ashta I and II kanë një kapacitet total prej 53 MW, dhe prodhojnë afërsisht 240 milion kWh energji elektrike në vit.

Hidrocentrali i Komanit filloi funksionimin në mesin e viteve '80, me turbinat e para që u vunë në shfrytëzim në vitin 1985. Diga e tij, e ndërtuar me gurë dhe betonarme, krijon një liqen artificial me sipërfaqe 12 km2 dhe me kapacitet 450 milion m3 ujë. Komani është një prej hidrocentraleve më të rëndësishëm në vend.

Në përgjithësi, Bashkia Shkodër shërben si një zonë kyçe për prodhimin e energjisë së rinovueshme në Shqipëri, me hidrocentralet që plotësojnë nevojat për energji dhe menaxhimin e ujit.

**Tabela 27.** Të dhëna kyçe të hidrocentraleve në Shkodër

| Hidrocentrali | Të dhëna | Kapaciteti | Prodhimi vjetor | Kapaciteti i rezervuarit |
|---|---|---|---|---|
| Vau i Dejës | Funksionon që prej vitit 1971, përfshin digat e Zadejës dhe Qyrsaqit. | I paspecifikuar | I paspecifikuar | 580 milion m3 |
| Ashta (I dhe II) | Turbina moderne Hydro Matrix, ndarë në dy pjesë, me një kanal 5 km të gjatë. | 53 MW | 240 milion kWh | I paspecifikuar |
| Koman | Digë guri me betonarme; liqen artificial me sipërfaqe 12 $km^2$ ndërtuar në 1985-1986. | I paspecifikuar | I paspecifikuar | 450 milion m3 |

Burimi: Strategjia e zhvillimit territorial, Bashkia Shkodër

Shkodra është zonë me rëndësi kritike për sektorin e energjisë së rinovueshme në Shqipëri. Tre hidrocentrale kontribuojnë konsiderueshëm në prodhimin e energjisë, me përdorim të teknologjisë moderne, si turbinat Hydro Matrix në Ashtë që tregojnë për përparimin e bërë në drejtim të eficiencës energjetike. Krahas kësaj, kapacitetet e mëdha të rezervuarëve mundësojnë ruajtjen dhe menaxhimin e ujit, duke theksuar rëndësinë strategjike të zonës në qëndrueshmërinë energjetike dhe mjedisore.

## Ujitja dhe kullimi

Ujitja dhe kullimi janë ndër faktorët kryesorë të rritjes së qëndrueshme të prodhimit bujqësor në vend, por për shkak të mungesës së vazhdueshme të investimeve, ky sektor ka mbetur akoma në gjendje kritike.
Në sistemin e kullimit dhe ujitjes në zonën e Bashkisë Shkodër, janë gjithsej 729 km kanale dytësore dhe tretësore kulluese, si dhe 213 km[36] kanale ujitëse. Si rezultat i mungesës së investimeve në sistemin e kullimit dhe ujitjes, situata në kanalet ujitëse dytësore dhe tretësore dhe kanalet kulluese dytësore dhe tretësore është tejet e rënduar dhe ata janë pothuajse jashtë funksionit. Kanalet kulluese tretësore nuk janë pastruar pothuaj kurrë dhe janë shtuar aluvionet nga toka, barërat e këqija e lëndë të tjera inerte. Ka mangësi të theksuara në mirëmbajtjen dhe pastrimin e tyre, si dhe në element të infrastrukturës si tombino, ura, sifona etj., që kanë çuar në mosfunksionimin e tyre. Kjo ka bërë që sipërfaqe të tëra bujqësore të mos kultivohen ose të japin prodhim minimal.

## Përbërja e tokës në Bashkinë Shkodër

Bashkia Shkodër ka një sipërfaqe totale prej afërsisht 873 km3, që e bën një prej bashkive më të mëdha në Shqipëri. Toka bujqësore zë një pjesë të konsiderueshme, me rreth 40% e sipërfaqes së përgjithshme që përdoret për bujqësi.[37] Fushat pjellore përqark liqenit të Shkodrës janë të njohura për prodhimin e drithërave, perimeve dhe kulturave foragjere, që mbështesin si konsumin brenda zonës, ashtu edhe sipërmarrjet bujqësore komerciale. Zonat e pyllëzuara përbëjnë rreth 35% të sipërfaqes, duke ofruar balancë ekologjike, biodiversitet dhe burime për praktikat tradicionale si mbledhja e druve të zjarrit dhe kullotat. Përdorimet e tokave urbane dhe gjysmë-urbane janë shtuar vitet e fundit, gjë që reflekton rritjen e popullsisë dhe rritjen ekonomike, ku zonat rezidenciale, parqet industriale dhe hapësirat për zbavitje po bëhen tipare të spikatura të bashkisë.
Ndonëse përbërja e tokës së bashkisë vë në pah potencialin e saj bujqësor dhe bukurinë natyrore, po ushtrohet gjithnjë e më shumë trysni për balancimin e zhvillimit me qëndrueshmërinë. Kërkesat në rritje për strehim dhe infrastrukturë, sidomos në qendrat urbane si qyteti i Shkodrës, bëjnë të nevojshëm planifikimin e kujdesshëm të përdorimit të tokës për të ruajtur integritetin ekologjik të zonës ndërkohë që nxitet zhvillimi i saj ekonomik.

## Infrastruktura rrugore në Bashkinë Shkodër

Bashkia Shkodër ka një rrjet rrugor me mbi 1200 kilometra[38] që lidh qendrat urbane, zonat rurale dhe kufijtë ndërkombëtarë. Bashkia përshkohet nga rrugë kombëtare të rëndësishme, si autostrada SH1 që lidh Shkodrën me Tiranën dhe deri në kufi me Malin e Zi, e cila mundëson tregtinë e brendshme dhe atë ndërkufitare. Përveç kësaj, rrugët dytësore ofrojnë lidhje të rëndësishme me komunitetet rurale, duke siguruar akses në tregje, shërbime shëndetësore dhe arsim. Megjithatë, shumë nga rrugët, sidomos në zonat e thella, janë të pashtruara, që kufizon mundësitë ekonomike dhe aksesueshmërinë.Me gjithë pozicionin e saj strategjik dhe si nyjë lidhëse, infrastruktura rrugore e Shkodrës ka nevojë për investime të konsiderueshme. Sipas një raporti të Ministrisë së Infrastrukturës (2023), 25% e rrugëve në bashki kanë nevojë për përmirësime të mëdha për të përmbushur standardet e sigurisë dhe funksionalitetit. Përpjekjet për përmirësimin e cilësisë së rrugëve dhe për të zgjeruar rrjetin mund të rrisin në mënyrë dramatike aktivitetin ekonomik, sidomos në bujqësi dhe turizëm.

## Turizmi, trashëgimia kulturore dhe historike

Bashkia Shkodër po punon për krijimin e një numri itineraresh tematike, përmirësimin e infrastrukturës së turizmit dhe promovimin e llojeve të ndryshme të turizmit, përfshirë atë malor, ekoturizmin, dhe turizmin bregdetar. Tabela 28 paraqet një përmbledhje të nismave:

36. Programi i buxhetit afatmesëm, 2024-2026.
37. INSTAT 2023.
38. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Shqipërisë, 2023.

**Tabela 28.** Pasqyrë e përgjithshme e nismave

| Kategoria | Përshkrimi | Zonat në fokus |
|---|---|---|
| Itinerare tematike | - Itinerare bregdetare<br>- Itinerare në natyrë (male, liqene, etj.)<br>- Itinerare historike dhe kulturore (kala, zona historike)<br>- Vizita në muze | Zonat bregdetare, malet (Postribë, Pult, Shosh, Shalë, Ana e Malit, Tarabosh), vende historike (Kalaja e Rozafës, Kalaja e Drishtit, etj.), muzetë e Shkodrës |
| Turizmi malor dhe ekoturizmi | - Zhvillimi i infrastrukturës së ekoturizmit<br>- Trajnimi për menaxhim të bujtinave të zonës<br>- Krijimi i manualeve dhe guidave për turistët | Postribë, Pult, Shosh, Shalë |
| Turizmi detar dhe bregdetar | - Zhvillimi i plazheve të Velipojës dhe Rrjollit<br>- Velipojë: Përmirësim i infrastrukturës dhe shërbimeve për turizëm familjar<br>- Rrjoll: Ruajtja si plazh "i virgjër" elitar | Velipojë, Rrjoll |
| Trajnimi i guidave turistike | Përgatitja dhe licencimi i të rinjve dhe të rejave të zonës si guida turistike | Të gjitha njësitë administrative |
| Menaxhimi i plazheve publike | Respektim i kushteve ligjore për sigurimin që të paktën 30% e zonave të plazheve të mbeten publike | Velipojë, Rrjoll |

Burimi: Strategjia e zhvillimit territorial, Bashkia Shkodër.

Shkodra është një bashki e pasur në histori, kulturë dhe monumente, që e bëjnë atë një zonë të rëndësishme si për trashëgiminë kulturore, ashtu edhe për turizmin. Tabela 29 më poshtë përmban disa prej monumenteve dhe vendeve kryesore me interes kulturor në territorin e bashkisë. Ato kanë rol të rëndësishëm në identitetin vendor, duke ruajtur historinë dhe traditat e zonës dhe duke tërhequr vizitorë për eksplorimin e pasurisë kulturore të Shkodrës.

**Tabela 29.** Monumente dhe vende me interes kulturor

| Emri | Kategoria | Fshati | Njësia administrative |
|---|---|---|---|
| Kalaja e Shkodrës | Turizëm kulturor | Shkodër | Shkodër |
| Kalaja e Drishtit | Turizëm kulturor | Drisht | Postribë |
| Kalaja e Gajtanit dhe rrënojat e quajtura qytet mbi kurrizin e malit në perëndim të Kalasë së Gajtanit | Turizëm kulturor | Gajtan | Guri i Zi |
| Kalaja | Turizëm kulturor | Beltojë | Bërdicë |
| Vendbanimi Prehistorik i Sistemit Tarracor | Turizëm kulturor | Theth | Shalë |
| Qyteza e Dakajve | Turizëm kulturor | Breg-Lumë | Shalë |
| Qyteza e Ganjollës | Turizëm kulturor | Ganjollë | Guri i Zi |
| Rrënojat e fortifikimit prehistorik në kodrën e Kratulit | Turizëm kulturor | Boks | Postribë |
| Banesa antike me mozaik në bregun e djathtë të lumit Drin afër Urës së Bahçallëkut | Turizëm kulturor | Shkodër | Shkodër |
| Ura e Mesit në lumin Kir | Turizëm kulturor | Mes | Postribë |

*(Vazhdon në faqen tjetër)*

| Emri | Kategoria | Fshati | Njësia administrative |
|---|---|---|---|
| Hamami | Turizëm kulturor | Shkodër | Shkodër |
| Kisha trikonkëshe në Kalanë e Drishtit | Turizëm kulturor | Drisht | Postribë |
| Rrënojat e Kishës së Shatit | Turizëm kulturor | Mazrek | Guri i Zi |
| Rrënojat e Kishës së Shirgjit | Turizëm kulturor | Shirgj | Dajç |
| Xhamia e Plumbit | Turizëm kulturor | Shkodër | Shkodër |
| Ura e Hoxhës në lumin Gomsiqe | Turizëm kulturor | Shkodër | Shkodër |
| Zona e mbrojtur e vendbanimit prehistorik i sistemit tarracor | Turizëm kulturor | Grunas | Shalë |
| Zona e mbrojtur e kompleksit "Ndre" | Turizëm kulturor | Boks | Postribë |
| Zona e mbrojtur e fortifikimit të Kratulit | Turizëm kulturor | Boks | Postribë |
| Zona e mbrojtur e Xhamisë së Plumbit | Turizëm kulturor | Shkodër | Shkodër |

Source: Territorial Development Strategy, Shkodër Municipality.

Monumentet e përfshira në tabelë janë kategorizuar në bazë të rëndësisë së tyre, si monumente historike, monumente fetare, dhe zona të mbrojtura, që ofrojnë informacion për trashëgiminë e pasur kulturore të zonës.

## Bujqësia dhe blegtoria

Bashkia e Shkodrës është qendër shumë e rëndësishme e veprimtarisë bujqësore dhe blegtorale në Shqipëri, çka pasqyron burimet e pasura natyrore dhe traditën shumëvjeçare bujqësore. E pozicionuar në pjesën veriore të vendit, Shkodra është e pasur me toka pjellore, klimë të favorshme dhe një komunitet rural shumë aktiv që mban gjallë sektorin e bujqësisë në zonë.

**Tabela 30.** Numri i fermerëve në vitet 2021 deri 2023

| Viti | Numri i fermerëve |
|---|---|
| 2021 | 1,833 |
| 2022 | 2,187 |
| 2023 | 2,465 |

Burimi: INSTAT 2024.

Të dhënat dëshmojnë për një rritje të qëndrueshme të numrit të fermerëve në Shkodër gjatë periudhës përkatëse trevjeçare. Kjo rritje tregon për angazhimin e më shumë individëve në bujqësi, me gjasë për shkak të zgjerimit të mundësive në bujqësi ose përmirësimit të mbështetjes për sektorin bujqësor.

## Blegtoria

Blegtoria, në veçanti, luan rol qendror në ekonominë e zonës, me kategori të ndryshme si gjedhët, ripërtypësit e vegjël, shpendët dhe bletarinë, që kontribuojnë në prodhimin ushqimor, gjenerimin e të ardhurave dhe fitimin e jetesës në zonat rurale. Diversiteti bujqësor i bashkisë përfshin edhe kultivimin e kulturave bujqësore dhe mbarështimin e bagëtive, që krijon një ekosistem bujqësor dinamik dhe të ndërvarur.

**Tabela 31.** Shifrat e bagëtive 2023

| Kategoria blegtorale | Numri i krerëve |
|---|---|
| Gjedhë | 16.516 |
| Lopë | 13.871 |
| Dele | 19.680 |
| Dhi | 11.865 |
| Derra | 5.588 |
| Dosa | 768 |
| Kafshë barre (kuaj, etj.) | 1.756 |
| Shpendë | 271.424 |
| Pula | 265.995 |
| Gjela deti | 1.150 |
| Koshere bletësh | 22.045 |

Burimi: INSTAT 2024.

Bashkia Shkodër ka një prani të shumëllojshme dhe të qëndrueshme të rritjes së gjedhëve dhe shpendëve. Me një total prej 16.516 krerë gjedhë, nga të cilat 13.871 lopë, ky sektor kontribuon konsiderueshëm në prodhimin e qumështit dhe të mishit. Po kështu, në zonë ka 271.424 shpendë, kryesisht pula (265.995), dhe gjela deti (1.150). Bletaria, me 22.045 koshere, është gjithashtu sektor i rëndësishëm për prodhimin e mjaltit dhe mbështetjen e biodiversitetit.

**Tabela 32.** Prodhime blegtorale, 2023

| Produkti | Sasia (ton ose copë) |
|---|---|
| Qumësht (Gjithsej) | 37.251,0 |
| - Qumësht lope | 33.386,0 |
| - Qumësht deleje | 1.905,0 |
| - Qumësht dhie | 1.960,0 |
| Mish (Gjithsej) | 4.048,0 |
| - Mish lope | 2.270,0 |
| - Mish deleje | 612,0 |
| - Mish dhie | 295,0 |
| - Mish derri | 464,0 |
| - Shpendë | 407,0 |
| Vezë | 39.101.000 kokrra |
| Lesh | 47,2 |
| Mjaltë | 247,0 |

Burimi: INSTAT 2024.

Të dhënat pasqyrojnë sektorin e blegtorisë në Bashkinë Shkodër, që karakterizohet nga produkte të ndryshme si bulmet, mish, vezë, lesh dhe mjaltë. Kjo shumëllojshmëri mbështet jo vetëm fitimin e jetesës në zonë, por edhe i jep Shkodrës një vend të rëndësishëm në ekonominë bujqësore dhe blegtorale të Shqipërisë.
Bashkia Shkodër është prodhues i rëndësishëm i qumështit, me një sasi totale prej 37.251 ton në vitin 2023. Pjesa më e madhe është qumësht lope (33.386 ton). Sasia e qumështit të deles dhe të dhisë është përkatësisht 1.905 ton dhe 1.960 ton. Blegtoria në Shkodër prodhoi gjithsej 4048 ton mish në vitin 2023. Mishi i lopës përbënte pjesën më të madhe, me 2,270 ton, ndjekur nga mishi i deles (612 ton) dhe mishi i dhisë (295 ton), mishi i derrit (464 ton) dhe mishi i shpendëve (407 ton). Nga shpendët u morën 39,1 milion vezë në vitin 2023. Në vitin 2023, u prodhuan 47,2 ton lesh, ndërsa prodhimi i mjaltit arriti në 247 ton.

## Bimët e arave

Bashkia Shkodër demonstron fokus në kultivimin e drithërave, me një sipërfaqe totale të kultivuar prej 2.671 hektarë që prodhuan 18.292 ton drithë në vitin 2023. Rendimenti i prodhimit të misrit ishte 77 ton/ha dhe i grurit me 34,7 ton/ha.

**Tabela 33.** Bimët e arave, 2023

| Kategoria | Kultura | Sipërfaqe e kultivuar (në ha) | Prodhimi (në ton) |
|---|---|---|---|
| Drithërat | Gjithsej | 2.671 | 18.292 |
| | Grurë | 538 | 1.868 |
| | Misër | 2.133 | 16.424 |
| Perimet | Gjithsej | 1.233 | 28.327 |
| | Patate | 221 | 5.120 |
| | Qepë | 201 | 3927 |
| | Fasule | 198 | 270 |
| Bimë industriale | Duhan | 130 | 220 |
| Bimë foragjere | Gjithsej | 7.365 | 276.649 |

Burimi: INSTAT 2024.

## Kultivimi i perimeve

Kultivimi i perimeve është një tjetër aspekt vital i sektorit bujqësor të Shkodrës, me 1.233 hektarë ku prodhohen 28.327 ton perime. Rendimenti i prodhimit të patates është 231,7 ton/ha; qepët me pothuaj 200 ton/ha; fasulet me 13,6 ton/ha; duhani është bima industriale kryesore e zonës, me 130 hektarë dhe 220 ton, me rendiment 16,9 ton/ha.

Bimët foragjere zënë një sipërfaqe të konsiderueshme prej 7.365 hektarë, me prodhim 276.649 ton. Nuk ka informacion për thekrën, elbin, tërshërën, lulen e diellit, sojën, bimët mjekësore, panxharin e sheqerit dhe luleshtrydhet.

**Tabela 34.** Prodhimi i perimeve të freskëta, 2023

| Kategoria | Sipërfaqe e kultivuar (në ha) | Sipërfaqe serra (në ha) | Prodhim gjithsej (në ton) | Prodhimi në serra (në ton) | Rendiment (ton/ha) |
|---|---|---|---|---|---|
| Gjithsej perime të freskëta | 667.0 | 35.0 | 16,303 | 2,409 | .. |
| Domate | 156.0 | 18.0 | 5,460 | 1,482 | 350.0 |
| Tranguj | 90.0 | 10.0 | 2,696 | 616 | 299.6 |
| Speca | 113.0 | 3.0 | 2,980 | 180 | 263.7 |

Burimi: INSTAT 2024.

Sipërfaqja totale e kultivuar me perime të freskëta në Bashkinë e Shkodrës është 667 hektarë, nga të cilat 35 hektarë janë serra. Ky kombinim i kultivimit në fushë të hapur dhe në serra mundëson diversifikimin dhe shumëllojshmërinë e prodhimit, me 16.303 ton perime të freskëta në vitin 2023.

Sipërfaqja e mbjellë me domate është 156 hektarë, nga të cilat 18 hektarë janë serra. Gjithsej u prodhuan 5.460 ton domate, nga të cilat 1482 ton në serra, me rendiment 350 ton/ha.
Kultivimi i trangullit bëhet në 90 hektarë (10 hektarë në serra), me prodhim total 2.696 ton, nga të cilët 616 ton kultivohen në mjedise të kontrolluara. Rendimenti ishte 299,6 ton/ha.
Specat kultivohen në 113 hektarë, ndër të cilët 3 hektarë janë serra, me një prodhim total prej 2.980 ton. Prodhimi i serrave ishte 180 ton.

**Tabela 35.** Prodhimi i pjeprit dhe shalqirit, 2023

| Kategoria | Sipërfaqe e kultivuar (në ha) | Sipërfaqe serra (në ha) | Prodhim gjithsej (në ton) | Prodhimi në serra (në ton) | Rendimenti (ton/ha) |
|---|---|---|---|---|---|
| Gjithsej pjepra dhe shalqi | 269.0 | 21.0 | 6,186 | 945 | .. |
| Pjepra | 153.0 | 21.0 | 4,109 | 945 | 268.6 |
| Shalqi | 116.0 | .. | 2,077 | .. | 179.1 |

Burimi: INSTAT 2024.

Bashkia Shkodër ka gjithsej 269 hektarë të kultivuar me pjepra dhe shalqi, nga të cilat në 21 hektarë përdoren metodat e serrës. Në vitin 2023 prodhimi total arriti në 6.186 ton, nga të cilët 945 ton u prodhuan në serra. Shalqiri u kultivua në 15.3 hektarë.

21 hektarët e serrave u përdorën për kultivimin e shalqirit, me 945 ton në mjedise të kontrolluara. Prodhimi total ishte 4.109 ton, me rendiment 268,6 ton/ha. Kultivimi i pjeprit bëhet në 116 hektarë, me prodhim total 2.077 ton dhe rendiment 179,1 ton/ha.

## Pemët frutore dhe prodhimi i frutave

Në Bashkinë e Shkodrës pemët frutore kultivohen në sipërfaqe totale prej 327 hektarësh, nga të cilat aktualisht 263 hektarë janë në prodhim. Në vitin 2023, këto prodhuan 4.910 ton fruta të ndryshme.

**Tabela 36.** Pemët frutore dhe prodhimi i frutave, 2023

| Kategoria | Gjithsej sipërfaqe e kultivuar (në ha) | Sipërfaqe në prodhim (në ha) | Prodhim gjithsej (në ton) |
|---|---|---|---|
| Gjithsej pemë frutore | 327 | 263 | 4.910 |
| Mollë | 6 | 5 | 140 |
| Kumbulla | 43 | 36 | 477 |
| Qershi | 48 | 39 | 269 |
| Fiq | 55 | 54 | 1.706 |
| Nektarina/pjeshkë | 80 | 77 | 719 |
| Gështenja | 10 | 10 | 182 |
| Arra | 50 | 3 | 140 |

Burimi: INSTAT 2024.

Prodhimi i fikut numëron 1706 ton nga 54 hektarë; nektarinat/pjeshkat: 719 ton nga 77 hektarë; kumbullat 477 ton nga 36 hektarë. Gështenjat kultivohen në 10 hektarë, nga të cilat të gjitha janë produktive, me prodhim 182 ton. Mollët dhe arrat: mollët 140 ton nga 5 hektarë, dhe arrat me të njëjtën sasi prodhimi, por me vetëm 3 hektarë në prodhim aktiv.

**Tabela 37.** Kultivimi dhe prodhimi i agrumeve, 2023

| Kategoria | Gjithsej sipërfaqe e kultivuar (në ha) | Sipërfaqe në prodhim (në ha) | Prodhim gjithsej (në ton) |
|---|---|---|---|
| Gjithsej agrume | 21 | 15 | 524 |
| Mandarina | 19 | 14 | 355 |
| Portokalle | 2 | 1 | 131 |
| Limonë | - | - | 38 |

Burimi: INSTAT 2024.

Në vitin 2023, në Bashkinë e Shkodrës agrumet kultivoheshin në 21 hektarë, me 15 hektarë në prodhim aktiv. Prodhimi i përgjithshëm vjetor i agrumeve ishte 524 ton. Mandarinat zinin 19 hektarë, 14 nga të cilët në prodhim aktiv me 355 ton prodhim, ose pothuaj 68% të prodhimit të përgjithshëm të agrumeve. Portokajtë zinin vetëm 2 hektarë, me 1 hektar në prodhim aktiv dhe prodhim total 131 ton.

**Tabela 38.** Kultivimi dhe prodhimi i ullirit, 2023

| Kategoria | Gjithsej sipërfaqe e kultivuar (në ha) | Sipërfaqe në prodhim (në ha) | Prodhim gjithsej (në ton) |
|---|---|---|---|
| Ullinj | 662 | 558 | 710 |

Burimi: INSTAT 2024.

Në vitin 2023, kishte 662 hektarë për kultivimin e ullirit. Nga sipërfaqja totale e kultivuar u mor prodhim nga 558 hektarë (84% e sipërfaqes) me një prodhim total vjetor prej 710. Ndonëse pjesa më e madhe e sipërfaqes së kultivuar është prodhuese, 104 hektarë mbeten joprodhuese.

**Tabela 39.** Kultivimi dhe prodhimi i vreshtave, 2023

| Kategoria | Gjithsej sipërfaqe e kultivuar (në ha) | Sipërfaqe në prodhim (në ha) | Prodhim gjithsej (në ton) |
|---|---|---|---|
| Vreshta | 187 | 180 | 950 |

Source: INSTAT 2024.

Në vitin 2023, Bashkia Shkodër kishte 187 hektarë për kultivimin e vreshtave, me pjesën më të madhe të tyre në prodhim aktiv. Nga e gjithë, sipërfaqja e kultivuar, rrush u prodhua nga 180 hektarë (96%), me një prodhim total prej 950 ton në vitin 2023. Të dhënat flasin për aktivitet të shumëllojshëm bujqësor në Bashkinë Shkodër dhe theksojnë rëndësinë e saj në prodhimin e drithërave, perimeve dhe bimëve foragjere.

Kultura me rendiment të lartë, si misri dhe patatja tregojnë për efikasitetin dhe produktivitetin e praktikave bujqësore të zonës, ndërsa kultivimi i gjerë i bimëve foragjere thekson natyrën simbiotike midis bujqësisë dhe blegtorisë në zonë. Kjo qasje e integruar e pozicionon Shkodrën si një kontribuese shumë të rëndësishme në prodhimin e përgjithshëm bujqësor në Shqipëri dhe ofron mundësi për zgjerim dhe novacion të mëtejshëm në këtë sektor.

Duke pasur parasysh potencialin e jashtëzakonshëm të Shkodrës për prodhime bujqësore dhe përpunim ushqimor, si dhe kontekstin social-ekonomik të saj, sektorët në vijim mund të jenë veçanërisht premtues sepse kanë potencialin më të madh për përmirësimin e jetesës së grave, promovimin e barazisë gjinore dhe zhvillimin e zinxhirit të vlerave:

**Bujqësia:** Shkodra kultivon një gamë të shumëllojshme frutash dhe perimesh, si patate, qepë, domate dhe pemë frutore si ullinj, rrush, fiq, pjeshka, kumbulla dhe qershi - fiqtë me prodhim total 1.706 ton nga 54 ha, nektarina/pjeshka me 719 ton nga 77 ha; kumbulla me 477 ton nga 36 ha; agrume me 524 nga 15 ha; dhe ullinj me710 ton nga 558 ha; gështenjat me 182 ton nga 10 ha; vreshtat me 950 ton nga 180 ha. Një prodhim tjetër interesant është duhani me 220 ton nga 130 ha.

**Blegtoria:** 13.871 lopë; 19.680 dele dhe 11.865 dhi, me prodhim total qumështi 37.251 ton (90% nga lopët dhe 10% nga delet dhe dhitë, së bashku) që furnizojnë 22 baxho në territorin e bashkisë.

**Bletaria** ka vlerë të konsiderueshme, me 22.000 koshere dhe 247 ton mjaltë në vitin 2023.

**Turizmi dhe tradita:** Shkodra shquhet për traditë kulturore të pasur, monumente historike, bukuri natyrore dhe artizanat tradicional. Promovimi i grave si sipërmarrëse në turizmin kulturor, si guida, artizane, dhe mikpritje mund të rrisë të ardhurat lokale dhe të forcojë barazinë gjinore.

Ekoturizmi, me fokus bukuritë natyrore të zonës (si Liqeni i Shkodrës), mund të jetë një platformë për biznese të vogla të drejtuara nga gratë, si shërbime guidash ekoturistike lokale, ose hoteleri dhe kulinari. Shkodra ka një traditë të pasur në punime artizanale, si endja e pëlhurave, qëndistaria dhe poçeria.

Promovimi i grave artizane dhe prodhimeve të tyre përmes mbështetjes me trajnime dhe marketing dhe akses në tregje të vlerës së lartë, mund t'i fuqizojë ndjeshëm gratë në zonë. Gratë në Shkodër janë shquar tradicionalisht për aftësitë e tyre në endjen e pëlhurave.

# Shtojca 2: Konteksti Kombëtar i Barazisë Gjinore

Korniza ligjore në Shqipëri, sidomos për sa i përket barazisë gjinore, është ndërtuar mbi dispozitat kushtetuese dhe ligjore që synojnë të sigurojnë të drejta të barabarta të burrave dhe grave.
Neni 18/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk duhet të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etniciteti, gjuha, bindjet politike, ose karakteristika të tjera.

Gjatë viteve, Shqipëria ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të harmonizuar kornizën e saj ligjore me standardet ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe luftimin e diskriminimit, dhunës, dhe abuzimit në familje me bazë gjinore. Ndër ligjet kryesore që kontribuojnë në këtë kornizë ligjore përfshihen:

**Ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri"** (Ligji nr. 9970/2008): Ky ligj trajton çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, për sigurimin e mundësive të barabarta për burrat dhe gratë në ushtrimin e të drejtave të tyre, që ata të kontribuojnë në sektorë të ndryshëm të shoqërisë. Ai gjithashtu parashikon masa të veçanta të përkohshme, ndër të cilat edhe kuota gjinore prej 30% për poste politike dhe vendimmarrëse.

**Kodi Zgjedhor (Ligji nr. 10019/2008)**: Me ndryshimet që iu bënë në vitin 2012, në Kod u përfshinë kuotat gjinore në procesin zgjedhor, duke siguruar që asnjëra gjini të mos përfaqësohej nga më pak se 30% në listat e kandidatëve të partive politike për zgjedhjet parlamentare. Përpos kësaj, në vitin 2020 dhe vitin 2024 u përfshinë dispozita të specifike për garantimin e kuotave gjinore. Ndryshimet që iu bënë Kodit në 2015 dhe 2020 i zgjeruan më tej kuotat gjinore, ndër të cilat edhe kuota prej 50% meshkuj dhe 50% femra për zgjedhjet vendore. "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (Ligji Nr. 57/2016), përfshin për herë të parë konceptin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në menaxhimin e sistemit buxhetor, duke shtuar si parim të funksionimit të tij respektimin e barazisë gjinore, ku burri dhe gruaja gëzojnë mundësi dhe akses të barabartë në të drejta dhe përfitime të së njëjtës natyrë.

**Ligji "Për financat e vetëqeverisjes vendore"** (Ligji nr. 68/2017) ka krijuar mundësi për përfshirjen e efektshme të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit financiar vendor (programimi i buxhetit vjetor dhe afatmesëm, monitorimi dhe raportimi, vlerësimi dhe auditimi). Ndër të tjera, ky ligj synon të sigurojë që nëpërmjet krijimit dhe shpërndarjes së burimeve financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore të përshpejtohet dhe realizohet barazia gjinore.

**Kodi i Punës (Ligji nr. 7961/1995)**: Kodi i Punës ndalon diskriminimin në punësim, kërkon akomodim të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara dhe ndalon ngacmimin moral dhe seksual në vendin e punës. Ai përfshin gjithashtu edhe dispozita për promovimin e barazisë gjinore në punësim dhe të drejta profesionale.

**Ligji "Për personat me aftësi të kufizuara"** (Ligji nr. 93/2014): Ky ligj garanton mundësi dhe akses të barabartë për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë garantimin që gratë me aftësi të kufizuara të kenë të njëjtat mundësi si burrat me aftësi të kufizuara për akses në të drejtat e garantuara nga ky ligj.

**Ligji "Për sigurimet shoqërore"** (Ligji nr. 104/2014): Ky ligj njeh të drejtën e nënave dhe të baballarëve për leje prindërore, përfshirë zgjatjen e lejes së barrëlindjes deri në 63 ditë dhe aplikimi i bonusit për nënat me foshnja të porsalindura.

**Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"** (Ligji nr. 9669/2006): Ky ligj synon parandalimin dhe reduktimin e të gjitha formave të dhunës, duke u ofruar mbrojtje viktimave përmes procedurave të shpejta, jo të kushtueshme dhe të thjeshta. Me ndryshimet që iu bënë ligjit në vitet 2018 dhe 2020 u forcuan dispozitat që lidhen me parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave.

**Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi"**, i ndryshuar (Ligji nr. 221, datë 04.02.2010). Sipas këtij ligji, askush nuk mund të diskriminohet për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicionit gjenetik, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër. Edhe ky ligj u përmirësua me Ligjin 124/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 për mbrojtjen nga diskriminimi", ku ndër të tjera saktësohet më tej objekti i këtij ligji, shtohen përkufizimet, duke theksuar gjuhën e urrejtjes, jepet përkufizim për format e rënda të diskriminimit, etj.

**Ligji 22/2018 "Për strehimin social"**, ku theksohet parimi i mosdiskriminimit, për planifikimin, pajisjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e strehimit për grupet sociale në nevojë për strehim. Nga programi i banesave të specializuara përfitojnë shtresat vunerabël përfshirë viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe vajzat nëna.

**Ligji 110/2018 "Për noterinë"**, që fuqizon pavarësinë ekonomike të gruas dhe është garant kryesor i të drejtave pronësore të saj, duke sjellë risi në çështjet e rregullimit të barazisë gjinore në aspektin e mbrojtjes së pasurive.

**Ligji 111/2018 "Për kadastrën"**, që gjithashtu rregullon çështjet e barazisë gjinore, lidhur me regjistrimin e pasurisë së bashkësisë ligjore.

**Ligji 15/2019 "Për nxitjen e punësimit"**, ku viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje apo nënat nën moshën 18 vjeç, specifikohen tek grupet e veçanta të punëkërkueseve/punëkërkuesve të pafavorizuar në tregun e punës, të cilat/cilët përfitojnë nga shërbimet dhe programet e nxitjes së punësimit.

**Ligji 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"** ku përcaktohen si përfituese/përfitues të ndihmës ekonomike ndër të tjera viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre si dhe viktimat e dhunës në familje, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të cilat nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

**Ligji 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara"**, ku theksohet miradministrimi dhe përdorimi eficient, efektiv dhe ekonomik i pasurive të sekuestruara e konfiskuara nga organet e drejtësisë dhe pasurive të sekuestruara me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, rikthimi në komunitet i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe kompensimi financiar i viktimave të krimit.

Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore 2021-2030 (SKBGJ) përbën një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku të gjithë individëve gra, burra, të reja, të rinj, vajza e djem, pavarësisht moshës, gjinisë, vendlindjes e vendbanimit, grupit etnik apo social, aftësive të kufizuara, përkatësisë e besimit fetar, shprehjes së identitetit gjinor e orientimit seksual, si dhe karakteristikave të tjera individuale, u jepen mundësi të barabarta të zhvillojnë potencialet e tyre; të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrjen politike e publike; të zgjedhin e të zgjidhen; të edukohen dhe aftësohen gjatë gjithë jetës; të punësohen e punësojnë duke avancuar drejt profesioneve të reja e duke sfiduar stereotipat dhe ndarjen gjinore të punës; të ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe të mbështeten për t'u zhvilluar në aspektin social dhe ekonomik; të krijojnë familje të shëndetshme, ku prindërit ndajnë përgjegjësitë në mënyrë të barabartë dhe ku komunikimi është çelësi i zgjidhjes së problemeve; të jetojnë të lirë nga praktikat e dëmshme dhe dhuna; si dhe ku grupet e cenueshme trajtohen me përparësi dhe mbështeten derisa të fuqizohen e gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës - pra një shoqëri ku barazia nuk ngatërrohet me njëtrajtshmërinë dhe ku askush nuk duhet të mbetet pas.[39] Në nivel vendor, promovimi i përfshirjes dhe barazisë gjinore është bërë pjesë e kornizave ligjore dhe të politikave që theksojnë detyrimet e njësive të vetëqeverisjes vendore në fushën e barazisë gjinore (UN Women, 2019). Për shembull, Ligji «Për barazinë gjinore» shtjellon nevojën për promovimin e barazisë gjinore në qeverisjen lokale dhe njësitë e veçanta që janë përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin

39. VKM nr. 400, datë 30.06.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030, dhe të planit të saj të veprimit"

e performancës dhe shërbimit, përfshirë barazinë gjinore. Janë bërë përpjekje nga disa bashki për t'iu përmbajtur dispozitave të rregullores së e Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve Evropiane (KBRE) dhe standardeve e BE-së, me strukturë të qartë, prioritete, përgjegjësi dhe buxhete që u përgjigjen nevojave të grave, burrave, të rinjve e të rejave në mënyrë të barabartë (UN Women, 2018). Tetëmbëdhjetë njësi vetëqeverisëse vendore kanë nënshkruar "Kartën evropiane për barazinë e burrave dhe grave në jetën vendore" – një numër i tyre me ndihmën e UN Women, dhe 15 prej tyre kanë hartuar plan veprimi vendor për barazinë gjinore. Si rezultat i këtyre, ligjeve, politikave dhe planeve, Shqipëria ka shënuar përmirësime në shumë aspekte të barazisë gjinore, për shembull, në rolin e grave në zhvillimin e sektorit privat. Përqindja e sipërmarrjeve me pronare ose administratore gra është rritur në të gjitha zonat e Shqipërisë. Megjithatë decentralizimi dhe zbatimi i suksesshëm i kornizave ligjore dhe të zhvillimit ende has në vështirësi dhe ritmi i ndryshimit në fuqizimin ekonomik të grave përmes zhvillimit të sektorit privat është i ngadaltë, sidomos ndër gratë në zonat rurale. Normat, rolet dhe përgjegjësitë gjinore, dhe tendenciozitetë gjinor në aksesin e grave në burimet prodhuese (si toka, financat, rrjetet, teknologjia dhe pajisjet) dhe në shërbimet e biznesit, bëjnë që ende të mos ketë barazi për gratë dhe burrat në sferat ekonomike dhe sociale.

Disa ndikime të tendenciozitetit gjinor që shihet në Shqipëri për sa i përket fuqizimit të grave përmes zhvillimit të sipërmarrjeve, janë:

- 31,2% e ndërmarrjeve drejtohen nga gra.[40] Në vitin 2022, përqindja e grave pronare dhe administratore u pakësua krahasuar me vitin 2021, si për sa u përket bizneseve që prodhojnë të mira, ashtu edhe ato në sektorin e shërbimeve. Numri i bizneseve me pronare ose administratore gra është më i madh në sektorin e shërbimeve se sa në sektorin e prodhimit të të mirave, me përkatësisht 33,4 % and 17,2 %.

- Shkalla e punësimit në vitin 2023 ishte 72,9 % për burrat dhe 58, 9 % për gratë në grupmoshën 15-64 vjeç. Struktura e të punësuarve sipas statusit të aktivitetit tregon se 45,4% e grave janë të punësuara me pagë, ndërsa 23,5% e tyre janë punëtore pa pagesë në biznesin e familjes.[41]

- Në Shqipëri, numri i familjeve me kryefamiljarë burra është 4 herë më i madh se i atyre me kryefamiljare gra. Grupmosha 55-64 vjeç ka numrin më të madh të familjeve me kryefamiljarë burra, dhe grupmosha 74+ vjeç, numrin më të madh të grave kryefamiljare. Për të gjitha grupmoshat, numri i familjeve me kryefamiljarë burra është më i lartë.[42]

- Gratë luajnë rol të rëndësishëm në sektorët e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Shqipëri, ku përbëjnë një pjesë të madhe të forcës punëtore në bujqësi, ndonëse në shumicën e rasteve në punësim informal. Në vitin 2023, 37,3 % e grave të punësuara ishin të punësuara në sektorin e bujqësisë, me një rritje prej 0,1 pikë përqindjeje krahasuar me vitin pararendës. Bujqësia është burimi më i rëndësishëm i punësimit për gratë që jetojnë në zonat rurale.

Pabarazitë gjinore në bujqësi shpesh vazhdojnë të ekzistojnë për shkak të kornizave administrative diskriminuese. Ndër to përfshihen praktika që: (i) i pengojnë gratë të jenë (bashkë-)pronare të tokës; (ii) i pengojnë gratë të fitojnë të ardhurat të vetat apo të kenë akses në shërbime mbështetëse (për shembull, duke u refuzuar përdorimin e numrit tatimor);[43] (iii) kërkojnë nga gratë që të paraqesin "certifikatën e fermerit" si kriter për të marrë pjesë në programe trajnimi dhe për të përfituar shërbime këshillimore; dhe (iv) i lejojnë shoqatat e përdoruesve të ujit të përdorin pronësinë mbi tokën si kriter për anëtarësim në to.[44] Faktorë të tjerë pengues janë mungesa e transportit

40. INSTAT, Regjistrat e Biznesit, 2023. https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/regjistrat-e-biznesit/#tab3

41. Gra dhe burra në Shqipëri, 2022, https://www.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-indicators/gender-equality/#tab3

42. Po aty.

43. Sipas Udhëzimit nr.19, 'Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar', datë 3/9/2014, fermerët që i shesin prodhimet e tyre duhet të regjistrohen në zyrat tatimore dhe të kenë një numër unik identifikimi të personit të tatueshëm. Ky regjistrimi është i detyrueshëm që fermerët të përfitojnë nga skemat mbështetëse për fermerët në vend. Pjesa më e madhe e atyre që kanë numër identifikimi të personit të tatueshëm janë burra, megjithëse, në parim, bashkëregjistrimi është i lejueshëm/i mundshëm. Shih: https://www.tatime.gov.al/c/3/12/23/fermere

44. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2024.

publik në zonat rurale dhe mundësitë e kufizuara të lëvizjes. Në Shqipëri, pjesa më e madhe e motoçikletave dhe automjeteve zotërohen dhe drejtohen nga burrat dhe në vend mbizotëron norma sociale se nuk është e përshtatshme që gratë të udhëtojnë të pashoqëruara. Mundësitë e kufizuara të lëvizjes e bëjnë të vështirë që gratë të kenë akses në tregje.[45] Shumë gra nuk janë ende të regjistruara si (bashkë-)pronare të shtëpive, tokës dhe pasurive të tjera të tyre, që vazhdojnë të figurojnë të regjistruara më së shumti në emër të bashkëshortit ose të anëtarëve të tjerë meshkuj të familjes. Ndër gratë që zotërojnë pronë, pjesa më e madhe (afërsisht 76 për qind) e kanë emrin në një titull ose dokument pronësie për shtëpinë, por jo për tokën.[46] Gratë luajnë rol kyç në zhvillimin dhe rritjen ekonomike të komuniteteve rurale. Por ky rol i rëndësishëm i tyre – sidomos në prodhimin bujqësor – shpesh është "i padukshëm" dhe nuk njihet.[47]

# Shtojca 3. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural: Çështje Gjinore Kyçe në Shqipëri

### Puna e grave në bujqësi kontribuon konsiderueshëm në ekonomi, por roli i tyre përgjithësisht vazhdon të mos njihet

Në vitin 2022 bujqësia përfaqësonte 17,7 për qind të PBB-së në Shqipëri.[48] Ajo vazhdon të jetë sektor kyç në ekonominë e vendit, ku angazhohen 33,9 për qind të forcave aktive të punës. Bujqësia është burimi më i rëndësishëm i punësimit për gratë që jetojnë në zonat rurale: ato përbëjnë 40,1 për qind të forcave të punës në bujqësi, krahasuar me 28,7 për qind të burrave.49 Bujqësia është burimi më i rëndësishëm i punës për gratë që jetojnë në zonat rurale.

### Ashtu si sektorë të tjerë të ekonomisë, sektori bujqësor karakterizohet nga segmentimi gjinor i tregut të punës.

Gratë e punësuara në bujqësi kanë më tepër gjasa të kryejnë punë me paga të ulëta, me kohë të pjesshme ose sezonale, ndërsa burrat janë më së shumti të punësuar në vende pune të paguara më mirë dhe me kualifikim më të lartë.[50] **Në përgjithësi, gratë janë të mbipërfaqësuara në punësim informal, punë të papaguar, dhe si kontribuese të punës në familje. Një analizë e strukturës së punësimit dhe statusit të aktiviteteve të personave të punësuar tregon se** 23,5 për qind e grave punojnë në familje, ndërsa përqindja e burrave që punojnë në familje është shumë më e ulët, 13.2 për qind. Përpos kësaj, sektori karakterizohet nga një sasi e konsiderueshme pune të papaguar të grave.[51] Në punësimin informal, përqindja e grave që kontribuojnë si punëtore në familje është pothuaj dy herë më e madhe se e burrave (54 për qind kundrejt 28 për qind).[52] […] Megjithëse gratë mbajnë mbi shpatulla një pjesë të konsiderueshme të barrës së punës në bujqësi, kontributi i tyre mbetet në një shkallë të lartë i pavlerësuar nga pikëpamja ekonomike.[53] […][54]

45. FAO dhe UN Women (në botim). *National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania* (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

46. INSTAT (2018). Studimi i Dytë Demografik dhe Shëndetësor Shqiptar (2017-2018). Shih: https://dhsprogram.com/pubs/pdf/FR348/FR348.pdf

47. Po aty.

48. INSTAT [në internet]. Të dhënat e llogarive kombëtare (PPB) të vitit 2023. Shih: https://www.instat.gov.al/en/themes/economy-and-finance/national-accounts-gdp/

49. INSTAT (2023). Gra dhe Burra. Shih: https://www.instat.gov.al/media/12598/burra-dhe-gra-2023.pdf. Ndërsa në vitin 2019, burrat përbënin 32,2 për qind, përqindja e grave ka mbetur pothuaj e pandryshuar.

50. FAO (2011). *The Role of Women in Agriculture* (Roli i grave në bujqësi). Shih: https://openknowledge.fao.org/items/a605b688-83e0-4e3a-ad47-874f0d6f63b1

51. INSTAT (2023). Tregu i punës, 2022. Gjendet në: https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2023/labour-market-2022/

52. Përllogaritjet e ONP-së për vitin 2019 (ILOSTAT). Shih: ONP (2023). Women and Men in the Informal Economy: A Statistical Update (Gratë dhe burrat në ekonominë informale: përditësim statistikor). Gjendet në: https://www.ilo.org/publications/women-and-men-informal-economy-statistical-update

53. FAO (2016). Gender, Agriculture and Rural Development in Albania (Gjinia, Bujqësia dhe Zhvillimi Rural në Shqipëri). Shih: https://albania.un.org/sites/default/files/2020-05/no.52-%20Gender%2C%20agriculture%20and%20rural%20development%20in%20Albania.pdf

54. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

### Stereotipat gjinorë dhe praktikat diskriminuese kufizojnë aksesin e grave në burimet thelbësore të prodhimit bujqësor bazë

Në themel të praktikave diskriminuese qëndron koncepti i rrënjosur thellë se puna e grave është plotësuese e punës së burrave, të cilët konsiderohen si fituesit kryesorë të jetesës në familjet shqiptare. Kështu, ndërkohë që kryefamiljarët meshkuj shpesh janë pronarë që zotërojnë dhe administrojnë pasuritë familjare dhe lëndët e para bujqësore (për shembull, farat, plehrat organike dhe kimike, makineritë bujqësore), gratë në të njëjtat familje shpesh nuk kanë lirinë t'i përdorin burimet ose të vendosin bashkërisht për varietetet e bimëve, llojet e plehrave dhe kimikateve që përdoren, ose kohën e përdorimit të tyre. Në këto raste, gratë nuk mund t'i vënë njohuritë dhe përvojat e tyre në shërbim të veprimtarive prodhuese. […] Pabarazitë gjinore në bujqësi shpesh vazhdojnë të ekzistojnë për shkak të kornizave administrative diskriminuese. Ndër to përfshihen praktika që: (i) i pengojnë gratë të jenë (bashkë-)pronare të tokës; (ii) i pengojnë gratë të fitojnë të ardhurat të vetat apo të kenë akses në shërbime mbështetëse (për shembull, duke u refuzuar përdorimin e numrit tatimor)[55]; (iii) kërkojnë nga gratë që të paraqesin "certifikatën e fermerit" si kriter për të marrë pjesë në programe trajnimi dhe për të përfituar shërbime këshillimore; dhe (iv) i lejojnë shoqatat e përdoruesve të ujit të përdorin pronësinë mbi tokën si kriter për anëtarësim në to.

### Faktorë të tjerë pengues janë mungesa e transportit publik në zonat rurale dhe mundësitë e kufizuara të lëvizjes.

Në Shqipëri, pjesa më e madhe e motoçikletave dhe automjeteve zotërohen dhe drejtohen nga burrat dhe në vend mbizotëron norma sociale se nuk është e përshtatshme që gratë të udhëtojnë të pashoqëruara. Mundësitë e kufizuara të lëvizjes e bëjnë të vështirë që gratë të kenë akses në tregje.[56] […][57]

### Shërbimet këshillimore bujqësore janë kryesisht për burrat

Shërbimi Kombëtar i Ekstensionit Bujqësor (SHKEB) për këshillim bujqësor, një strukturë në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, operon nëpërmjet katër agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor (AREB) dhe, në nivel vendor, përmes qendrave të informacionit bujqësor. Shërbimi këshillimor publik përfshin gjithashtu pesë qendra të specializuara të transferimit të teknologjisë bujqësore. […] kapacitetet dhe aftësitë gjinore ende nuk janë pjesë e kualifikimeve të kërkuara për punonjësit dhe trajnimet në këtë drejtim mungojnë. Reagueshmëria e dobët gjinore e shërbimeve, së bashku me statusin social të grave dhe nivelet e ulëta të pronësisë së tyre mbi tokën, ka bërë që gratë të kenë akses të kufizuar në shërbime mbështetëse.[58] Shërbimet këshillimore bujqësore kanë si grup të synuar dhe ndihmojnë burrat: ndër 70.000 fermerët që u kontaktuan dhe ndihmuan nga shërbimet këshillimore në zona të ndryshme të vendit në vitin 2016, u konstatua se vetëm rreth 11 për qind ishin gra.[59] Që prej atëherë, numri i grave përfituese të shërbimeve këshillimore është tkurrur më tej, duke arritur në vetëm 8 për qind në vitin 2023.[60] Si rezultat i aksesit të kufizuar në informacione bujqësore dhe për tregun, niveli i produktivitetit të grave mbetet i ulët. […][61]

55. Sipas Udhëzimit nr.19, 'Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar', datë 3/9/2014, fermerët që i shesin prodhimet e tyre duhet të regjistrohen në zyrat tatimore dhe të kenë një numër unik identifikimi të personit të tatueshëm. Ky regjistrimi është i detyrueshëm që fermerët të përfitojnë nga skemat mbështetëse për fermerët në vend. Pjesa më e madhe e atyre që kanë numër identifikimi të personit të tatueshëm janë burra, megjithëse, në parim, bashkëregjistrimi është i lejueshëm/i mundshëm. Shih: https://www.tatime.gov.al/c/3/12/23/fermere

56. FAO dhe UN Women (në botim). *National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania* (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

57. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

58. FAO (2024). *Ensuring that rural advisory services are responsive to women: good practices from FAO experiences in Europe and Central Asia* (Sigurimi që shërbimet këshillimore rurale t'u përgjigjen nevojave të grave: praktika të mira nga përvojat e FAO-s në Evropë dhe Azinë Qendrore). Shih: https://openknowledge.fao.org/items/c69ef2a6-4381-4e16-b624-a090e94b5710

59. UNDP dhe UN Women (2016). Dosja Gjinore Shqipëri. Shih: https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/10/albania-gender-brief

60. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të dhëna të vitit 2024, cituar në: FAO dhe UN Women (së shpejti). *National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania* (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

61. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023.. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

## Niveli i tanishëm i (bashkë-)regjistrimit të fermave kufizon aksesin e grave në mundësi ekonomike

Legjislacioni që garanton të drejta të barabarta të grave në pronësi dhe trashëgimi është përmirësuar ndjeshëm.[62] Megjithatë, ende nuk janë të disponueshme të dhëna në lidhje me (bashkë-)pronësinë e grave mbi tokën. Aktualisht, vetëm 10 për qind e titujve të pronësisë mbi tokën janë të regjistruar digjitalisht, 10 për qind nuk janë të regjistruar, ndërsa 80 për qind ekzistojnë të regjistruar vetëm në letër. […] Shumë gra nuk janë ende të regjistruara si (bashkë-) pronare të shtëpive, tokës dhe pasurive të tjera të tyre, që vazhdojnë të figurojnë të regjistruara më së shumti në emër të bashkëshortit ose të anëtarëve të tjerë meshkuj të familjes. Ndër gratë që zotërojnë pronë, pjesa më e madhe (afërsisht 76 për qind) e kanë emrin në një titull ose dokument pronësie për shtëpinë, por jo për tokën.[63] […]Kjo i ka penguar gratë fermere që, për shembull, të përfitojnë shërbime këshillimore bujqësore, mbështetje financiare, dhe kontrata formale të rregullta me tregtarët, gjë që ka ndikuar negativisht në produktivitetin e tyre.[64] Krahas kësaj, gratë ndeshin vështirësi për të pasur akses në kredi nga bankat komerciale, kryesisht për shkak të kolateralit të pamjaftueshëm, situatë që rëndohet edhe më për shkak se të drejtat pronësore *de facto* janë të dobëta ose inekzistente. Arritja e një barazie më të madhe në të drejtat pronësore mbi tokën dhe aksesin në kredi do të shtonte ndjeshëm pjesëmarrjen fitimprurëse të grave në ekonominë bujqësore. Mungesa e pronësisë mbi tokën ndikon gjithashtu edhe në mundësitë e anëtarësimit të grave në organizatat e fermerëve, si shoqatat e përdoruesve të ujit dhe të ujitjes dhe shoqatat e prodhuesve. Duke qenë se për t'u anëtarësuar në këto organizata shpesh duhet të jesh pronar i tokës ose kryefamiljar, gratë e kanë të vështirë të bëhen anëtare të tyre. Kur shërbimet këshillimore bujqësore u drejtohen vetëm fermerëve të regjistruar ose anëtarëve të shoqatave, gratë automatikisht përjashtohen për shkak të mospërmbushjes së kushteve të anëtarësimit dhe, rrjedhimisht, nuk përfitojnë nga këto shërbime. […][65]

## Gratë kanë (bashkë-)pronësi të kufizuar në ferma dhe ndërmarrje bujqësore

Në vitin 2022, nga 84.369 fermerë të regjistruar zyrtarisht në zyrat tatimore në Shqipëri, vetëm 10,8 për qind ishin gra.[66] Pjesa më e madhe e kontributit të grave në sektorin bujqësor konsiston në punësim informal në familjen bujqësore.[67] Në këtë lloj aktiviteti bujqësor, burrat përgjithësisht identifikohen si drejtues dhe "kryefamiljarë" ndërsa gratë janë të regjistruara si "ndihmëse", nën kategorinë "punëtorë familjarë kontribues".[68] Zakonisht burrat janë ata që kanë nën kontroll asetet bujqësore, marrin vendime, administrojnë financat dhe kryejnë punët që kërkojnë lëvizshmëri, ndërsa gratë merren kryesisht me punë fizike bujqësore, si punët para dhe pas vjeljes/korrjes, përpunimet ushqimore dhe punët e shtëpisë. Kjo ndarje e pabarabartë e punës kufizon aksesin e grave në asete bujqësore.

Ndërmarrjet që operojnë në kuadër të kategorisë ekonomike "Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi" përfaqësojnë vetëm 1 për qind të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve aktive.[69] Në mbi 80 për qind të ndërmarrjeve

62. Ligji nr.111/2018 për Kadastrën, miratuar më 02/02/2019. Gjendet në: https://www.ashk.gov.al/2021/04/16/2066/. (versioni në gjuhën angleze gjendet në): https://www.fao.org/faolex/results/details/en/c/LEX-FAOC220473/); dhe Ligji nr.110/2018 për Noterinë, miratuar më 20/12/2018. Gjendet në: http://www.nchb.al/wp-content/uploads/2021/04/Ligj-nr.-110-2018-Per-Noterine.pdf. (Një përkthim jozyrtar në anglishte gjendet në: https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=160&catid=25&m=0). Legjislacioni i ri synon të mbrojë gratë nga tjetërsimi, blerja dhe heqja dorë nga pronat e tyre të paluajtshme, përfshirë tokën. Ai parashikon zbatimin e një sistemi me një sportel, tek noteri publik, për transaksionet që lidhen me tokën si edhe krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës për sigurimin e llogaridhënies nga noterët.

63. INSTAT (2018). Studimi i Dytë Demografik dhe Shëndetësor Shqiptar (2017-2018). Shih: https://dhsprogram.com/pubs/pdf/FR348/FR348.pdf

64. UN Women (2016). Studim kombëtar: Diversifikimi ekonomik për gratë që jetojnë në zonat rurale në Shqipëri. Gjendet në: https://albania.un.org/en/46581-economic-diversification-women-living-albanian-rural-areas

65. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

66. INSTAT (2022). Regjistrat e biznesit, 2022. Gjendet në: https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2023/business-registers-2022/

67. Po aty.

68. FAO (2016). *Gender, Agriculture, and Rural Development in Albania* (Gjinia, bujqësia dhe zhvillimi rural në Shqipëri). Shih: https://albania.un.org/sites/default/files/2020-05/no.52-%20Gender%2C%20agriculture%20and%20rural%20development%20in%20Albania.pdf

69. INSTAT (2022). Regjistrat e biznesit, 2022. Gjendet në: https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2023/business-registers-2022/

bujqësore aktive, pronarët ose drejtuesit janë burra: në vitin 2022, gratë ishin (bashkë-)pronare të vetëm 18,5 për qind të ndërmarrjeve aktive në bujqësi, pylltari, dhe peshkim.[70] Që nga viti 2016, numri i përgjithshëm i grave pronare dhe drejtuese të bizneseve në Shqipëri është rritur. Megjithatë, niveli dhe ritmi i përfshirjes ekonomike të grave përmes zhvillimit të sektorit privat vazhdojnë të jenë të ulëta, sidomos për sa u përket grave **në zonat rurale. Ndikimi i normave gjinore kufizuese që çojnë në diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të grave është i dukshëm në të gjitha nivelet e ekonomisë rurale** […][71]

### Gratë në zonat rurale kanë akses të kufizuar në burimet e nevojshme për t'u marrë me biznes

Shumë gra në Shqipëri përballen me vështirësi për të pasur akses në burime biznesi. Gratë që nuk kanë llogari bankare apo nuk zotërojnë tokë për ta ofruar si kolateral, kanë akses të kufizuar në shërbime financiare, gjë që ua bën të vështirë të krijojnë, menaxhojnë, ose zgjerojnë bizneset e tyre.

Për përfitimin e shërbimeve financiare zakonisht është kusht që të kesh llogari bankare. Megjithatë, ekziston një vijë e qartë ndarëse midis zonave rurale dhe urbane: në vitin 2017, vetëm 31 për qind e banorëve të zonave rurale raportuan se kishin llogari bankare, krahasuar me 52 për qind të banorëve në zona urbane.[72] **Përveç kësaj, shihet qartë edhe një hendek i konsiderueshëm gjinor: në grupmoshën 15-45 vjeç, vetëm 17 për qind e grave dhe 25,9 për qind e burrave që jetonin në zona rurale raportuan se kishin llogari bankare, krahasuar me 44,7 për qind të grave dhe 48,2 për qind të burrave në zonat urbane.**[73] **Këto rezultate ilustrojnë disavantazhet për shkak të përkatësisë së shumëfishtë, si rezultat i** karakteristikave gjinore (domethënë, të qenit grua) dhe atyre të vendbanimit (domethënë, banimi në zone rurale).

Krahas kësaj, gratë në zonat rurale kanë akses të kufizuar në trajnime që ofrojnë njohuri dhe aftësi biznesi, si ato për përpunimin dhe marketimin e produkteve. Për marketimin e duhur të biznesit, është e rëndësishme të merret në kohë informacion i saktë përmes telefonit celular, radios, apo përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Zotërimi ose jo i këtyre mjeteve dhe burimeve nga gratë mund të ndikojë në suksesin e biznesit të tyre.

Ndonëse përgjithësisht janë bërë përparime në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në marketim, gratë në zonat rurale kanë akses të kufizuar në internet dhe në TIK. Në përgjithësi, infrastruktura e teknologjisë së informacionit është mjaft e zhvilluar në qendrat urbane. Kurse në zonat rurale, ku mbulimi me infrastrukturën e energjisë elektrike dhe internetit me bandë të gjerë nuk është aq i zhvilluar, kostot e këtyre shërbimeve janë të larta dhe depërtimi i ulët – dhe numri i personave që kanë akses në internet dhe që përdorin atë është më i vogël. Në zonat rurale, më pak se 10 për qind e familjeve kanë akses në internet dhe vetëm 28 për qind e tyre kanë kompjuter.[74] Mungesa e konektivitetit të zonave rurale në Shqipëri është evidentuari si një prej mangësive që pengon rritjen ekonomike në vend.[75] **Për më tepër, kur në familje ka vetëm një telefon celular, ai shpesh përdoret vetëm nga kryefamiljari, ndërsa gratë dhe vajzat në familje nuk mund ta përdorin atë lirisht. Aktualisht nuk ka studime mbi aksesin e grave në zonat rurale në internet dhe në TIK.**

### Gratë fermere kanë përfaqësim të ulët në organizata, shoqata dhe organe vendimmarrëse në zonat rurale

Me gjithë rolin e rëndësishëm të grave të zonave rurale në prodhimin bujqësor në Shqipëri, pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje në nivel të familjes, komunitetit dhe administrativ është përgjithësisht e kufizuar. Gratë rrallë janë

70. Po aty.

71. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

72. INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik, dhe ICF (2018). Studimi i Dytë Demografik dhe Shëndetësor Shqiptar (2017-2018). Gjendet në: http://www.instat.gov.al/media/5050/adhs-2017-18-pdf.pdf

73. Po aty.

74. Po aty.

75. ITU (2022). *Albania – Digital Development Country Profile* (Shqipëria – Profili i zhvillimit digjital të vendit. Shih: https://www.itu.int/en/ITU-D/Regional-Presence/Europe/Documents/Publications/2022/Digital%20Development/Digital%20Development%20Country%20Profile_Albania_final_02.22.pdf

anëtare apo përfaqësohen në shoqata apo komitete zyrtare dhe ato vazhdojnë të jenë tejet të nënpërfaqësuara në poste vendimmarrëse dhe drejtuese.[76] Në nivel komuniteti, burrat janë drejtues të grupeve prodhuese dhe kooperativave, ndërsa gratë janë të përjashtuara, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga marrja e vendimeve. Në organizatat e fermerëve, numri i grave anëtare është zakonisht i ulët, sepse në ato organizata pranohen si anëtarë kryesisht kryefamiljarët. Rrjedhimisht, gratë rrallë janë të pranishme në diskutime dhe vendimet që merren në grup nuk pasqyrojnë njohuritë, pikëpamjet, nevojat dhe të drejtat e tyre. Shqetësim është gjithashtu mospjesëmarrja e grave në proceset e menaxhimit të burimeve natyrore, si menaxhimi i integruar i ujit, si dhe niveli i ulët i përfshirjes së grave rurale në nismat lidhur me ndryshimet klimatike dhe ruajtjen e biodiversitetit dhe të trashëgimisë kulturore.[77]

[…] Gjithashtu, gratë nuk kanë pushtet ekonomik, influencë politike, apo informacion mbi proceset e vendimmarrjes. Së fundi, për shkak të kufizimeve në mundësitë e lëvizjes, largësia fizike nga qendrat administrative ku merren vendimet i kufizon më tej mundësitë e pjesëmarrjes së grave. […][78]

### Ofrimi i shërbimeve dhe infrastruktura rurale nuk plotësojnë nevojat e grave dhe vajzave

Në Shqipëri vazhdon të jetë shqetësim aksesi i kufizuar – sidomos i grave dhe vajzave - në shërbime bazë si shëndetësia, kujdesi shëndetësor seksual dhe riprodhues dhe mbrojtja sociale në zonat rurale dhe të thella.[79] Krahas kësaj, infrastruktura e dobët e furnizimit me ujë dhe mbledhjes së ujërave të zeza, mungesa e pajisjeve teknologjike që kursejnë kohë, ofrimi i pamjaftueshëm i shërbimeve të kujdesit për fëmijët e vegjël, infrastruktura e pasigurt e transportit dhe mungesa e transportit publik me kosto të përballueshme - që të gjitha ndikojnë negativisht në mundësitë e grave për t'i kushtuar kohë punës produktive dhe të paguar dhe për të pasur akses në tregje.

### Formimi profesional bujqësor nuk mbështet perspektivat e grave dhe vajzave për të pasur karrierë në këtë sektor

Në kuadër të aspiratës së Shqipërisë për të hyrë në tregun e përbashkët të BE-së, të rinjtë e të rejat duhet të kenë nivele të reja të përgatitjes profesionale që të mund të angazhohen si punëtorë fermash, teknikë, sipërmarrës biznesesh bujqësore apo vendimmarrës në fushën e zhvillimit rural. Shkollat profesionale luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e kapaciteteve njerëzore të kualifikuara dhe pajisjen e të rejave dhe të rinjve me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që kërkon tregu. Por me gjithë veprimtaritë promovuese dhe mbështetjen për nxitjen e nxënësve nga zonat rurale të Shqipërisë për të marrë pjesë në arsim dhe formim profesional (AFP), numri i nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme profesionale ka rënë. Kjo rënie ka qenë veçanërisht e ndjeshme në regjistrimet nga radhët e grupeve vulnerabël (një rënie me 30 për qind).[80] Në Shqipëri ka tetë shkolla të mesme bujqësore dhe nxënësit në to vazhdojnë të jenë pothuaj tërësisht djem. Numri i vajzave është i ulët (afërsisht 16 për qind) dhe pjesëmarrja e vajzave nga zonat rurale është pothuaj e papërfillshme. […][81]

### Politikat, programet, buxhetet dhe skemat kombëtare për mbështetjen e bujqësisë dhe blegtorisë nuk u përgjigjen mjaftueshëm nevojave të grave

Në përgjithësi, politikat, planet, programet dhe buxhetet në Shqipëri hartohen mbi bazën e premisës se të gjithë individët që merren me bujqësi dhe blegtori janë burra. Sikurse shihet edhe në Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit

76. UN Women (2020). Dosja e Barazisë Gjinore, Shqipëri 2020. Shih: https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/country-gender-equality-brief-albania-2020-0

77. Po aty.

78. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

79. KEGJFDG E OKB-SË (2023). Vërejtje përmbyllëse të raportit të pestë periodik për Shqipërinë, 2023. Gjendet në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=KEGJFDG%2FC%2FALB%2FCO%2F5&Lang=en

80. Komisioni Evropian (2023). Raporti për Shqipërinë 2023. Shih: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/ea0a4b05-683f-4b9c-b7ff-4615a5fffd0b_en?filename=SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

81. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

Rural dhe Peshkimit 2021-2027,[82] **vëmendja e dokumenteve strategjike përqendrohet tek fermerët burra. Edhe zyrtarët dhe punonjësit e këshillimit bujqësor që shpërndajnë teknologji, politika, informacion dhe risi bujqësore ndër fermerët, janë kryesisht burra. Ndonëse në periudhën 2018-2023 numri i përgjithshëm i grave që përfituan nga skemat kombëtare të mbështetjes pati rritje në vlerë absolute, përqindja e grave në raport me numrin e gjithsejtë të përfituesve ra nga 22 për qind në vitin 2018 në 16 për qind në vitin 2023.**[83] **Për të nxitur pjesëmarrjen e grave, Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural** (FBZHR) u jep pikë shtesë ("bonus") grave që aplikojnë. Megjithatë, përqindja e grave që aplikojnë dhe përfitojnë nga programet e FBZHR-së mbetet jashtëzakonisht e ulët.[84] […]

Programi i Zhvillimit Rural në kuadër të Instrumentit të Asistencës Para Anëtarësimit (IPA) i Republikës së Shqipërisë 2021-2027 (IPA-ZHR III) përmend shprehimisht detyrimet dhe objektivat e barazisë gjinore.[85] Në të përmendet *Aide-Mémoire* e kornizës ndërkombëtare përkatëse[86] për përfshirjen e perspektivës gjinore në Planin e Veprimit për Reduktimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë të OKB-së, detyrimet në kuadër të Planit të Tretë të Veprimit Gjinor të BE-së[87], dhe aktivitetet dhe rezultatet e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore (2021-2030), Objektivi 3.1, "Fuqizimi ekonomik i grave në zonat rurale".[88] Qëllimi i përgjithshëm i IPA-ZHR III është rritja e punësimit dhe të ardhurave "të gjeneruara nga gratë dhe sipërmarrësit e rinj në zonat rurale". Në dokument jepen rregullat për aksesimin e fondeve të IPA-ZHR III, ku përfshihen:

- respektim i shprehur i standardeve të BE-së lidhur me kërkesat e barazisë gjinore, pra, integrim i perspektivës gjinore në të gjitha programet;
- kryerja e analizës gjinore;
- të dhëna të ndara sipas gjinisë;
- përdorimi dhe monitorimi i treguesve gjinorë;
- trajnimi për integrimin gjinor në strukturat operative;
- bashkëpunimi me organizatat/shoqatat e grave;
- pjesëmarrja e barabartë e grave në grupet dhe organet zyrtare (si Grupet e Veprimit Vendor);
- përfaqësimi i grave në poste udhëheqëse dhe vendimmarrëse;
- përfshirja e organeve qeveritare përgjegjëse për promovimin e barazisë gjinore;
- veprim afirmativ (kuotat, preferenca ndaj grave aplikante);
- raportim i rezultateve të barazisë gjinore.

82. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (2022). Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027, miratuar me Vendimin nr.460, datë 29 qershor 2022. Gjendet në: https://qbz.gov.al/eli/fz/2022/100/6dea9d2c-c264-48a8-a9e1-d041781a823c;q=strategjia%20e%20bujqesise%20dhe%20zhvillimit%20rural

83. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të dhëna të vitit 2024, cituar në: FAO dhe UN Women (së shpejti). *National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania* (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

84. Në vitin 2018, në skemat kombëtare të mbështetjes në bujqësi aplikuan 779 gra, nga të cilat 627 i përfituan ato. Pesë gra përfituan nga "mbështetja për investime në agroturizëm", "inkubator për mbështetjen e prodhimeve vendore tradicionale" dhe "mbështetje për ndërtimin ose rindërtimin e mjediseve të akomodimit në turizmin rural me të paktën 6 deri në 10 dhoma". Në vitin 2019, përqindja e grave që aplikuan për subvencione nga AZHBR ishte 19 për qind. Burimi: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të dhëna të vitit 2019; dhe: Avokati i Popullit i Republikës së Shqipërisë (2020). Raport alternativ mbi zbatimin e Konventës KEGJFDG në Shqipëri 2016-2020. Gjendet në: https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/alternative-report-on-the-implementation-of-the-cedaw-convention-in-albania

85. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (2022). Shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/Programi-IPARD-III_2021-2027_English.pdf

86. UN Women - *Women's Resilience to Disasters Knowledge Hub (2017). Aide-Memoire on integrating gender equality in the UN plan of action on disaster risk reduction for resilience* (Qendër e njohurive për përballimin e fatkeqësive nga gratë (2017). (Kujtesë për integrimin e barazisë gjinore në planin e veprimit të BE-së për reduktimin e rreziqeve nga fatkeqësitë dhe përballimin e situatave). Gjendet në: https://wrd.unwomen.org/practice/resources/aide-memoire-integrating-gender-equality-un-plan-action-disaster-risk-reduction

87. Komisioni Evropian dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë (2020). *Objectives and Indicators to Frame the Implementation of the Gender Action Plan III (2021-25)*(Objektiva dhe tregues për kornizën e zbatimit të Planit të Veprimit Gjinor III), f.27. Gjendet në: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020SC0284

88. Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore 2021-2030, botuar në Fletoren Zyrtare nr.112, datë 15/07/2021. Shih: https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/112. Gjendet në: https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-02/WEB_Strategjia%20Kombetare%20-%20EN.pdf

Nuk ka informacion të disponueshëm për nivelin e përmbushjes dhe zbatimit të rregulloreve të barazisë gjinore gjatë zbatimit të IPA-ZHR III. Në vitin 2023, Komisioni Evropian pezulloi IPA-ZHR III dhe ajo vazhdon të jetë joaktive.

Rregullat e BE-së të përcaktuara në kuadër të programit IPA-ZHR III për adresimin dhe promovimin e barazisë gjinore në bujqësi shërbejnë si udhëzues i vlefshëm për harmonizimin me standardet e BE-së. Është e nevojshme që të reagohet me politika dhe rregullore kombëtare që rezultojnë në ngushtimin e hendekut gjinor dhe promovojnë një mjedis ku gratë kanë akses të barabartë në burime, në mënyrë që ato të mund të kontribuojnë në mënyrë efektive në prodhim bujqësor, konkurrencë, rritje ekonomike dhe zhvillim rural.

### Boshllëqe në statistikat dhe të dhëna gjinore për bujqësinë dhe zhvillimin rural

Të dhënat e ndara sipas gjinisë dhe statistikat gjinore janë shumë të rëndësishme për të kuptuar situatën me të cilën përballen gratë dhe burrat në sektorin BZHR në Shqipëri. Ato janë gjithashtu me rëndësi kyçe për kryerjen e analizave gjinore, hartimin e politikave reaguese gjinore dhe zhvillimin e masave për trajtimin e pabarazive dhe sfidave specifike gjinore. Megjithatë, mangësitë aktuale në të dhëna pengojnë hartimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe buxheteve që kanë lidhje me bujqësinë dhe zhvillimin rural të cilat u kundërvihen pabarazive, trajtojnë sfidat specifike gjinore, dhe monitorojnë siç duhet përparimin e bërë në ngushtimin e dallimeve gjinore.[89] [...][90]

89. KEGJFDG e OKB-së (2023). Vërejtje përmbyllëse të raportit të pestë periodik për Shqipërinë, 2023. Gjendet në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=KEGJFDG%2FC%2FALB%2FCO%2F5&Lang=en]

90. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

**Figura 4.** Gratë, burrat dhe bujqësia në Shqipëri




Burimi: INSTAT (2023). Tregu i punës, 2022; Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të dhëna të vitit 2024, cituar në : FAO dhe UN Women (së shpejti). National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

# Fuqizim i Grave për Zhvillim Rural në Shqipërinë e Veriut

SHKODËR DIBËR MALËSI E MADHE BULQIZË

Ambasada Italiane Tiranë

AGENZIA ITALIANA PER LA COOPERAZIONE ALLO SVILUPPO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

UN WOMEN